

32004L0022

Direktiva nr. 2004/22/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 mars 2004, mbi instrumentet matëse (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

Gazeta Zyrtare L 135 , 30/04/2004 fq. 0001 - 0080

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe veçanërisht nenin 95 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh Opinionin e Komitetit Europian Ekonomik dhe Shoqëror [2],

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përkruar në nenin 251 të Traktatit [3],

Duke pasur parasysh:

(1) Një numër instrumentesh matëse mbulohen nga direktiva të posaçme, të miratuara mbështetur në Direktivën e Këshillit 71/316/KEE, datë 26 korrik 1971, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me dispozitat e përbashkëta si për instrumentet matëse, ashtu edhe për metodat e kontrollit metrologjik [4]. Direktivat e posaçme që janë vjetërsuar nga pikëpamja teknike duhet të anulohen dhe të zëvendësohen prej direktivave të pavarura që pasqyrojnë frymën e Rezolutës së Këshillit, datë 7 maj 1985, mbi një metodë të re për harmonizimin teknik dhe standardet [5].

(2) Instrumente matëse të sakta dhe të kontrollueshme mund të përdoren për një shumëllojshmëri të detyrave të matjes. Ato që i përkasin motiveve të interesit publik, shëndetit publik, sigurisë dhe rendit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, të vënies së taksave dhe tatimeve e tregtisë së drejtë, të cilat dretjepërdrejtë dhe jodretjepërdrejtë ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve në shumë mënyra, mund të kërkojnë përdorimin e instrumenteve matëse të kontrolluara në mënyrë ligjore.

(3) Kontrolli metrologjik ligjor nuk duhet të çojë në pengesa ndaj lëvizjes së lirë të instrumenteve matëse. Dispozitat në lidhje me këto duhet të jenë të njëjta në të gjitha Shtetet Anëtare dhe prova e përshtatjes duhet të pranohet në të gjithë Komunitetin.

(4) Kontrolli metrologjik ligjor kërkon përshtatshmëri me kërkesat e caktuara të funksionimit. Kërkesat e funksionimit që duhet të përmbushin instrumentet matëse duhet të sigurojnë një nivel të lartë të mbrojtjes. Vlerësimi i përshtatshmërisë duhet të sigurojë një nivel të lartë besimi.

(5) Shtetet Anëtare, si rregull i përgjithshëm, duhet të kërkojnë kontrollin metrologjik ligjor. Atje ku kërkohet kontrolli metrologjik ligjor, duhet të përdoren vetëm instrumentet matëse që janë në përputhje me kërkesat e zakonshme të funksionimit.

(6) Parimi i opsioneve i paraqitur nga kjo direktivë, sipas të cilit Shtetet Anëtare mund të zbatojnë të drejtën e tyre për të vendosur nëse rregullojnë përdorimin e ndonjë prej instrumenteve që trajtohen në këtë direktivë, duhet të zbatohet vetëm në atë masë që nuk shkakton konkurrencë të padrejtë.

(7) Përgjegjësitë e prodhuesit për të respektuar kërkesat e kësaj direktive duhet të jenë të deklaruara shprehimisht.

(8) Funksionimi i instrumenteve matëse është veçanërisht i ndjeshëm ndaj rrethanave, në veçanti rrethanave elektromagnetike. Paprekshmëria e instrumenteve matëse ndaj ndërhyrjeve elektromagnetike formon një pjesë

përbërëse të kësaj direktive dhe kërkesat e paprekshmërisë të Direktivës së Këshillit 89/336/KEE, datë 3 maj 1989, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me përshtatshmërinë elektromagnetike [6] nuk duhet të zbatohen.

(9) Legjislacioni i Komunitetit duhet të përcaktojë kërkesa teknike që nuk pengojnë përparimin teknik, duke preferuar kërkesat e funksionimit. Dispozitat për heqjen e pengesave teknike ndaj tregtisë duhet të ndjekin Rezolutën e Këshillit, datë 7 maj 1985, mbi një metodë të re për harmonizimin teknik dhe standardet.

(10) Në mënyrë që të mbahen parasysh ndryshimet në kushtet klimatike ose të niveleve të ndryshme të mbrojtjes së konsumatorit që mund të zbatohen në nivelin kombëtar, kërkesat thelbësore mund të çojnë në krijimin e klasave të mjedisit ose të saktësisë.

(11) Në mënyrë që të lehtësohet detyra e vërtetimit të përshtatshmërisë me kërkesat thelbësore dhe për të mundësuar vlerësimin e përshtatshmërisë, është e dëshirueshme që të ekzistojnë standarde të harmonizuara. Standarde të tilla të harmonizuara hartohen prej organeve të së drejtës private dhe ata duhet të ruajnë statusin e tyre si tekste jo të detyrueshme. Për këtë qëllim, Komiteti Europian për Standardizimin (KEN), Komiteti Europian për Standardizimin Elektroteknik (KESE) dhe Instituti i Standardeve Europiane të Telekomunikacionit (ISET) njihen si organet kompetente për miratimin e standardeve të harmonizuara në përputhje me udhëzimet e përgjithshme mbi bashkëpunimin ndërmjet Komisionit dhe organeve Europiane të Standardizimit, të nënshkruara më 13 nëntor 1984.

(12) Kërkesat teknike dhe të funksionimit të dokumenteve normative të pranuar në nivel ndërkombëtar gjithashtu mund të jenë në përputhje, pjesërisht ose plotësisht, me kërkesat thelbësore të përshkruara nga kjo direktivë. Në ato raste, përdorimi i këtyre dokumenteve normative të pranuar në nivel ndërkombëtar mund të jetë një alternativë ndaj përdorimit të standardeve të harmonizuara dhe, në kushte të veçanta, mund të lejojnë krijimin e supozimit të përshtatshmërisë.

(13) Përshtatshmëria me kërkesat thelbësore të përshkruara nga kjo direktivë gjithashtu mund të sigurohet nëpërmjet kërkesave që nuk jepen nga një standard teknik evropian ose një dokument normativ i pranuar në nivel ndërkombëtar. Përdorimi i standardeve teknike evropiane ose dokumenteve normative të pranuar në nivel ndërkombëtar atëhere duhet të jetë opsional.

(14) Vlerësimi i përshtatshmërisë së njësisë duhet të respektojë dispozitat e kësaj direktive. Nëse njësitë tregtohen veçmas dhe në mënyrë të pavarur nga një instrument, procesi i vlerësimit të përshtatshmërisë duhet të kryhet në mënyrë të pavarur nga instrumenti në fjalë.

(15) Niveli i modernizimit në teknologjinë matëse i nënshtrohet evolucionit të vazhdueshëm, që mund të çojë në ndryshime të nevojave për vlerësime të përshtatshmërisë. Prandaj, për secilën kategori të matjes dhe, atje ku është e përshtatshme, për njësitë, duhet të ekzistojë një procedurë e përshtatshme ose një zgjidhje ndërmjet procedurave të ndryshme me saktësi të barabartë. Procedurat e miratuara janë ato që kërkohen nga Vendimi i Këshillit 93/465/KEE, datë 22 korrik 1993, në lidhje me elementet standarde për fazat e ndryshme të procedurave të vlerësimit të përshtatshmërisë dhe rregullat për vendosjen dhe përdorimin e shënimit "CE", të cilat synohet të përdoren në direktivat e harmonizimit teknik [7]. Megjithatë, mund të duhet që të bëhet shmangie prej këtyre elementeve standarde, në mënyrë që të pasqyrohen aspektet e veçanta të kontrollit metrologjik. Duhet të parashikohet që shënimi "CE" të vendoset gjatë procesit të prodhimit.

(16) Zhvillimet e vazhdueshme në teknologjinë e matjes si dhe shqetësimet e shprehura prej të interesuarve në lidhje me certifikimin, theksojnë nevojën për të siguruar procedura vlerësimi të qëndrueshme të përshtatshmërisë për prodhimet industriale, siç kërkohet nga Rezoluta e Këshillit e miratuar më 10 nëntor 2003 [8].

(17) Shtetet Anëtare nuk duhet të pengojnë nxjerrjen në treg dhe/ose vënien në përdorim të instrumenteve matëse që mbajnë shënimin 'CE' dhe shënime metrologjike shtesë në përputhje me dispozitat e kësaj direktive.

(18) Shtetet Anëtare duhet të kryejnë veprimet e duhura për të moslejuar që instrumente matëse të papërshtatshme të nxirren në treg dhe/ose të vihen në përdorim. Prandaj, bashkëpunimi i përshtatshëm ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare është i nevojshëm për të siguruar arritjen e këtij qëllimi në të gjithë Komunitetin.

(19) Prodhuesit duhet të informohen në lidhje me bazat në të cilat u mbështetën vendimet negative në lidhje me prodhimet e tyre dhe për mjetet ligjore në dispozicion për ta.

(20) Prodhuesve duhet t'u ofrohet mundësia për të ushtruar të drejtat e marra përpara hyrjes në fuqi të kësaj direktive, gjatë një periudhe të arsyeshme kalimtare.

(21) Karakteristikat kombëtare në lidhje me kërkesat kombëtare të përshtatshme në përdorim nuk duhet të ndërhyjnë në dispozitat e kësaj direktive në lidhje me "vënien në përdorim".

(22) Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE, datë 28 qershor 1999, që përshkruan procedurat për ekzekutimin e fuqive zbatuese të dhëna Komisionit [9].

(23) Veprimtaria e Komitetit të Instrumenteve matëse duhet të përfshijë këshillime të përshtatshme me përfaqësues të palëve të interesuara.

(24) Direktivat 71/318/KEE, 71/319/KEE, 71/348/KEE, 73/362/KEE, 75/33/KEE, në lidhje me kontatorët e përcaktuar në Shtojcën MI-001 të kësaj direktive, 75/410/KEE, 76/891/KEE, 77/95/KEE, 77/313/KEE, 78/1031/KEE dhe 79/830/KEE atëhere duhet të shfuqizohen,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Fusha e veprimit

Kjo direktivë zbatohet për pajisjet dhe sistemet me një funksion të matjes të përkufizuar në shtojcat për instrumentet matëse të veçanta në lidhje me kontatorët e ujit (MI-001), kontatorët e gazit dhe pajisjet e konvertimit të vëllimit (MI-002), kontatorët aktivë të energjisë elektrike (MI-003), kontatorët e ngrohjes (MI-004), sistemet e matjes për matjen e vazhdueshme dhe dinamike të sasive të lëngjeve, përveç ujit (MI-005), instrumentet matëse të peshimit automatik (MI-006), kontatorët e taksive (MI-007), matjet e materialeve (MI-008), instrumentet e matjes së dimensioneve (MI-009) dhe analizuesit e gazit të shkarkuar (MI-010).

Neni 2

1. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë përdorimin e instrumenteve matëse të përmendura në nenin 1 për detyrat e matjes për motive të interesit publik, shëndetit publik, sigurisë publike, rendit publik, mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes së konsumatorëve, vënies së taksave e tatimeve dhe të tregtisë së drejtë, atje ku ato e konsiderojnë atë të justifikuar.

2. Atje ku Shtetet Anëtare nuk parashikojnë një përdorim të tillë, ato duhet të komunikojnë arsyet për këtë pranë Komisionit dhe Shteteve të tjera Anëtare.

Neni 3

Qëllimi

Kjo direktivë përcakton kërkesat që pajisjet dhe sistemet e përmendura në nenin 1 duhet të përmbushen me qëllim që të nxirren në treg dhe/ose të vihen në përdorim për ato motive të përmendura në nenin 2 pika 1.

Kjo direktivë është një direktivë e veçantë në lidhje me kërkesat për përjashtimin elektromagnetik në kuptimin e nenit 2 pika 2 të Direktivës 89/336/KEE. Direktiva 89/336/KEE vazhdon të zbatohet në lidhje me kërkesat e rrezatimit.

Neni 4 **Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj direktive:

- (a) “instrument matës” nënkupton çdo pajisje ose sistem me një funksion matës që mbulohet nga nenet 1 dhe 3;
- (b) “njësi” nënkupton një pajisje fizike, të përmendur si të tillë në shtojcat e veçanta, që funksionon në mënyrë të pavarur dhe përbën një instrument matës së bashku
 - me njësi të tjera me të cilat përshtatet, ose
 - me një instrument matës me të cilin përshtatet;
- (c) “kontrolli metrologjik ligjor” nënkupton kontrollin e detyrave të matjes të synuara për fushën e zbatimit të një instrumenti matës, për motive të interesit publik, shëndetit publik, sigurisë publike, rendit publik, mbrojtjes së mjedisit, vënies së taksave dhe tatimeve, mbrojtjes së konsumatorëve dhe tregtisë së drejtë;
- (d) “prodhues” nënkupton një person fizik ose juridik përgjegjës për përshtatshmërinë e instrumentit matës me këtë direktivë me qëllim ose nxjerrjen e tij në treg në emër të tij dhe/ose vënien e tij në përdorim për qëllimet e tij;
- (e) “nxjerrje në treg” nënkupton vendosjen në dispozicion për herë të parë në Komunitet të një instrumenti që synohet për një përdorues të fundit, qoftë kundrejt shpërblimit ose falas;
- (f) “venie në përdorim” nënkupton përdorimin e parë të një instrumenti të synuar për përdoruesin e fundit për qëllimet për të cilat ai ishte menduar;
- (g) “përfaqësues i autorizuar” nënkupton një person fizik ose juridik, i cili është i vendosur brenda Komunitetit dhe është i autorizuar nga një prodhues, me shkrim, për të vepruar në llogari të tij për detyrat e përcaktuara brenda kuptimit të kësaj direktive;
- (h) “standard i harmonizuar” nënkupton një karakteristikë teknike të miratuar nga CEN, CENELEC ose ETSI ose së bashku nga dy ose të gjitha këto organizata, me kërkesë të Komisionit, sipas Direktivës 98/34/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 22 qershor 1998, që përshkruan një procedurë për sigurimin e informacionit në fushën e standardeve e rregulloreve teknike dhe rregullave mbi shërbimet e shoqërisë së informacionit [10] dhe e përgatitur në përputhje me orientimet e përgjithshme të pranuar nga Komisioni dhe organizatat e standardeve europiane;
- (i) “dokument normativ” nënkupton një dokument që përmban karakteristika teknike të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore (ONML), që i nënshtrohet procedurës së parashikuar në nenin 16 pika 1.

Neni 5 **Zbatueshmëria për njësitë**

Atje ku ekzistojnë shtojca të veçanta, që përshkruajnë kërkesat thelbësore për njësitë, dispozitat e kësaj direktive zbatohen *mutatis mutandis* për njësi të tilla.

Njësitë dhe instrumentet matëse mund të vlerësohen në mënyrë të pavarur dhe veçmas, me qëllim që të përcaktohet përshtatshmëria.

Neni 6 **Kërkesat thelbësore dhe vlerësimi i përshtatshmërisë**

1. Një instrument matës përmbushë kërkesat thelbësore të përshkruara në Shtojcën I dhe në shtojcën e veçantë për instrumentin përkatës. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë, nëse është e nevojshme, për përdorimin e drejtë të

instrumentit, që informacioni të cilit i referohet GZ siç GZ në Shtojcën I ose në shtojcat e veçanta për instrumentet matëse përkatëse të paraqitet në gjuhën(t) zyrtare të Shtetit Anëtar në të cilin instrumenti nxirret në treg.

2. Përshtatshmëria e një instrumenti matës me kërkesat thelbësore vlerësohet në përputhje me nenin 9.

Neni 7

Shënimi i përshtatshmërisë

1. Përshtatshmëria e një instrumenti matës ndaj të gjitha dispozitave të kësaj direktive tregohet nëpërmjet pranisë në të të shënimit “CE” dhe shënimeve metrologjike shtesë, siç përcaktohet në nenin 17.

2. Shënimi “CE” dhe shënimet metrologjike shtesë vendosen nga prodhuesi, ose nën përgjegjësinë e tij. Këto shënime mund të vendosen tek instrumenti gjatë procesit të prodhimit, nëse kjo është e justifikuar.

3. Vendosja e shënimeve në një instrument matës që ka të ngjarë të mashtrrojë palët e treta, në lidhje me kuptimin dhe/ose formën e shënimit “CE” dhe shënimeve metrologjike shtesë, është e ndaluar. Çdo shënim tjetër mund të vendoset në një instrument matës, me kusht që dukshmëria dhe lexueshmëria e shënimit “CE” dhe shënimeve metrologjike shtesë nuk është zvogëluar në këtë mënyrë.

4. Atje ku instrumenti matës i nënshtrohet masave të miratuara, sipas direktivave të tjera që mbulojnë aspekte të tjera që kërkojnë vendosjen e shënimit “CE”, shënimi tregon se instrumenti në fjalë gjithashtu supozohet të jetë në përputhje me kërkesat e atyre direktivave të tjera. Në një rast të tillë, referimi ndaj botimit të direktivës në fjalë, në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, duhet të jepet në dokumentet, njoftimet ose udhëzimet e kërkuara prej atyre direktivave dhe që shoqërojnë instrumentin matës.

Neni 8

Nxjerrja në treg dhe vënia në përdorim

1. Shtetet Anëtare nuk pengojnë për arsyet e përshkruara në këtë direktivë nxjerrjen në treg dhe/ose vënien në përdorim të ndonjë instrumenti matës që mban shënimin “CE” dhe shënime metrologjike shtesë në përputhje me nenin 7.

2. Shtetet Anëtare marrin masat e duhura për të siguruar që instrumentet matëse të nxirren në treg dhe/ose të vihen në përdorim vetëm nëse janë në përputhje me kërkesat e kësaj direktive.

3. Një Shtet Anëtar mund të kërkojë që një instrument matës të përmbushë dispozitat që rregullojnë vënien në përdorim të tij që justifikohen prej kushteve klimatike vendore. Në një rast të tillë, Shteti Anëtar duhet të zgjedhë kufij të përshtatshëm të lartë dhe të ulët të temperaturës nga Tabela 1 e Shtojcës I dhe, përveç kësaj, mund të përcaktojë kushte të lagështirës (kondensimi ose jokondensimi) dhe nëse vendi i menduar i përdorimit është i hapur apo i mbyllur.

4. Kur përcaktohen klasa të ndryshme të saktësisë për një instrument matës:

(a) shtojcat e veçanta për instrumentin nën titullin “Vënia në përdorim” mund të tregojë klasat e saktësisë që përdoren për zbatimet e caktuara.

(b) në të gjitha rastet e tjera një Shtet Anëtar mund të përcaktojë klasat e saktësisë që përdoren për zbatimet e caktuara brenda klasës së përcaktuar, me kusht që të lejojë përdorimin e të gjitha klasave të saktësisë në territorin e tij.

Në çdo rast nëse janë sipas shkronjave (a) ose (b), instrumentet matëse të një klase të saktësisë më të lartë mund të përdoren nëse pronari i tyre e dëshiron këtë.

5. Në panairë, ekspozita, shfaqje tregtare, etj., Shtetet Anëtare nuk ndalojnë shfaqjen e instrumenteve që nuk janë në përputhje me këtë direktivë, me kusht që një shenjë e dukshme të tregojë qartë mospërputhshmërinë e tyre dhe mosdisponueshmërinë e tyre për t'u nxjerrë në treg dhe/ose për t'u vënë në përdorim derisa të jenë të përshtatshëm.

Neni 9

Vlerësimi i përshtatshmërisë

Vlerësimi i përshtatshmërisë së një instrumenti matës ndaj kërkesave thelbësore përkatëse kryhet nëpërmjet zbatimit, sipas zgjedhjes së prodhuesit, të një prej procedurave të vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në shtojcën e veçantë për instrumentin. Prodhuesi paraqet, atje ku është e përshtatshme, dokumentacionin teknik për instrumentet matëse të veçanta ose grupet e instrumenteve të veçanta siç parashikohet në nenin 10.

Elementet standarde të vlerësimit të përshtatshmërisë që përbëjnë procedurat përshkruhen në Shtojcat A deri në H1.

Regjistrimet dhe korrespondenca në lidhje me vlerësimin e përshtatshmërisë hartohen në gjuhën(t) zyrtare të Shtetit Anëtar ku gjendet organi njoftues që kryhen procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë ose në një gjuhë që është e pranuar nga ai organ.

Neni 10

Dokumentacioni teknik

1. Dokumentacioni teknik bën të kuptueshme skicën, prodhimin dhe funksionimin e instrumentit matës dhe lejon një vlerësim të përshtatshmërisë së tij ndaj kërkesave të duhura të kësaj direktive.

2. Dokumentacioni teknik duhet të jetë aq i hollësishëm sa të sigurojë:

- përkufizimin e karakteristikavetrologjike,
- riprodhueshmërinë e funksionimit metrologjik të instrumenteve të prodhuara kur përditësohen siç duhet, duke përdorur mjetet e synuara të përshtatshme, dhe
- integritetin e instrumentit.

3. Dokumentacioni teknik duhet të përfshijë aq sa është e rëndësishme për vlerësimin dhe identifikimin e llojit dhe/ose instrumentit:

- (a) një përshkrim të përgjithshëm të instrumentit;
- (b) skicën konceptuale dhe vizatimet e prodhimit dhe planet e elementeve përbërëse, njësive, qarqeve, etj;
- (c) procedurat e prodhimit për të siguruar prodhimin konsekuent;
- (d) nëse është i zbatueshem, një përshkrim të pajisjeve elektronike me vizatime, diagrame, skema të logjikës dhe informacion të përgjithshëm të programit kompjuterik që shpjegon karakteristikat dhe funksionimin;
- (e) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për kuptimin e paragrafëve (b), (c) dhe (d), përfshirë funksionimin e instrumentit;
- (f) një listë të standardeve dhe/ose dokumentave normative të cilëve iu referohet neni 13, të zbatuara plotësisht ose pjesërisht;
- (g) përshkrime të zgjidhjeve të pranuar për të përmbushur kërkesat thelbësore atje ku nuk janë zbatuar standardet dhe/ose dokumentet normative të referuara në nenin 13;
- (h) rezultate të përlogaritjeve të skicës, ekzaminime, etj;
- (i) rezultatet e duhura të testimit, atje ku janë të nevojshme, për të treguar se lloji dhe/ose instrumentet matëse janë në përputhje me :
 - kërkesat e kësaj direktive sipas kushteve të deklaruara të funksionimit dhe në çrregullimet e caktuara mjedisore,
 - karakteristikat e fortësisë për kontaktorët e gazit, ujit dhe ngrohjes, si dhe për lëngjet e tjera përveç ujit.
- (j) certifikata të ekzaminimit të llojit KE ose certifikata të ekzaminimit të skicës të KE-së, në lidhje me instrumentet matëse që përmbajnë pjesë identike me ato në skicë.

4. Prodhuesi duhet të përcaktojë se ku janë vendosur vula dhe shënime.

5. Prodhuesi duhet të përcaktojë kushtet për përshtatshmërinë me paraqitjen dhe njësitë, atje ku janë të përshtatshme.

Neni 11

Njoftimi

1. Shtetet Anëtare duhet të njoftojnë Shtetet Anëtare të tjera dhe Komisionin në lidhje me organet në juridiksionin e tyre, të cilët ata i kanë caktuar për të kryer detyrat që kanë lidhje me elementet standarde të vlerësimit të përshtatshmërisë të referuar në nenin 9, së bashku me numrat e identifikimit që u janë dhënë atyre nga Komisioni në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, llojin(et) e instrumentit matës për të cilin është caktuar secili organ dhe përveç kësaj, atje ku është e përshtatshme, klasat e saktësisë të instrumentit, sferën e matjes, teknologjinë e matjes dhe çdo karakteristikë tjetër të instrumentit që kufizon fushën e veprimit të njoftimit.

2. Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë kriteret e përcaktuara në nenin 12 për caktimin e organeve të tilla. Organet që përmbushin kriteret e përshkruara në standardet kombëtare që ndërrojnë vendet me standardet e harmonizuara përkatëse, referimet e të cilave janë botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, supozohen se përmbushin kriteret korresponduese. Shtetet Anëtare botojnë referimet e këtyre standardeve kombëtare.

Nëse një Shtet Anëtar nuk ka paraqitur legjislacion kombëtar për detyrat e përmendura në nenin 2, ai ruan të drejtën për të caktuar dhe njoftuar një organ për detyrat në lidhje me atë instrument.

3. Një Shtet Anëtar që ka njoftuar një organ:

— siguron se organi vazhdon të përmbushë kriteret e përshkruara në nenin 12,

— tërheq një njoftim të tillë nëse zbulon se organi nuk i përmbush më ato kriteret.

Ai njofton menjëherë Shtetet Anëtare të tjera dhe Komisionin për një tërheqje të tillë.

4. Secilit prej organeve që njoftohen ju jepet një numër identifikimi nga Komisioni. Komisioni boton një listë të organeve të njoftuara, së bashku me informacionin në lidhje me fushën e veprimit të njoftimit të referuar në paragrafin 1, në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, seria C dhe sigurohet që lista është e përditësuar.

Neni 12

Kriteret që duhet të përmbushen nga organe të caktuara

Shtetet Anëtare zbatojnë kriteret e mëposhtme për caktimin e organeve në përputhje me nenin 11 pika 1.

1. Organi, drejtuesi i tij dhe personeli i përfshirë në detyrat e vlerësimit të përshtatshmërisë nuk mund të jetë skicuesi, prodhuesi, furnitori, instaluesi ose përdoruesi i instrumenteve që ata inspektojnë, as përfaqësuesi i autorizuar i ndonjërit prej tyre. Përveç kësaj, ata nuk mund të jenë të përfshirë drejtpërdrejtë në skicimin, prodhimin, marketimin ose mirëmbajtjen e instrumenteve, as të përfaqësojnë palët e përfshira në këto veprimtari. Megjithatë, kriteri i mëparshëm, nuk përjashton në asnjë mënyrë mundësinë e shkëmbimit të informacionit teknik ndërmjet prodhuesit dhe organit për qëllimet e vlerësimit të përshtatshmërisë.

2. Organi, drejtuesi i tij dhe personeli i përfshirë në detyrat e vlerësimit të përshtatshmërisë nuk i nënshtrohet asnjë presioni dhe joshjeje, veçanërisht joshjeve financiare që mund të ndikojnë në gjykimin e tyre ose në rezultatet e vlerësimit të tyre mbi përshtatshmërinë, veçanërisht nga persona ose grupe personash me një interes në rezultatet e vlerësimeve.

3. Vlerësimi i përshtatshmërisë duhet të kryhet me shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencës së kërkuar në fushën e metrologjisë. Nëse organi kontraktonte detyra të caktuara, ai fillimisht duhet

të sigurohet se kontraktori përmbush kërkesat e kësaj direktive dhe në veçanti të këtij neni. Organi mban dokumentet përkatëse të vlerësimit të cilësive të kontraktorit dhe të punës së kryer prej tij sipas kësaj direktive në dispozicion të autoritetit njoftues.

4. Organi duhet të jetë në gjendje që të kryejë të gjitha detyrat për vlerësimin e përshtatshmërisë për të cilat është caktuar, qoftë nëse ato detyra kryhen nga vetë organi ose në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij. Ai duhet të ketë në dispozicion të tij personelin e nevojshëm dhe mundësinë e përdorimit të mjediseve të nevojshme për të kryer në një mënyrë të saktë detyrat teknike dhe administrative të përfshira në vlerësimin e përshtatshmërisë.

5. Personeli i organit ka:

- trajnim të mirë teknik dhe profesional, që mbulon të gjitha detyrat e vlerësimit të përshtatshmërisë për të cilat është krijuar organi;
- njohuri të kënaqshme të rregullave në lidhje me detyrat që kryen dhe përvojë të përshtatshme të detyrave të tilla;
- aftësinë e nevojshme për të hartuar certifikatat, regjistrimet dhe raportet që tregojnë se detyrat janë kryer.

6. Paanësia e organit, drejtuesit dhe personelit të tij është e garantuar. Shpërblimi i organit nuk varet nga rezultatet e detyrave që kryen. Shpërblimi i drejtuesit të organit dhe personelit të tij nuk varet nga numri i detyrave të kryera ose nga rezultatet e detyrave të tilla.

7. Organi ka siguracion për përgjegjësi civile, nëse përgjegjësia civile e tij nuk mbulohet nga Shteti Anëtar në fjalë sipas ligjit kombëtar.

8. Drejtuesi dhe personeli i organit pritët që të respektojnë sekretin profesional në lidhje me të gjithë informacionin e siguruar gjatë kryerjes së detyrave të tyre, në përputhje me këtë direktivë, përveç për sa i përket autoritetit të Shtetit Anëtar që e ka krijuar atë.

Neni 13

Standardet e harmonizuara dhe dokumentet normative

1. Shtetet Anëtare supozojnë përshtatshmërinë me kërkesat thelbësore të referuara në Shtojcën I dhe në shtojcat e veçanta për instrumentet matëse përkatëse, në lidhje me një instrument matës që është në përputhje me elementet e standardeve kombëtare që zbatojnë standardin europian të harmonizuar, për atë instrument matës që u korrespondon atyre elementeve të këtij standardi europian të harmonizuar, referimet në lidhje me të cilin janë botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, seria C.

Atje ku një instrument matës është në përputhje vetëm pjesërisht me elementet e standardeve kombëtare të referuara në nënparagrafin e parë, Shtetet Anëtare supozojnë përshtatshmëri me kërkesat thelbësore që u korrespondojnë elementeve të standardeve kombëtare me të cilat instrumenti është në përputhje.

Shtetet Anëtare botojnë referimet ndaj standardeve kombëtare që iu referohen në nënparagrafin e parë.

2. Shtetet Anëtare supozojnë përshtatshmërinë me kërkesat thelbësore të referuara në Shtojcën I dhe në shtojcat e veçanta për instrumentet matëse përkatëse në lidhje me një instrument matës që është në përputhje me pjesë korresponduese të dokumenteve normative dhe listave të referuara në nenin 16 pika 1 germa (a), referimet në lidhje me të cilat janë botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, seria C.

Atje ku një instrument matës është në përputhje vetëm pjesërisht me dokumentin normativ të referuar në nënparagrafin e parë, Shtetet Anëtare supozojnë përshtatshmëri me kërkesat thelbësore që u korrespondojnë elementeve normative me të cilat instrumenti është në përputhje.

Shtetet Anëtare botojnë referimet ndaj dokumenteve normative që iu referohen në nënparagrafin e parë.

3. Një prodhues mund të zgjedhë të përdorë çdo zgjidhje teknike që është në përputhje me kërkesat thelbësore që iu referohen në Shtojcën I dhe shtojcat e veçanta për instrumentet matëse përkatëse (MI-001 deri në MI-010). Përveç kësaj, për të përfituar nga supozimi i përshtatshmërisë, prodhuesi duhet të zbatojë me saktësi zgjidhjet e përmendura ose në standardet europiane të harmonizuara ose në pjesët korresponduese të dokumenteve normative dhe listave të referuara në paragrafët 1 dhe 2.

4. Shtetet Anëtare supozojnë përshtatshmërinë me testimet e duhura të përmendura në pikën (i) të nenit 10 nëse programi korrespondues i testimit është kryer në përputhje me dokumentet përkatëse të përmendura në paragrafët 1 deri në 3 dhe nëse rezultatet e testimit sigurojnë përshtatshmëri me kërkesat thelbësore.

Neni 14 **Komiteti Drejtues**

Atje ku një Shtet Anëtar ose Komisioni e konsideron se një standard europian i harmonizuar, siç i referohet në nenin 13 pika 1 nuk përmbush plotësisht kërkesat thelbësore që u referohen në Shtojcën I dhe shtojcat e veçanta për instrumentet matëse përkatëse, Shteti Anëtar ose Komisioni e paraqesin këtë çështje përpara Komitetit Drejtues të krijuar sipas nenit 5 të Direktivës 98/34/KE, duke dhënë arsyet e tij për këtë. Komiteti jep një opinion pa vonesë.

Duke marrë parasysh opinionin e Komitetit, Komisioni njofton Shtetet Anëtare nëse është e nevojshme që të tërhiqet referimi ndaj standardeve kombëtare nga botimi që i referohet në nënparagrafin e tretë të nenit 13 pika 1.

Neni 15 **Komiteti për instrumentet matëse**

1. Komisioni mbështetet nga Komiteti për instrumentet matëse.

2. Atje ku i referohet këtij paragrafi, zbatohen edhe nenet 3 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të saj.

3. Atje ku i referohet këtij paragrafi, zbatohen edhe nenet 3 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të saj.

Periodha e parashikuar në nenin 5 pika 6 të Vendimit 1999/468/KE është tre muaj.

4. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

5. Komisioni siguron se informacioni përkatës në lidhje me masat e parashikuara, siç u referohen në nenin 16, është vendosur në dispozicion të palëve të interesuara në kohën e përshtatshme.

Neni 16 **Funksionet e Komitetit për instrumentet matëse**

1. Me kërkesë të një Shteti Anëtar ose me vetë iniciativën e tij, Komisioni, duke vepruar në përputhje me procedurën që referohet në nenin 15 pika 2, mund të marrë çdo masë të përshtatshme për të:

(a) identifikuar dokumentet normative të hartuara nga ONML-ja dhe për të renditur në një listë pjesët, përshtatshmëria me të cilet krijon supozimin e përshtatshmërisë me kërkesat thelbësore korresponduese të kësaj direktive;

(b) botuar referimet e dokumenteve normative dhe të listës së referuar në pikën (a) në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, seria C.

2. Me kërkesë të një Shteti Anëtar ose me vetë iniciativën e tij, Komisioni, duke vepruar në përputhje me procedurën që referohet në nenin 15 pika 3, mund të marrë çdo masë të përshtatshme për të ndryshuar shtojcat për instrumentet matëse të veçanta (MI-001 deri në MI-010) në lidhje me:

- gabimet maksimale të lejueshme (MPE-të) dhe klasat e saktësisë,
- kushtet e vlerësuara të funksionimit,
- vlerat kritike të ndryshimit,
- shqetësimin,

3. Atje ku një Shtet Anëtar ose Komisioni e konsideron se një dokument normativ, referimet e të cilit janë botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit European, seria C, në përputhje me paragrafin 1 germa (b), nuk përmbush plotësisht kërkesat thelbësore që i referohen në Shtojcën I dhe në shtojcat e veçanta për instrumentet matëse përkatëse, ai Shtet Anëtar ose Komisioni e paraqesin këtë çështje përpara Komitetit për instrumentet matëse, duke dhënë arsyet për këtë.

Komisioni, duke vepruar në përputhje me procedurën e referuar në nenin 15 pika 2, njofton Shtetet Anëtare nëse është e nevojshme që të tërhiqen referimet ndaj dokumenteve normative në fjalë botimi në Gazetën Zyrtare.

4. Shtetet Anëtare mund të marrin masa të përshtatshme për t'u këshilluar me palët e interesuara në nivelin kombëtar në lidhje me punën e ONML-së që ka lidhje me fushën e veprimit të kësaj direktive.

Neni 17 Shënimet

1. Shënimi “CE” që i referohet në nenin 7 përbëhet nga simboli “CE” sipas skicës së përshkruar në paragrafin I.B shkronja (d) të shtojcës së Vendimit 93/465/KEE. Shënimi “CE” është të paktën 5 mm i lartë.

2. Shënimet metrologjike shtesë përbëhen nga shkronja e madhe “M” dhe dy shifrat e fundit të vitit të vendosjes së tij, të rrethuar nga një katror. Lartësia e katrorit është e barabartë me lartësinë e shënimit “CE”. Shënimet metrologjike shtesë pasojnë menjëherë shënimin “CE”.

3. Numri i identifikimit të organit të njoftuar në fjalë që i referohet në nenin 11, nëse parashikohet nga procedura e vlerësimit të përshtatshmërisë, pason shënimin “CE” dhe shënimin metrologjik shtesë.

4. Kur një instrument matës përbëhet nga një grup pajisjesh, që nuk janë njësi të tij, të cilat veprojnë së bashku, shënimet vendosen në pajisjen kryesore të instrumentit. Atje ku një instrument matës është shumë i vogël ose shumë i ndjeshëm për të mbajtur shënimin “CE” dhe shënimet metrologjike shtesë, shënimet vendosen në paketim, nëse ka paketim, dhe në dokumentet shoqëruese që kërkohen nga kjo direktivë.

5. Shënimi “CE” dhe shënimet metrologjike shtesë janë të paheqshme. Numri i identifikimit i organit të njoftuar në fjalë është i paheqshëm ose vetëshkatërrues nëse hiqet. Të gjitha shënimet janë qartësisht të dukshme ose lehtësisht të disponueshme.

Neni 18 Vëzhgimi i tregut dhe bashkëpunimi administrativ

1. Shtetet Anëtare marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar se instrumentet matëse që i nënshtrohen kontrollit metrologjik ligjor, por nuk janë në përputhje me dispozitat e zbatueshme të kësaj direktive, nuk nxirren në treg dhe nuk vihen në përdorim.

2. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ndihmojnë njëri-tjetrin në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të kryer vëzhgimin e tregut. Në veçanti, autoritetet kompetente shkëmbejnë:

- informacionin në lidhje me nivelin në të cilin instrumentet matëse që ata shqyrtojnë janë në përputhje me dispozitat e kësaj direktive dhe rezultatet e shqyrtimeve të tilla;
- Shqyrtime të llojit KE dhe certifikatat e shqyrtimit të skicave dhe shtojcat e tyre të lëshuara prej organeve të njoftuara, si dhe shtesat, modifikimet dhe tërheqjet në lidhje me certifikatat që janë lëshuar më parë;
- miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara nga organet e njoftuara, si dhe informacionin mbi sistemet e cilësisë të refuzuara ose të tërhequra;
- raportet e vlerësimit të hartuara nga organet e njoftuara, kur kërkohen nga autoritetet e tjera.

3. Shtetet Anëtare sigurojnë që i gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me certifikatat dhe miratimet e sistemit të cilësisë është vënë në dispozicion të organeve që ata kanë njoftuar.

4. Çdo Shtet Anëtar njofton Shtetet Anëtare të tjera dhe Komisionin se cilat autoritete kompetente ka caktuar për një shkëmbim të tillë të informacionit.

Neni 19

Dispozita e mbrojtjes

1. Atje ku një Shtet Anëtar përcakton se i gjithë instrumenti matës ose një pjesë e tij e një modeli të caktuar, që mban shënimin “CE” dhe shënimet metrologjike shtesë, nuk përmbushin kërkesat thelbësore që kanë lidhje me funksionimin metrologjik të përcaktuar në këtë direktivë, kur është instaluar dhe është përdorur siç duhet, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, ai merr masat e duhura për të tërhequr këto instrumente nga tregu, për të ndaluar ose kufizuar që ato të nxirren më tej në treg ose për të ndaluar ose kufizuar që ato të përdoren më tej.

Kur vendos në lidhje me masat e mësipërme, Shteti Anëtar merr parasysh natyrën sistematike ose të rastësishme të mospërshtatshmërisë. Atje ku Shteti Anëtar ka përcaktuar se mospërshtatshmëria është e një natyre sistematike, ai njofton menjëherë Komisionin në lidhje me masat e marra, duke treguar arsyet për vendimin e tij.

2. Komisioni fillon këshillime me palët në fjalë sa më shpejt që të jetë e mundur.

(a) Nëse Komisioni zbulon se masat e marra nga Shteti Anëtar në fjalë janë të justifikuara, ai njofton menjëherë atë Shtet Anëtar, si dhe Shtetet Anëtare të tjera.

Shteti Anëtar kompetent ndërmerr veprimin e duhur ndaj çdo personi që vendos shënimet dhe njofton Komisionin dhe Shtetet Anëtare të tjera për këtë.

Nëse mospërputhja i atribuohet mungesave në standarde ose në dokumentet normative, Komisioni, pas këshillimit me palët në fjalë, e paraqet këtë çështje sa më shpejt që të jetë e mundur përpara Komitetit të duhur, siç referohet në nenet 14 ose 15.

(b) Nëse Komisioni zbulon se masat e marra nga Shteti Anëtar në fjalë nuk janë të justifikuara, ai njofton menjëherë Shtetin Anëtar për këtë, si dhe prodhuesin në fjalë ose përfaqësuesin e autorizuar të tij.

Komisioni siguron që Shtetet Anëtare mbahen të informuara mbi ecurinë dhe rezultatin e procedurës.

Neni 20

Shënimet e vendosura në mënyrë të padrejtë

1. Atje ku një Shtet Anëtar përcakton se shënimet ‘ “CE” dhe shënimet metrologjike shtesë janë vendosur në mënyrë të padrejtë, prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij detyrohet:

- të përshtatë instrumentin sipas atyre dispozitave që kanë lidhje me shënimin ‘ “CE” dhe shënimet metrologjike shtesë që nuk trajtohen nga neni 19 pika 1 dhe
- t’i japë fund shkeljes sipas kushteve të vendosura nga Shteti Anëtar.

2. Nëse shkelja e përshkruar më sipër vazhdon, Shteti Anëtar duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të kufizuar ose ndaluar nxjerrjen në treg të instrumentit në fjalë ose për të siguruar se ai tërhiqet nga tregu apo për të ndaluar ose kufizuar përdorimin më tej të tij në përputhje me procedurat e përshkruara në nenin 19.

Neni 21

Vendimet që përfshijnë refuzimin ose kufizimin

Çdo vendim që merret sipas kësaj direktive që përfshin tërheqjen nga tregu të një instrumenti matës, apo ndalimin ose kufizimin e nxjerrjes në treg apo vënies në përdorim të një instrumenti, deklaron bazat e sakta në të cilat mbështetet. Vendimi i njoftohet menjëherë palës në fjalë, e cila në të njëjtën kohë njoftohet në lidhje me mjetet ligjore në dispozicion të saj sipas ligjit të Shtetit Anëtar në fjalë dhe për afatet kohore të cilave i nënshtrohen mjete të tilla.

Neni 22

Shfuqizimet

Direktivat e mëposhtme shfuqizohen duke filluar nga data 30 tetor 2006 pa cenuar nenin 23:

- Direktiva e Këshillit 71/318/KEE, datë 26 korrik 1971, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me kontatorët e gazit [11],
- Direktiva 71/319/KEE, datë 26 korrik 1971, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me kontatorët për lëngjet përveç ujit [12];
- Direktiva 71/348/KEE, datë 12 tetor 1971, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me pajisjet ndihmëse për kontatorët për lëngjet përveç ujit [13],
- Direktiva 73/362/KEE, datë 19 nëntor 1973, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me matjen materiale të gjatësisë [14],
- Direktiva 75/33/KEE, datë 17 dhjetor 1974, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me kontatorët e ujit të ftohtë, për sa u përket kontatorëve të përcaktuar në Shtojcën MI-001 të kësaj direktive [15].
- Direktiva 75/410/KEE, datë 24 qershor 1975, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me makinat e peshimit me totalizim të vazhdueshëm [16],
- Direktiva 76/891/KEE, datë 4 nëntor 1976, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me kontatorët e energjisë elektrike [17],
- Direktiva 77/95/KEE, datë 21 dhjetor 1976, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me kontatorët e taksive [18],
- Direktiva 77/313/KEE, datë 5 prill 1977, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me sistemet e matjes për lëngjet përveç ujit [19],
- Direktiva 78/1031/KEE, datë 5 dhjetor 1978, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me peshimin automatik dhe makinat e gradimit të peshës [20],
- Direktiva 79/830/KEE, datë 11 shtator 1979, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me kontatorët e ujit të ngrohtë [21].

Neni 23

Dispozitat kalimtare

Nëpërmjet shmangies nga neni 8 pika 2, Shtetet Anëtare lejojnë, për detyrat e matjes për të cilat ata kanë parashikuar përdorimin e instrumentit matës të kontrolluar ligjërisht, nxjerrjen në treg dhe vënien në përdorim të instrumenteve matëse që janë në përputhje me rregullat në fuqi përpara datës 30 tetor 2006 deri në përfundimin e vlefshmërisë së tipit të miratimit për ato instrumente matëse ose, në rast të një lloji miratimi me një vlefshmëri të papërcaktuar, për një periudhë maksimale deri në dhjetë vjet nga data 30 tetor 2006.

Neni 24

Transpozimi

1. Shtetet Anëtare miratojnë dhe botojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme në përputhje me këtë direktivë përpara datës 30 prill 2006. Ata njoftojnë menjëherë Komisionin për këto. Kur Shtetet Anëtare të miratojnë këto masa, ata duhet të përmbajnë një referim ndaj këtij direktivë ose duhet të shoqërohen nga një referim i tillë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Metodrat e bërjes së një referimi të tillë përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

Shtetet Anëtare i zbatojnë këto dispozita nga data 30 tetor 2006.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave të ligjit kombëtar që ata kanë miratuar në fushën e mbuluar nga kjo direktivë.

Neni 25 **Klauzola e rishikimit**

Parlamenti Europian dhe Këshilli Europian ftojnë Komisionin që të raportojë, përpara datës 30 prill 2011, mbi zbatimin e kësaj direktive, *inter alia*, mbi bazën e raporteve të paraqitura nga Shtetet Anëtare dhe atje ku është e nevojshme, të paraqesë një propozim për ndryshime.

Parlamenti Europian dhe Këshilli Europian ftojnë Komisionin të vlerësojë nëse procedurat për vlerësimin e përshtatshmërisë për prodhimet industriale zbatohen siç duhet dhe atje ku është e nevojshme, të propozojë ndryshime në mënyrë që të sigurohet një certifikim i njëtrajtshëm.

Neni 26 **Hyrja në fuqi**

Kjo direktivë hyn në fuqi në ditën e publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.

Neni 27 **Adresa**

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 31 mars 2004.

Për Parlamentin Europian
Presidenti
P. Cox

Për Këshillin
Presidenti
D. Roche

[1] GZ C 62 E, 27.02.2001, fq. 1, dhe GZ C 126 E, 28.05.2002, fq. 368.

[2] GZ C 139, 11.05.2001, fq. 4.

[3] Opinioni i Parlamentit Europian, datë 3 korrik 2001 (GZ C 65 E, 14.03.2002, fq. 34). Qëndrimi i Perbashket i Keshillit, datë 22 korrik 2003 (GZ C 252 E, 21.10.2003, fq. 1) dhe Qëndrimi i Parlamentit Europian, datë 17 dhjetor 2003 (i papublikuar ende ne Gazeten Zyrtare). Vendimi i Keshillit datë 26 shkurt 2004.

[4] GZ L 202, 06.09.1971, fq. 1. Direktivë e ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr. 807/2003 (GZ L 122, 16.05.2003, fq. 36).

[5] GZ C 136, 04.06.1985, fq. 1.

[6] GZ L 139, 23.05.1989, f. 19. Direktivë siçe ndryshuar së fundi nga Direktiva 93/68/KEE (GZ L 220, 30.08.1993, fq. 1).

[7] GZ L 220, 30.8.1993, fq. 23.

[8] GZ C 282, 25.11.2003, fq. 3.

[9] GZ L 184, 17.07.1999, fq. 23.

[10] GZ L 204, 21.7.1998, fq. 37. Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 98/48/KE (GZ L 217, 05.08.1998, fq. 18).

[11] GZ L 202, 6.9.1971, fq. 21. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva e Komisionit 82/623/KEE (GZ L 252, 27.08.1982, fq. 5).

[12] GZ L 202, 06.09.1971, fq. 32.

- [13] GZ L 239, 25.10.1971, fq. 9. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Akti i Aderimit i vitit 1994.
- [14] GZ L 335, 5.12.1973, fq. 56. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva e Komisionit 85/146/KEE (GZ L 54, 23.2.1985, f. 29).
- [15] GZ L 14, 20.1.1975, fq. 1.
- [16] GZ L 183, 14.7.1975, fq. 25.
- [17] GZ L 336, 4.12.1976, fq. 30.
- [18] GZ L 26, 31.1.1977, fq. 59.
- [19] GZ L 105, 28.4.1977, fq. 18. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva e Komisionit 82/625/KEE (GZ L 252, 27.08.1982, fq. 10).
- [20] GZ L 364, 27.12.1978, fq. 1.
- [21] GZ L 259, 15.10.1979, fq. 1.

SHTOJCA I

Kërkesat thelbësore

Një instrument matës siguron një nivel të lartë të mbrojtjes metrologjike në mënyrë që çdo palë e interesuar të ketë besim në rezultatin e matjes dhe skicohet dhe prodhohet me një nivel të lartë cilësie, për sa i përket teknologjisë së matjes dhe sigurisë së të dhënave të matjes.

Kërkesat që përmbushen prej instrumenteve matëse përshkruhen më poshtë dhe plotësohen, atje ku është e përshtatshme, nëpërmjet kërkesave mbi instrumentet matëse të vecanta në Shtojcat MI-001 deri në MI-010 që sigurojnë më shumë hollësi në lidhje me disa aspekte të kërkesave të përgjithshme.

Zgjidhjet e pranuar gjatë përmbushjes së kërkesave marrin parasysh përdorimin e synuar të instrumentit dhe ndonjë keqpërdorim të parashikueshëm të tij.

Përkufizimet

Sasia e matur: sasia e matur është sasia e caktuar që i nënshtrohet matjes.

Sasia e ndikuar: një sasi e ndikuar është një sasi që nuk është e matur, por që ndikon rezultatin e matjes.

Kushtet e vlerësuara të funksionimit: kushtet e vlerësuara të funksionimit janë vlerat për sasinë e matur dhe sasinë e ndikuar që përbëjnë kushtet normale të punës së një instrumenti.

Trazimi: një sasi e ndikuar që ka një vlerë brenda kufijve të përcaktuar në kërkesat e duhura, por jashtë kushteve të vlerësuara të funksionimit të përcaktuara të instrumentit matës. Një sasi e ndikuar është një trazim nëse për atë sasi të ndikuar kushtet e vlerësuara të funksionimit nuk janë të përcaktuara.

Vlera e ndryshimit kritik: vlera e ndryshimit kritik është vlera në të cilën ndryshimi në rezultatin e matjes konsiderohet i padëshirueshëm.

Matja materiale: një matje materiale është një pajisje që synon të riprodhojë ose të sigurojë në një mënyrë të përhershme gjatë përdorimit të saj një ose më shumë vlera të ditura të një sasive të dhënë.

Shitje të drejtpërdrejta: një veprim tregtar është një shitje e drejtpërdrejtë nëse:

- rezultati i matjes shërben si bazë për çmimin që paguhet dhe;
- të paktën njëra prej palëve të përfshira në veprimin në lidhje me matjen është një konsumator ose çdo palë tjetër që kërkon një nivel të ngjashëm mbrojtjeje dhe;
- të gjitha palët në këtë veprim pranojnë rezultatin e matjes në atë kohë dhe vend.

Mjediset klimatike: mjediset klimatike janë kushtet në të cilat mund të përdoren instrumentet e matjes. Për të trajtuar ndryshimet klimatike ndërmjet Shteteve Anëtare, është përcaktuar një sferë e kufijve të temperaturës.

Shërbimet: një shërbim konsiderohet furnitor i elektricitetit, gazit, ngrohjes ose ujit.

Kërkesat

1. Gabimet e lejueshme

1.1. Në kushtet e vlerësuara të funksionimit dhe në mungesë të një trazire, gabimi i matjes nuk kapërcen vlerën e gabimit maksimal të lejueshëm (MPE) siç përshkruhet në kërkesat për instrumentet matëse të veçanta përkatëse.

Nëse nuk shprehet ndryshe në shtojcat për instrumentet matëse të vecanta, MPE shprehet si një vlerë e dyanshme e shmangies nga vlera e vërtetë e matjes.

1.2. Në kushtet e vlerësuara të funksionimit dhe në prani të një trazire, kërkesa e funksionimit përshkruhet në kërkesat për instrumentet matëse të veçanta përkatëse.

Atje ku instrumenti synohet të përdoret në një fushë elektromagnetike të vazhdueshme dhe të përhershme të përcaktuar, funksionimi i lejueshëm gjatë testimit të amplitudës në fushën elektromagnetike me rrezatim është brenda MPE-së.

1.3. Prodhuesi përcakton mjediset klimatike, mekanike dhe elektromagnetike në të cilat instrumenti synohet të përdoret, sasinë e furnizimit me energji dhe sasi të tjera të trazirës që ka të ngjarë të ndikojnë në saktësinë e tij, duke marrë parasysh kërkesat e përshkruara në shtojcat për instrumentet e veçanta përkatëse.

1.3.1. Mjediset klimatike

Prodhuesi përcakton kufirin e lartë dhe kufirin e ulët të temperaturës për çdonjërin prej vlerave në Tabelen 1, përveç kur parashikohet ndryshe në Shtojcat MI-001 deri në MI-010, dhe tregon nëse instrumenti është i synuar për lagështirë kondensuese ose jokondensuese, si dhe vendndodhjen e synuar për instrumentin, d.m.th. e hapur ose e mbyllur.

Tabela 1

Kufijtë e temperaturës

Kufiri i lartë i temperaturës 30 °C 40 °C 55 °C 70 °C

Kufiri i ulët i temperaturës 5 °C - 10 °C - 25 °C - 40 °C

1.3.2. (a) Mjediset mekanike klasifikohen në klasat M1 deri në M3 siç përshkruhet më poshtë.

M1: Kjo klasë zbatohet për instrumentet matëse të përdorura në vendndodhje me dridhje dhe tronditje të një niveli të ulët, p.sh. për instrumentet matëse që janë vendosur në struktura me mbështetje të lehtë që iu nënshtrohen dridhjeve dhe tronditjeve të neglizhueshme që transmetohen nga shpërthime vendore ose veprimtari të shpimit, përplasje e dyerve, etj.

M2: Kjo klasë zbatohet për instrumentet matëse të përdorura në vendndodhjet me nivele të larta të dridhjes dhe tronditjes, p.sh. që transmetohen nga makina dhe automjete që kalojnë aty pranë ose që janë ngjitur me makineri të rënda, rripa transmisioni, etj.

M3: Kjo klasë zbatohet për instrumentet matëse të përdorura në vendndodhjet ku niveli i dridhjes dhe tronditjes është i lartë dhe shumë i lartë, p.sh. për instrumentet matëse të vendosura drejtpërdrejt në makineri, rripa transmisioni, etj.

(b) Sasi të ndikuara të mëposhtme konsiderohen në lidhje me mjediset mekanike:

— Dridhje;

— Tronditje mekanike.

1.3.3. (a) Mjediset elektromagnetike klasifikohen në klasat E1, E2 ose E3 siç përshkruhet më poshtë, përveç kur përshkruhet ndryshe në shtojcat për instrumentet matëse të veçanta përkatëse.

E1: Kjo klasë zbatohet për instrumentet matëse të përdorura në vendndodhje me trazime elektromagnetike që u korrespondojnë atyre që ka të ngjarë të gjenden në ndërtesa banimi, tregtare dhe të industrisë së lehtë.

E2: Kjo klasë zbatohet për instrumentet matëse të përdorura në vendndodhje me trazime elektromagnetike që u korrespondojnë atyre që ka të ngjarë të gjenden në ndërtesa industriale të tjera.

E3: Kjo klasë zbatohet për instrumentet matëse që furnizohen nga bateria e një automjeti. Instrumentet matëse të tilla duhet të jenë në përputhje me kërkesat e E2 dhe kërkesat shtesë të mëposhtme:

- zvogëlimet e voltazhit të shkaktuara nga vënia në funksionim e qarqeve të ndezësit të motorit të motorëve me djegie të brendshme;
- ndryshimet e shkarkimit të ngarkesës që ndodhin në rast të shkëputjes së një baterie të shkarkuar, ndërsa motori është i ndezur.

(b) Sasitë e ndikuara të mëposhtme konsiderohen në lidhje me mjediset elektromagnetike:

- Ndërprerje të voltazhit,
- Zvogëlime të shkurtra të voltazhit,
- Voltazh që kalon në linjat e furnizimit dhe/ose linjat e sinjalizimit,
- Shkarkime elektrostatische,
- Fushat elektromagnetike të frekuencave të radios,
- Fushat elektromagnetike të frekuencave të radios të përçuara në linjat e furnizimit dhe/ose linjat e sinjalizimit,
- Ngritjet në linjat e furnizimit dhe/ose linjat e kanalizimit.

1.3.4. Sasi të tjera të ndikuara që konsiderohen, atje ku është e përshtatshme, janë:

- Ndryshimi i voltazhit,
- Luhatjet e frekuencës së energjisë,
- Fushat magnetike të frekuencës së korrentit,
- Ndonjë sasi tjetër që ka të ngjarë të ndikojë në një mënyrë të konsiderueshme në saktësinë e instrumentit.

1.4. Kur kryhen testimet siç parashikohet në këtë direktivë, zbatohen paragrafët e mëposhtëm:

1.4.1. Rregullat bazë për testimin dhe përcaktimin e gabimeve

Kërkesat thelbësore të përcaktuara në 1.1. dhe 1.2 verifikohen për çdo sasi të ndikuar të rëndësishme. Përveç kur përcaktohet ndryshe në shtojcën për instrumentin e veçantë përkatës, këto kërkesa thelbësore zbatohen kur bëhet fjalë për çdo sasi të ndikuar dhe ndikimin e saj veçmas, të gjitha sasitë e ndikuara të tjera mbahen relativisht konstante në vlerën e tyre të referimit.

Testimet metrologjike kryhen gjatë ose pas përdorimit të sasisë së ndikuar, cilido kusht që i korrespondon gjendjes së funksionimit normal të instrumentit kur ajo sasi e ndikuar ka të ngjarë të ndodhë.

1.4.2. Lagështira e mjedisit

- Sipas mjedisit klimatik të funksionimit në të cilin instrumenti synohet të përdoret, mund të jenë të përshtatshme teste të ngrohjes së thatë në gjendje të qëndrueshme (jokondensuese) ose të ngrohjes së thatë ciklike (kondensuese).

— Testimi i ngrohjes së thatë ciklike është i përshtatshëm kur kondensimi është i rëndësishëm ose kur hyrja e avullit përshpejtohet nga ndikimi i frymëmarrjes. Në kushtet kur lagështira jokondensuese është një faktor, është i përshtatshëm testimi i ngrohjes së thatë në gjendje të qëndrueshme.

2. Riprodhueshmëria

Përdorimi i të njëjtës sasi të matur në një vendndodhje tjetër ose nga një përdorues tjetër, nëse të gjitha kushtet e tjera janë të njëjta, duhet të rezultojë në një përputhje të afërt të matjeve të njëpasnjëshme. Ndryshimi ndërmjet rezultateve të matjes është i vogël kur krahasohet me MPE.

3. Përsëritshmëria

Përdorimi i të njëjtës sasi të matur në të njëjtat kushte të matjes duhet të rezultojë në një përputhje të afërt të matjeve të njëpasnjëshme. Ndryshimi ndërmjet rezultateve të matjes është i vogël kur krahasohet me MPE.

4. Diferencimi dhe ndjeshmëria

Një instrument matës është aq i ndjeshëm dhe pragu i diferencimit duhet të jetë aq i ulët sa që të jetë i përshtatshëm për detyrën e matjes së synuar.

5. Qëndrueshmëria

Një instrument matës skicohet për të ruajtur një qëndrueshmëri të përshtatshme të karakteristikave metrologjike të tij gjatë një periudhe kohe të vlerësuar nga prodhuesi, me kusht që të instalohet, mirëmbahet dhe përdoret siç duhet në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, kur është në kushtet mjedisore për të cilat është menduar.

6. Besueshmëria

Një instrument matës skicohet për të zvogëluar sa më shumë që të jetë e mundur ndikimin e një të mete që çon në një rezultat të pasaktë të matjes, përveç kur prania e një të mete të tillë është e dukshme.

7. Përshtatshmëria

7.1. Një instrument matës nuk ka asnjë karakteristikë që ka të ngjarë të lehtësojë përdorimin mashtrues, ndërsa mundësitë për keqpërdorimin e paparamenduar janë minimale.

7.2. Një instrument matës është i përshtatshëm për përdorimin e synuar të tij, duke marrë parasysh kushtet e punës në praktikë dhe nuk ka nevoja të paarsyeshme nga përdoruesi në mënyrë që të sigurojë një rezultat të drejtë të matjes.

7.3. Gabimet e një instrumenti të matjes së shërbimeve në rrjedhë jashtë sferës së kontrolluar nuk paragjykojnë në mënyrë të papërshtatshme.

7.4. Atje ku një instrument matës është skicuar për matjen e vlerave të sasisë së matur që janë konstante me kalimin e kohës, instrumenti matës nuk është i ndjeshëm ndaj luhatjeve të vogla të vlerës së sasisë së matur ose duhet të ndërmarrë një veprim të përshtatshëm.

7.5. Një instrument matës është i fortë dhe materialet e ndërtimit të tij janë të përshtatshme për kushtet në të cilat synohet të përdoret.

7.6. Një instrument matës skicohet në mënyrë që të lejojë kontrollin e detyrave të matjes pasi instrumenti është nxjerrë në treg dhe është vënë në përdorim. Nëse është e nevojshme, pajisje ose program kompjuterike të posaçëm për këtë kontroll janë pjesë të instrumentit. Procedura e testimit përshkruhet në manualin e funksionimit.

Kur një instrument matës ka program kompjuterik shoqërues, i cili siguron funksione të tjera përveç funksionit të matjes, programi kompjuterik që është kritik për karakteristikat metrologjike është i identifikueshëm dhe nuk ndikohet në mënyrë të papranueshme nga programi kompjuterik shoqërues.

8. Mbrojtja ndaj prishjes

8.1. Karakteristikat metrologjike të një instrumenti matës nuk ndikohen në ndonjë mënyrë të papranueshme nëpërmjet lidhjes së tij me një pajisje tjetër, nëpërmjet ndonjë karakteristike të vetë pajisjes së lidhur ose nga ndonjë pajisje e largët që komunikon me instrumentin matës.

8.2. Një element përbërës i prekshëm që është kritik për karakteristikat metrologjike skicohet në mënyrë që të mund të sigurohet. Masat e sigurisë të parashikuara duhet të garantojnë për prova të një ndërhyrjeje.

8.3. Programi kompjuterik që është kritik për karakteristikat metrologjike identifikohet si i tillë dhe sigurohet.

Identifikimi i programit kompjuterik sigurohet lehtësisht nga instrumenti matës.

Prova e një ndërhyrjeje është e disponueshme për një periudhë kohe të arsyeshme.

8.4. Të dhënat e matjes dhe programi kompjuterik që është kritik për karakteristikat e matjes dhe parametrat metrologjikë të rëndësishëm të ruajtur ose të transmetuar mbrohet në mënyrë të përshtatshme ndaj prishjes aksidentale ose të qëllimshme.

8.5. Për instrumentet matëse e matjes së shërbimeve, shfaqja e sasisë së plotë të furnizuar ose shfaqjet prej të cilave përcaktohet sasia e plotë e furnizuar, referimi i plotë ose i pjesshëm i të cilave është baza për pagesën, nuk duhet të jetë në gjendje që të zerohet gjatë përdorimit.

9. Informacioni që duhet të mbahet nga dhe të shoqërojë instrumentin

9.1. Një instrument matës duhet të mbajë mbishkrimet e mëposhtme:

- markën ose emrin e prodhuesit;
- informacion në lidhje me saktësinë e tij,

plus, kur është e zbatueshme:

- informacion në lidhje me kushtet e përdorimit;
- kapacitetin e matjes;
- sferën e matjes;
- shenimin e identitetit;
- numrin e certifikatës së shqyrtimeve të llojit KE ose certifikatën e shqyrtimit të skicave KE;
- informacion nëse pajisjet shtesë që sigurojnë rezultatet metrologjike janë në përputhje me dispozitat e kësaj direktive mbi kontrollin metrologjik ligjor.

9.2. Një instrument me përmasa shumë të vogla ose i një përbërjeje shumë të ndjeshme për të lejuar që ai të mbajë informacion të rëndësishëm ka paketimin e tij, dhe nëse ka të tilla, dokumentet shoqëruese që kërkohen sipas dispozitave të kësaj direktive të shënuara ashtu siç duhet.

9.3. Instrumenti shoqërohet nga informacioni në lidhje me funksionimin e tij, përveç kur lehtësia e instrumentit të matjes e bën këtë të panevojshëm. Informacioni është i thjeshtë për t'u kuptuar dhe përfshin atje ku është e përshtatshme:

- kushtet e vlerësuara të funksionimit;
- klasat e mjedisit mekanik dhe elektromagnetik;

- kufirin e lartë dhe të ulët të temperaturës, nëse kondensimi është i mundshëm ose jo dhe vendndodhja është e hapur ose e mbyllur;
- udhëzimet për instalimin, mirëmbajtjen, riparimet, rregullimet e lejueshme;
- udhëzimet për funksionimin e duhur dhe çdo kusht të veçantë të përdorimit;
- kushtet për përshtatshmërinë me paraqitjet, njësitë ose instrumentet matëse.

9.4. Grupet e instrumenteve matëse identike të përdorura në të njëjtën vendndodhje ose të përdorura për matje të shërbimeve nuk kërkojnë domosdoshmërisht manuale individuale të udhëzimeve.

9.5. Përveç kur përcaktohet ndryshe në një shtojcë të instrumentit të veçantë, shkalla e intervalit për një vlerë të matur është në formën $1 \times 10_n$, $2 \times 10_n$, ose $5 \times 10_n$, ku n është një numër i plotë ose zero.

Njësia e matjes ose simboli i tij vendosen pranë vlerës numerike.

9.6. Një matje materiale shënohet me një vlerë ose shkallë nominale, e shoqëruar nga njësia e matjes që është përdorur.

9.7. Njësitë e matjes që janë përdorur dhe simbolet e tyre janë në përputhje me dispozitat e legjislacionit të Komunitetit ose njësitë e matjes dhe simbolet e tyre.

9.8. Të gjitha shënimet dhe mbishkrimet e kërkuara sipas çdo kërkesë janë të qarta, të paheqshme, jo me dy kuptime dhe të patransferueshme.

10. Tregimi i rezultatit

10.1. Tregimi i rezultatit bëhet nëpërmjet një shfaqjeje ose kopjeje të shtypur.

10.2. Tregimi i çdo rezultati është i qartë e jo me dy kuptime dhe shoqërohet nga shënime dhe mbishkrime të tilla të nevojshme për të informuar përdoruesin në lidhje me rëndësinë e rezultatit. Leximi i thjeshtë i rezultatit të paraqitur lejohet në kushtet normale të përdorimit. Tregues shtesë mund të vendosen me kusht që ata të mos ngatërrohen me treguesit metrologjikë të kontrolluar.

10.3. Në rast të kopjes së printuar, kjo kopje ose ky regjistrim gjithashtu është i thjeshtë për t'u lexuar dhe i paheqshëm.

10.4. Një instrument matës për shitjet e veprimet tregtare të shitjeve të drejtpërdrejta skicohet për të paraqitur rezultatin e matjes për të dyja palët në këtë veprim kur instalohet ashtu siç është menduar. Kur është kritik në rastin e shitjeve të drejtpërdrejta, çdo kupon që i jepet konsumatorit nga një pajisje ndihmëse që nuk është në përputhje me kerkesat e kësaj direktive, përmban një informacion të përshtatshëm kufizues.

10.5. Pavarësisht nëse një instrument matës që synohet të përdoret për qëllime të matjes së shërbimeve mund të lexohet së largu, ai pajiset në çdo rast me një ekran metrologjik të kontrolluar, që mund të shihet nga konsumatori për përdorur vegla ndihmëse. Leximi i këtij ekrani është rezultati i matjes që shërben si bazë për çmimin që paguhet.

11. Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave për të përfunduar veprimin tregtar

11.1. Një instrument matës përveç një instrumenti matës të shërbimeve regjistron në mjete të qëndrueshme rezultatin e matjes të shoqëruar nga informacioni për identifikimin e veprimit të caktuar, kur:

- matja nuk është e përsëritshme dhe;
- instrumenti matës normalisht synohet për përdorim në mungesë të një prej palëve të veprimit tregtar.

11.2. Përveç kësaj, një provë e qëndrueshme e rezultatit të matjes dhe informacionit për të identifikuar veprimin vihet në dispozicion sipas kërkesës në kohën e përfundimit të matjes.

12. Vlerësimi i përshtatshmërisë

Një instrument matës skicohet në mënyrë që të lejojë vlerësimin e gatshëm të përshtatshmërisë së tij me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

SHTOJCA A

Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit” është procedura e vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkruara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Dokumentacioni teknik

2. Prodhuesi siguron dokumentacionin teknik siç përshkruhet në nenin 10. Dokumentacioni lejon vlerësimin e përshtatshmërisë së instrumentit me kërkesat e duhura të kësaj direktive. Ai, për aq sa është e rëndësishme për një vlerësim të tillë, mbulon skicimin, prodhimin dhe funksionimin e instrumentit.

3. Prodhuesi vendos dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për dhjetë vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit.

Prodhimi

4. Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përshtatshmërinë e instrumenteve të prodhuara me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

5.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE” dhe shënime metrologjike shtesë në secilin instrument matës që përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

5.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për një model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për dhjetë vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon instrumentin për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklarimit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

Përfaqësuesi i autorizuar

6. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafët 3 dhe 5.2 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

Kur prodhuesi nuk është i vendosur brenda Komunitetit dhe atje ku ai nuk ka një përfaqësues të autorizuar, detyrimet që gjenden në paragrafët 3 dhe 5.2 janë përgjegjësia e personit që nxjerr instrumentin në treg.

SHTOJCA A1

Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus testimin e prodhimit nga një organ i njoftuar

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus testimin e prodhimit nga një organ i njoftuar” është procedura e vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkruara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Dokumentacioni teknik

2. Prodhuesi siguron dokumentacionin teknik siç përshkruhet në nenin 10. Dokumentacioni lejon vlerësimin e përshtatshmërisë së instrumentit me kërkesat e duhura të kësaj direktive. Ai, për aq sa është e rëndësishme për një vlerësim të tillë, mbulon skicimin, prodhimin dhe funksionimin e instrumentit.

3. Prodhuesi vendos dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për dhjetë vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit.

Prodhimi

4. Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përshtatshmërinë e instrumenteve të prodhuara me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Kontrollet e prodhimit

5. Një organ i njoftuar, i zgjedhur nga prodhuesi, kryen kontrole të prodhimit ose merr masa për kryerjen e tyre në intervale të përshtatshme të përcaktuara prej tij, në mënyrë që të verifikojë cilësinë e kontroleve të brendshëm të prodhimit, duke marrë parasysh, inter alia, kompleksitetin teknologjik të instrumenteve dhe sasinë e prodhimit. Një mostër e përshtatshme e prodhimeve përfundimtare, të marra nga organi i njoftuar përpara nxjerrjes në treg, shqyrtohet dhe kryhen testimet e përshtatshme të identifikuar nga dokumenti(dokumentet) e duhura që u referohen në nenin 13 ose teste të barasvlershme për të kontrolluar përshtatshmërinë e instrumenteve me kërkesat e duhura të kësaj direktive. Në mungesë të një dokumenti të duhur, organi i njoftuar në fjalë vendos në lidhje me testimet e përshtatshme që kryhen.

Në ato raste kur një numër i përshtatshëm i instrumenteve në mostër nuk është në përputhje me një nivel të cilësisë së pranueshme, organi i njoftuar merr masat e duhura.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

6.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE”, shënimet metrologjike shtesë dhe, nën përgjegjësinë e organit të njoftuar të referuar në paragrafin 4, numrin e identifikimit të këtij të fundit në secilin instrument matës që përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

6.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për dhjetë vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaramit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë, sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

Përfaqësuesi i autorizuar

7. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafet 3 dhe 6.2 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

Kur prodhuesi nuk është i vendosur brenda Komunitetit dhe atje ku ai nuk ka një përfaqësues të autorizuar, detyrimet që gjenden në paragrafet 3 dhe 6.2 janë përgjegjësia e personit që nxjerr instrumentin në treg.

SHTOJCA B

Shqyrtimi i tipit

1. “Shqyrtimi i tipit” është pjesë e procedurës së vlerësimit të përshtatshmërisë, sipas të cilës një organ i njoftuar shqyrton skicën teknike të një instrumenti matës dhe sigurohet e deklaron se skica teknike përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

2. Shqyrtimi i tipit mund të kryhet në njërin nga mënyrat e mëposhtme. Organi i njoftuar vendos mbi mënyrën e përshtatshme dhe mostrat e kërkuara:

- (a) shqyrtimi i një mostre përfaqesuese të prodhimit të parashikuar të instrumentit matës të plotë;
- (b) shqyrtimi i mostrave përfaqesuese të prodhimit të parashikuar të një ose më shumë pjesëve kritike të instrumentit matës, plus vlerësimi i përshtatshmërisë së skicës teknike të pjesëve të tjera të instrumentit matës nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe provave mbështetëse që iu referohen në paragrafin 3;
- (c) vlerësimi i përshtatshmërisë së skicës teknike të instrumentit matës nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe provave mbështetëse të referuara në paragrafin 3, pa shqyrtimin e një mostre.

3. Kërkesa për shqyrtimin e tipit paraqitet nga prodhuesi pranë një organi të njoftuar të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përfshin:

- emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqesuesi i autorizuar, edhe emrin dhe adresën e tij;
- një deklaratë me shkrim se e njëjta kërkesë nuk është paraqitur pranë ndonjë organi tjetër të njoftuar;
- dokumentacionin teknik siç përshkruhet në nenin 10. Dokumentacioni bën të mundur vlerësimin e përshtatshmërisë së instrumentit me kërkesat e duhura të kësaj direktive. Ai, për aq sa është e rëndësishme për një vlerësim të tillë, mbulon skicimin, prodhimin dhe funksionimin e instrumentit;
- mostrat përfaqesuese të prodhimit të parashikuar siç kërkohet nga organi i njoftuar;
- provat mbështetëse për përshtatshmërinë e skicës teknike për ato pjesë të instrumentit matës për të cilat nuk kërkohen mostra. Këto prova mbështetëse përmendin çdo dokument të duhur që është zbatuar, në veçanti atje ku dokumentet e duhura të referuara në nenin 13 nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë, dhe përfshijnë, atje ku është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera nga laboratorit i përshtatshëm i prodhuesit ose nga ndonjë laborator tjetër testues për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.

4. Organi i njoftuar:

Për mostrat:

4.1. shqyrton dokumentacionin teknik, verifikon se mostrat janë prodhuar në përputhje me të dhe identifikon elementet që janë skicuar në përputhje me dispozitat përkatëse të dokumenteve të duhura të referuara në nenin 13, si dhe elementet që janë skicuar pa zbatuar dispozitat përkatëse të atyre dokumenteve;

4.2. kryen shqyrtimet dhe testimet e duhura ose merr masa për kryerjen e tyre, për të kontrolluar nëse atje ku prodhuesi ka zgjedhur të zbatojë zgjidhjet e dokumenteve të duhura të referuara në nenin 13, këto janë zbatuar siç duhet;

4.3. kryen shqyrtimet dhe testimet e duhura ose të marrë masa për kryerjen e tyre, për të kontrolluar nëse atje ku prodhuesi ka zgjedhur të mos zbatojë zgjidhjet e dokumenteve të duhura të referuara në nenin 13, zgjidhjet e zbatuara nga prodhuesi përmbushin kërkesat përkatëse thelbësore të kësaj direktive;

4.4. bie dakord me paraqitësin e kërkesës në lidhje me vendndodhjen ku do të kryhen shqyrtimet dhe testimet.

Për pjesët e tjera të instrumentit matës:

4.5. shqyrton dokumentacionin teknik dhe provat mbështetëse për të vlerësuar përshtatshmërinë e skicës teknike të pjesëve të tjera të instrumentit matës.

Për procesin e prodhimit:

4.6. shqyrton dokumentacionin teknik për të siguruar se prodhuesi ka mjete të përshtatshme për të siguruar prodhimin e qëndrueshëm.

5.1. Organi i njoftuar harton një raport të vlerësimit që regjistron veprimtaritë e kryera në përputhje me paragrafin 4 dhe rezultatet e tyre. Pa cenuar nenin 12 pika 8, organi i njoftuar bën publike përmbajtjen e këtij raporti, të plotë ose të pjesshme, vetëm me pëlqimin e prodhuesit.

5.2. Atje ku skica teknike përmbush kërkesat e kësaj direktive që zbatohen ndaj instrumentit matës, organi i njoftuar i lëshon prodhuesit një certifikatë të shqyrtimit të tipit KE. Certifikata përmban emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse është e përshtatshme, të përfaqësuesit të autorizuar të tij, përfundimet e shqyrtimit, kushtet (nëse ka ndonjë) për vlefshmërinë e tij dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e instrumentit. Certifikata mund të ketë një ose më shumë shtojca të bashkëngjitura.

Certifikata dhe shtojcat e saj përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për vlerësimin e përshtatshmërisë dhe kontrollit të shërbimit. Në veçanti, për të lejuar që përshtatshmëria e instrumenteve matëse të vlerësohet me llojin e shqyrtuar në lidhje me riprodhueshmërinë e funksioneve metrologjike të tyre kur përditësohen siç duhet duke përdorur mjete të përshtatshme, përmbajtja përfshin:

- karakteristikat metrologjike të llojit të instrumentit;
- masat e kërkuara për sigurimin e integritetit të instrumenteve (vulosja, identifikimi i programit kompjuterik, etj.);
- informacion mbi elementet e tjera të nevojshme për identifikimin e instrumenteve dhe për të kontrolluar përputhshmërinë e jashtme vizuale të tyre me tipin;
- nëse është e përshtatshme, çdo informacion të veçantë të nevojshëm për të verifikuar karakteristikat e instrumenteve të prodhuar;
- në rastin e një njësie, të gjithë informacionin e nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me njësitë ose instrumentet matëse të tjerë.

Certifikata ka një vlefshmëri prej dhjetë vjetësh nga data e lëshimit dhe mund të përsëritet për periudha të mëvonshme prej dhjetë vjetësh secila.

5.3. Organi i njoftuar harton një raport të vlerësimit në lidhje me këtë dhe e vendos atë në dispozicion të Shtetit Anëtar që e ka caktuar këtë organ.

6. Prodhuesi informon organin e njoftuar që mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën e shqyrtimit të tipit KE për të gjitha ndryshimet në instrument që mund të ndikojnë në përputhshmërinë e instrumentit me kërkesat thelbësore ose kushtet për vlefshmërinë e certifikatës. Ndryshime të tilla kërkojnë miratim shtesë në formën e një shtesë ndaj certifikatës origjinale të shqyrtimit të tipit KE.

7. Çdo organ i njoftuar njofton menjëherë Shtetin Anëtar që e ka caktuar atë në lidhje me:

- certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe shtojcat e lëshuara;
- shtesat dhe ndryshimet në lidhje me certifikatat e lëshuara më pare.

Çdo organ i njoftuar njofton menjëherë Shtetin Anëtar se e ka caktuar atë për tërheqjen e një certificate të shqyrtimit të tipit KE. Organi i njoftuar mban dosjen teknike që përfshin dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi për një periudhë deri në fund të vlefshmërisë së certifikatës.

8. Prodhuesi mban një kopje të certifikatës së shqyrtimit të tipit KE, shtojcave të saj dhe shtesave me dokumentacionin teknik për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit matës të fundit.

9. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të paraqesë kërkesën që i referohet në paragrafin 3 dhe mund të kryejë detyrimet e përmendura në paragrafët 6 dhe 8. Atje ku prodhuesi nuk është i vendosur brenda Komunitetit dhe atje ku ai nuk ka një përfaqësues të autorizuar, detyrimet për të vendosur në dispozicion dokumentacionin teknik sipas kërkesës është përgjegjësia e personit të caktuar nga prodhuesi.

SHTOJCA C

Deklarimi i përshtatshmërisë ndaj tipit, mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë ndaj tipit mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit” është pjesë e procedurës së vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkruara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë janë në përputhje me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Prodhimi

2. Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përshtatshmërinë e instrumenteve të prodhuara me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

3.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE” dhe shënime metrologjike shtesë në secilin instrument matës që është në përputhje me tipin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

3.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për dhjetë vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklarimit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

Përfaqësuesi i autorizuar

4. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafin 3.2 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

Kur prodhuesi nuk është i vendosur brenda Komunitetit dhe atje ku ai nuk ka një përfaqësues të autorizuar, detyrimet që gjenden në paragrafin 3.2 janë përgjegjësia e personit që nxjerr instrumentin në treg.

SHTOJCA C1

Deklarimi i përshtatshmërisë ndaj tipit mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus testimin e prodhimit nga një organ i njoftuar

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë ndaj tipit mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus testimin e prodhimit nga një organ i njoftuar” është pjesë e procedurës së vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkruara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë janë në përputhje me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Prodhimi

2. Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përshtatshmërinë e instrumenteve të prodhuara me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Kontrollet e prodhimit

3. Një organ i njoftuar, i zgjedhur nga prodhuesi, kryen kontrolle të prodhimit ose merr masa për kryerjen e tyre në intervale të përshtatshme të përcaktuara prej tij, në mënyrë që të verifikojë cilësinë e kontrolleve të brendshme të prodhimit, duke marrë parasysh, *inter alia*, kompleksitetin teknologjik të instrumenteve dhe sasinë e prodhimit. Një mostër e përshtatshme e prodhimeve përfundimtare, të marra nga organi i njoftuar përpara nxjerrjes në treg, shqyrtohet dhe kryhen testimet e përshtatshme të identifikuara nga dokumentet e duhura që u referohen në nenin 13 ose testime të barasvlershme për të kontrolluar përputhshmërinë e prodhimit me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të llojit KE dhe me kërkesat e duhura të kësaj direktive. Në mungesë të një dokumenti të duhur, organi i njoftuar në fjalë vendos në lidhje me testimet e përshtatshme që kryhen.

Në ato raste kur një numër i përshtatshëm i instrumenteve në moster nuk është në përputhje me një nivel të cilësisë së pranueshme, organi i njoftuar merr masat e duhura.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

4.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE”, shënime metrologjike shtesë dhe, nën përgjegjësinë e organit të njoftuar të referuar në paragrafin 3, numrin e identifikimit të këtij të fundit, në secilin instrument matës që është në përputhje me tipin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

4.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për dhjetë vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentin për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklarimit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

Përfaqësuesi i autorizuar

5. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafin 4.2 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

Kur prodhuesi nuk është i vendosur brenda Komunitetit dhe atje ku ai nuk ka një përfaqësues të autorizuar, detyrimet që gjenden në paragrafin 4.2 janë përgjegjësia e personit që nxjerr instrumentin në treg.

SHTOJCA D

Deklarimi i përshtatshmërisë ndaj tipit mbështetur në sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë ndaj tipit mbështetur në sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit” është pjesë e procedurës së vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkuara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë janë në përputhje me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Prodhimi

2. Prodhuesi përdor një sistem të miratuar të cilësisë për prodhimin, inspektimin e prodhimit përfundimtar dhe testimin e instrumentit matës në fjalë siç përcaktohet në paragrafin 3 dhe i nënshtrohet vrojtimit siç përcaktohet në paragrafin 4.

Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi paraqet një kërkesë për vlerësimin e sistemit të cilësisë pranë një organi të njoftuar të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përfshin:

- të gjithë informacionin e duhur për kategorinë e parashikuar të instrumentit;
- dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;
- dokumentacionin teknik të tipit të miratuar dhe një kopje të certifikatës së shqyrtimit të tipit KE.

3.2. Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e instrumenteve me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi dokumentohen në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e praktikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave mbi cilësinë.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të përshtatshëm të:

- objektivave të cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe autoritetin e administratës në lidhje me cilësinë e prodhimit;
- prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe teknikat, proceset dhe veprimet sistematike të sigurimit të cilësisë që përdoren;
- shqyrtimeve dhe testeve që kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe shpeshtësinë me të cilën ato kryhen;
- të dhënave mbi cilësinë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj;
- mjeteve për vëzhgimin e arritjeve në lidhje me cilësinë e kërkuar të prodhimit dhe funksionimin e efektshëm të sistemit të cilësisë.

3.3. Organi i njoftuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai përmbush kërkesat të cilave iu referohen në paragrafin 3.2 Ai supozon përshtatshmëri me këto kërkesa në lidhje me një sistem të cilësisë që është në përputhje me karakteristikat korresponduese të standardit kombëtar që zbaton standardin përkatës të harmonizuar, nga momenti që referimet ndaj tij janë botuar.

Përveç përvojës në sistemet e administrimit të cilësisë, ekipi i kontrollit zotëron përvojë të përshtatshme në fushën përkatëse të metrologjisë e teknologjisë së instrumenteve dhe njohuri mbi kërkesat e zbatueshme të kësaj direktive. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në mjediset e prodhuesit.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhuesi merr përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej sistemit të cilësisë që është miratuar dhe për mirëmbajtjen e tij në mënyrë që ai të qëndrojë i përshtatshëm dhe efikas.

3.5. Prodhuesi informon organin e njoftuar që ka miratuar sistemin e cilësisë në lidhje me çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Organi i njoftuar vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë përmbush akoma kërkesat e referuara në paragrafin 3.2 ose nëse kërkohet një vlerësim i ri.

Ai njofton prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

Vëzhgimi nën përgjegjësinë e organit të njoftuar

4.1. Qëllimi i vëzhgimit është për t'u siguruar se prodhuesi përmbush detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë i miratuar.

4.2. Prodhuesi i lejon organit të njoftuar që të hyjë për qëllime inspektimi në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit e magazinimit dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

— dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

— të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj;

4.3. Organi i njoftuar kryen kontrole periodike për t'u siguruar se prodhuesi e mirëmban dhe e përdor sistemin e cilësisë dhe i paraqet prodhuesit një raport të kontrollit.

4.4. Përveç kësaj, organi i njoftuar mund të kryejë vizita të papritura pranë prodhuesit. Gjatë vizitave të tilla, organi i njoftuar, nëse janë të nevojshme, mund të kryejë teste të prodhimeve ose të marrë masa për kryerjen e tyre, për të verifikuar se sistemi i cilësisë është duke funksionuar në rregull.

Ai i paraqet prodhuesit një raport mbi vizitën, dhe një raport të testeve, nëse janë zhvilluar teste.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

5.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE”, shënime metrologjike shtesë dhe, nën përgjegjësinë e organit të njoftuar të referuar në paragrafin 3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit, në secilin instrument matës që është në përputhje me tipin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

5.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për dhjetë vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklarimit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

6. Prodhuesi, për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit, duhet të vendosë në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

— dokumentacionin që i referohet në paragrafin 3.1, kryeradha e dytë;

— ndryshimin e referuar në paragrafin 3.5, siç është miratuar;

— vendimet dhe raportet nga organi i njoftuar që u referohen në paragrafet 3.5, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo organ i njoftuar periodikisht vendos në dispozicion të Shtetit Anëtar që e caktoi atë listën e miratimeve të sistemeve të cilësisë të lëshuar ose të refuzuar dhe njofton menjëherë Shtetin Anëtar që e caktoi atë për tërheqjen e një miratimi të një sistemi të cilësisë.

Përfaqësuesi i autorizuar

8. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafët 3.1, 3.5, 5.2 dhe 6 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

SHTOJCA D1

Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit” është procedura e vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkruara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Dokumentacioni teknik

2. Prodhuesi siguron dokumentacionin teknik siç përshkruhet në nenin 10. Dokumentacioni lejon vlerësimin e përshtatshmërisë së instrumentit me kërkesat e duhura të kësaj direktive. Ai, për aq sa është e rëndësishme për një vlerësim të tillë, mbulon skicimin, prodhimin dhe funksionimin e instrumentit.

3. Prodhuesi vendos dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit.

Prodhimi

4. Prodhuesi përdor një sistem të miratuar të cilësisë për prodhimin, inspektimin e prodhimit përfundimtar dhe testimin e instrumentit matës në fjalë siç përcaktohet në paragrafin 5 dhe i nënshtrohet vrojtimit siç përcaktohet në paragrafin 6.

Sistemi i cilësisë

5.1. Prodhuesi paraqet një kërkesë për vlerësimin e sistemit të cilësisë pranë një organi të njoftuar të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përfshin:

- të gjithë informacionin e duhur për kategorinë e parashikuar të instrumentit;
- dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;
- dokumentacionin teknik të referuar në paragrafin 2.

5.2. Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e instrumenteve me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi dokumentohen në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e praktikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave mbi cilësinë.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të përshtatshëm të:

- objektivave të cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe autoritetin e administratës në lidhje me cilësinë e prodhimit;
- prodhimin, kontrollin të cilësisë dhe teknikave, proceseve dhe veprimeve sistematike të sigurimit të cilësisë që do të përdoren;
- shqyrtimeve dhe testeve që do të kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe shpeshësinë me të cilën ato do të kryhen;
- të dhënave mbi cilësinë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj;

— mjetet për vëzhgimin e arritjeve në lidhje me cilësinë e kërkuar të prodhimit dhe funksionimin e efektshëm të sistemit të cilësisë.

5.3 Organi i njoftuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai përmbush kërkesat të cilave iu referohen në paragrafin 5.2 Ai supozon përshtatshmëri me këto kërkesa në lidhje me nje sistem të cilësisë që është në përputhje me karakteristikat korresponduese të standardit kombëtar që zbaton standardin përketes të harmonizuar, nga momenti që referimet ndaj tij janë botuar.

Përveç përvojës në sistemet e administrimit të cilësisë, ekipi i kontrollit zotëron përvojë të përshtatshme në fushën përkatëse të metrologjisë e teknologjisë së instrumenteve dhe njohuri mbi kërkesat e zbatueshme të kësaj direktive. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në mjediset e prodhuesit.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

5.4. Prodhuesi merr përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej sistemit të cilësisë që është miratuar dhe për mirëmbajtjen e tij në mënyrë që ai të qëndrojë i përshtatshëm dhe efikas.

5.5. Prodhuesi informon organin e njoftuar që ka miratuar sistemin e cilësisë në lidhje me çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Organi i njoftuar vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë përmbush akoma kërkesat e referuara në paragrafin 3.2 ose nëse kërkohet një vlerësim i ri.

Ai njofton prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

Vëzhgimi nën përgjegjësinë e organit të njoftuar

6.1. Qëllimi i vëzhgimit është për t'u siguruar se prodhuesi përmbush detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë i miratuar.

6.2. Prodhuesi i lejon organit të njoftuar që të hyjë për qëllime inspektimi në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit e magazinimit dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

- dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
- dokumentacionin teknik të referuar në paragrafin 2;
- të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj;

6.3. Organi i njoftuar kryen kontrole periodike për t'u siguruar se prodhuesi e mirëmban dhe e përdor sistemin e cilësisë dhe i paraqet prodhuesit një raport të kontrollit.

6.4. Përveç kësaj, organi i njoftuar mund të kryejë vizita të papritura pranë prodhuesit. Gjatë vizitave të tilla, organi i njoftuar, nëse janë të nevojshme, mund të kryejë teste të prodhimeve ose të marrë masa për kryerjen e tyre, për të verifikuar se sistemi i cilësisë është duke funksionuar në rregull. Ai i paraqet prodhuesit një raport mbi vizitën, dhe një raport të testeve, nëse janë zhvilluar teste.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

7.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE”, shënime metrologjike shtesë dhe, nën përgjegjësinë e organit të njoftuar të referuar në paragrafin 5.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit, në secilin instrument matës që përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

7.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaramit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

8. Prodhuesi, për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit, duhet të vendosë në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

- dokumentacionin që i referohet në paragrafin 5.1, kryeradha e dytë;
- ndryshimin e referuar në paragrafin 5.5, siç është miratuar;
- vendimet dhe raportet nga organi i njoftuar që u referohen në paragrafët 5.5, 6.3 dhe 6.4.

9. Çdo organ i njoftuar periodikisht vendos në dispozicion të Shtetit Anëtar që e caktoi atë listën e miratimeve të sistemeve të cilësisë të lëshuar ose të refuzuar dhe njofton menjëherë Shtetin Anëtar që e caktoi atë për tërheqjen e një miratimi të një sistemi të cilësisë.

Përfaqësuesi i autorizuar

10. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafët 3, 5.1, 5.5, 7.2 dhe 8 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

SHTOJCA E

Deklarimi i përshtatshmërisë ndaj tipit mbështetur në sigurimin e cilësisë të inspektimit dhe testimit të prodhimit përfundimtar

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë ndaj tipit mbështetur në sigurimin e cilësisë së inspektimit dhe testimit të prodhimit përfundimtar” është pjesë e procedurës së vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkruara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë janë në përputhje me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Prodhimi

2. Prodhuesi përdor një sistem të miratuar të cilësisë siç përcaktohet në paragrafin 3 për inspektimin dhe testimin e prodhimit përfundimtar të instrumentit matës në fjalë dhe i nënshtrohet vërtimit siç përcaktohet në paragrafin 4.

Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi paraqet një kërkesë për vlerësimin e sistemit të cilësisë pranë një organi të njoftuar të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përfshin:

- të gjithë informacionin e duhur për kategorinë e parashikuar të instrumentit;
- dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;
- dokumentacionin teknik të tipit të miratuar dhe një kopje të certifikatës së shqyrtimit të tipit KE.

3.2. Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e instrumenteve me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi dokumentohen në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e praktikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave mbi cilësinë.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të përshtatshëm të:

- objektivave të cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe autoritetin e administratës në lidhje me cilësinë e prodhimit;
- shqyrtimeve dhe testeve që do të kryhen pas prodhimit;
- të dhënave mbi cilësinë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj;
- mjeteve për vëzhgimin e funksionimit të efektshëm të sistemit të cilësisë.

3.3. Organi i njoftuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai përmbush kërkesat të cilave iu referohen në paragrafin 3.2 Ai supozon përshtatshmëri me këto kërkesa në lidhje me një sistem të cilësisë që është në përputhje me karakteristikat korresponduese të standardit kombëtar që zbaton standardin përkatës të harmonizuar, nga momenti që referimet ndaj tij janë botuar.

Përveç përvojës në sistemet e administrimit të cilësisë, ekipi i kontrollit zotëron përvojë të përshtatshme në fushën përkatëse të metrologjisë e teknologjisë së instrumenteve dhe njohuri mbi kërkesat e zbatueshme të kësaj direktive. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në mjediset e prodhuesit.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhuesi merr përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej sistemit të cilësisë që është miratuar dhe për mirëmbajtjen e tij në mënyrë që ai të qëndrojë i përshtatshëm dhe i efikas.

3.5. Prodhuesi informon organin e njoftuar që ka miratuar sistemin e cilësisë në lidhje me çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Organi i njoftuar vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë i përmbush akoma kërkesat e referuara në paragrafin 3.2 ose nëse kërkohet një vlerësim i ri.

Ai njofton prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

Vëzhgimi nën përgjegjësinë e organit të njoftuar

4.1. Qëllimi i vëzhgimit është për t'u siguruar se prodhuesi përmbush detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë i miratuar.

4.2. Prodhuesi i lejon organit të njoftuar që të hyjë për qëllime inspektimi në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit e magazinimit dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

- dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
- të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj;

4.3. Organi i njoftuar kryen kontrole periodike për t'u siguruar se prodhuesi e mirëmban dhe e përdor sistemin e cilësisë dhe i paraqet prodhuesit një raport të kontrollit.

4.4. Përveç kësaj, organi i njoftuar mund të kryejë vizita të papritura pranë prodhuesit. Gjatë vizitave të tilla, organi i njoftuar, nëse janë të nevojshme, mund të kryejë testime të prodhimeve ose të marrë masa për kryerjen e tyre, për të verifikuar se sistemi i cilësisë është duke funksionuar në rregull. Ai i paraqet prodhuesit një raport mbi vizitën, dhe një raport të testimeve, nëse janë zhvilluar testime.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

5.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE”, shënime metrologjike shtesë dhe, nën përgjegjësinë e organit të njoftuar të referuar në paragrafin 3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit, në secilin instrument matës që është në përputhje me tipin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

5.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar. Një kopje e deklaramit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë, sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

6. Prodhuesi, për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit, duhet të vendosë në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

- dokumentacionin që i referohet në paragrafin 3.1, kryeradha e dytë;
- ndryshimin e referuar në paragrafin 3.5, siç është miratuar;
- vendimet dhe raportet nga organi i njoftuar që u referohen në paragrafet 3.5, nënparagrafi përfundimtar, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo organ i njoftuar periodikisht vendos në dispozicion të Shtetit Anëtar, që e caktoi atë, listën e miratimeve të sistemeve të cilësisë të lëshuar ose të refuzuar dhe njofton menjëherë Shtetin Anëtar që e caktoi atë, për tërheqjen e një miratimi të një sistemi të cilësisë.

Përfaqësuesi i autorizuar

8. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafët 3.1, 3.5, 5.2 dhe 6 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

SHTOJCA E1

Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në sigurimin e cilësisë të inspektimit dhe testimit të prodhimit përfundimtar

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në sigurimin e cilësisë së inspektimit dhe testimit të prodhimit përfundimtar” është procedura e vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkruara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Dokumentacioni teknik

2. Prodhuesi siguron dokumentacionin teknik siç përshkruhet në nenin 10. Dokumentacioni lejon vlerësimin e përshtatshmërisë së instrumentit me kërkesat e duhura të kësaj direktive. Ai, për aq sa është e rëndësishme për një vlerësim të tillë, mbulon skicimin, prodhimin dhe funksionimin e instrumentit.

3. Prodhuesi vendos dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit.

Prodhimi

4. Prodhuesi përdor një sistem të miratuar të cilësisë për prodhimin, inspektimin e prodhimit përfundimtar dhe testimin e instrumentit matës në fjalë siç përcaktohet në paragrafin 5 dhe i nënshtrohet vrojtimit siç përcaktohet në paragrafin 6.

Sistemi i cilësisë

5.1. Prodhuesi paraqet një kërkesë për vlerësimin e sistemit të cilësisë pranë një organi të njoftuar të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përfshin:

- të gjithë informacionin e duhur për kategorinë e parashikuar të instrumentit;
- dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;
- dokumentacionin teknik të referuar në paragrafin 2.

5.2. Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e instrumenteve me kërkesat e dhëna të kësaj direktive.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi dokumentohen në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e praktikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave mbi cilësinë.

Ky dokumentacion përmban veçanërisht një përshkrim të përshtatshëm të:

- objektivave të cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe autoritetin e administratës në lidhje me cilësinë e prodhimit;
- shqyrtimeve dhe testeve që do të kryhen pas prodhimit;
- të dhënave mbi cilësinë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj;
- mjeteve për vëzhgimin e funksionimit të efektshëm të sistemit të cilësisë.

5.3 Organi i njoftuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai përmbush kërkesat të cilave iu referohen në paragrafin 5.2 Ai supozon përshtatshmëri me këto kërkesa në lidhje me një sistem të cilësisë që është në përputhje me karakteristikat korresponduese të standardit kombëtar që zbaton standardin përkatës të harmonizuar, nga momenti që referimet ndaj tij janë botuar.

Përveç përvojës në sistemet e administrimit të cilësisë, ekipi i kontrollit zotëron përvojë të përshtatshme në fushën përkatëse të metrologjisë e teknologjisë së instrumenteve dhe njohuri mbi kërkesat e zbatueshme të kësaj direktive. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në mjediset e prodhuesit.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

5.4. Prodhuesi merr përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej sistemit të cilësisë që është miratuar dhe për mirëmbajtjen e tij në mënyrë që ai të qëndrojë i përshtatshëm dhe efikas.

5.5. Prodhuesi informon organin e njoftuar që ka miratuar sistemin e cilësisë në lidhje me çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Organi i njoftuar vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë përmbush akoma kërkesat e referuara në paragrafin 5.2 ose nëse kërkohet një vlerësim i ri.

Ai njofton prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

Vëzhgimi nën përgjegjësinë e organit të njoftuar

6.1. Qëllimi i vëzhgimit është për t'u siguruar se prodhuesi përmbush detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë i miratuar.

6.2. Prodhuesi i lejon organit të njoftuar që të hyjë për qëllime inspektimi në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit e magazinimit dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

- dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
- dokumentacionin teknik të referuar në paragrafin 2;
- të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj;

6.3. Organi i njoftuar kryen kontrole periodike për t'u siguruar se prodhuesi e mirëmban dhe e përdor sistemin e cilësisë dhe i paraqet prodhuesit një raport të kontrollit.

6.4. Përveç kësaj, organi i njoftuar mund të kryejë vizita të papritura pranë prodhuesit. Gjatë vizitave të tilla, organi i njoftuar, nëse janë të nevojshme, mund të kryejë teste të prodhimeve ose të marrë masa për kryerjen e tyre, për të verifikuar se sistemi i cilësisë është duke funksionuar në rregull. Ai i paraqet prodhuesit një raport mbi vizitën, dhe një raport të testeve, nëse janë zhvilluar teste.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

7.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE”, shënime metrologjike shtesë dhe, nën përgjegjësinë e organit të njoftuar të referuar në paragrafin 5.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit, në secilin instrument matës që përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

7.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklarimit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

8. Prodhuesi, për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit, duhet të vendosë në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

- dokumentacionin që i referohet në paragrafin 5.1, kryeradha e dytë;
- ndryshimin e referuar në paragrafin 5.5, siç është miratuar;
- vendimet dhe raportet nga organi i njoftuar që u referohen në paragrafët 5.5, 6.3 dhe 6.4.

9. Çdo organ i njoftuar periodikisht vendos në dispozicion të Shtetit Anëtar që e caktoi atë listën e miratimeve të sistemeve të cilësisë të lëshuar ose të refuzuar dhe njofton menjëherë Shtetin Anëtar që e caktoi atë për tërheqjen e një miratimi të një sistemi të cilësisë.

Përfaqësuesi i autorizuar

10. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafët 3, 5.1, 5.5, 7.2 dhe 8 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

SHTOJCA F

Deklarimi i përshtatshmërisë ndaj tipit mbështetur në verifikimin e prodhimit

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë ndaj tipit mbështetur në verifikimin e prodhimit” është pjesë e procedurës së vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkruara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë janë në përputhje me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Prodhimi

2. Prodhuesi përdor një sistem të miratuar të cilësisë siç përcaktohet në paragrafin 3 për inspektimin dhe testimin e prodhimit përfundimtar të instrumentit matës në fjalë dhe i nënshtrohet vërtimit siç përcaktohet në paragrafin 4.

Verifikimi

3. Një organ i njoftuar i zgjedhur nga prodhuesi kryen shqyrtimet dhe testimet e duhura ose merr masa për kryerjen e tyre, për të kontrolluar përshtatshmërinë e instrumenteve me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Shqyrtimet dhe testimet për të kontrolluar përputhshmërinë me kërkesat metrologjike kryhen, sipas zgjidhjes së prodhuesit, ose nëpërmjet shqyrtimit dhe testimit të çdo instrumenti siç përcaktohet në paragrafin 4, ose nëpërmjet shqyrtimit dhe testimit të instrumenteve mbi një bazë statistikore siç përcaktohet në paragrafin 5.

4. Verifikimi i përputhshmërisë me kërkesat metrologjike nëpërmjet shqyrtimit dhe testimit të çdo instrumenti

4.1. Të gjitha instrumentet matëse shqyrtohen individualisht dhe testimet e duhura siç përcaktohen në dokumentet e duhura të referuara në nenin 13 ose testime të barasvlershme duhet të kryhen për të verifikuar përshtatshmërinë e tyre me kërkesat metrologjike që zbatohen ndaj tyre. Në mungesë të një dokumenti të duhur, organi i njoftuar në fjalë vendos në lidhje me testimet e përshtatshme që kryhen.

4.2. Organi i njoftuar lëshon një certifikatë të përshtatshmërisë në lidhje me shqyrtimet dhe testimet e kryera dhe bashkon numrin e identifikimit të tij ndaj çdo instrumenti të miratuar ose merr masa për këtë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi mban certifikatat e përshtatshmërisë në dispozicion për inspektim nga autoritetet kombëtare për 10 vjet pas certifikimit të instrumentit.

5. Verifikimi statistikor i përputhshmërisë me kërkesat metrologjike

5.1. Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit të sigurojë njëtrajtshmërinë e çdo ngarkese të prodhuar dhe paraqet instrumentet matëse të tij për verifikim në formën e ngarkesave të njëtrajtshme.

5.2 Një mostër e rastësishme merret nga çdo ngarkesë sipas kërkesave të paragrafit 5.3. Të gjitha instrumentet matëse në mostër shqyrtohen individualisht dhe kryhen testime të përshtatshme siç përcaktohet në dokumentet e duhura të referuara në nenin 13 ose testime të barasvlershme për të përcaktuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat metrologjike që zbatohen për to dhe për të përcaktuar nëse ngarkesa pranohet ose refuzohet. Në mungesë të një dokumenti të duhur, organi i njoftuar në fjale vendos në lidhje me testimet e përshtatshme që kryhen.

5.3. Procedura statistikore përmbush kërkesat e mëposhtme:

Kontrolli statistikor mbështetet në atributet. Sistemi i mostrave siguron:

- një nivel të cilësisë që i korrespondon një probabiliteti të pranueshmërisë prej 95% me një jopërputhshmëri prej me pak se 1%;
- një cilësi kufi që i korrespondon një probabiliteti të pranueshmërisë prej 5% me një jo përputhshmëri prej më pak se 7%.

5.4. Nëse një ngarkesë pranohet, të gjithë instrumentet matëse në ngarkesë miratohen, përveç atyre instrumenteve nga mostra që u zbulua se nuk e kalojnë testimin.

Organi i njoftuar lëshon një certifikatë të përshtatshmërisë në lidhje me shqyrtimet dhe testimet e kryera dhe bashkon numrin e identifikimit të tij ndaj çdo instrumenti të miratuar ose merr masa për këtë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi mban certifikatat e përshtatshmërisë në dispozicion për inspektim nga autoritetet kombëtare për 10 vjet pas certifikimit të instrumentit.

5.5. Nëse një ngarkesë refuzohet, organi i njoftuar merr masat e duhura për të moslejuar nxjerrjen në treg të asaj ngarkese. Në rast të refuzimit të shpeshtë të ngarkesave, organi i njoftuar mund të pezullojë verifikimin statistikor dhe të marre masa të përshtatshme.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

6.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE” dhe shënime metrologjike shtesë në secilin instrument matës që është në përputhje me tipin e miratuar dhe përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive. 6.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklarimit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

Nëse pranohet nga organi i njoftuar i referuar në paragrafin 3, prodhuesi gjithashtu vendos numrin e identifikimit të organit të njoftuar në instrumentet matëse sipas përgjegjësisë së organit të njoftuar.

7. Prodhuesi, nëse pranohet nga organi i njoftuar dhe nën përgjegjësinë e tij, mund të vendos numrin e identifikimit të organit të njoftuar në instrumentet matëse gjatë procesit të prodhimit.

Përfaqësuesi i autorizuar

8. Detyrimet e prodhuesit mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, me përjashtim të detyrimeve që gjenden në paragrafët 2 dhe 5.1.

SHTOJCA F1

Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në verifikimin e prodhimit

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në verifikimin e prodhimit” është procedura e vlerësimit të përshtatshmërisë sipas së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkuara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse që u janë nënshtruar dispozitave të paragrafit 5 janë në përputhje me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Dokumentacioni teknik

2. Prodhuesi siguron dokumentacionin teknik siç përshkruhet në nenin 10. Dokumentacioni lejon vlerësimin e përshtatshmërisë së instrumentit me kërkesat e duhura të kësaj direktive. Ai, për aq sa është e rëndësishme për një vlerësim të tillë, mbulon skicimin, prodhimin dhe funksionimin e instrumentit.

3. Prodhuesi vendos dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit.

Prodhimi

4. Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë e instrumenteve të prodhuara me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Verifikimi

5. Një organ i njoftuar i zgjedhur nga prodhuesi kryen shqyrtimet dhe testimet e duhura ose merr masa për kryerjen e tyre, për të kontrolluar përshtatshmërinë e instrumenteve me llojin siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit të tipit KE dhe kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Shqyrtimet dhe testimet për të kontrolluar përputhshmërinë me kërkesat metrologjike kryhen, sipas zgjidhjes së prodhuesit, ose nëpërmjet shqyrtimit dhe testimit të çdo instrumenti siç përcaktohet në paragrafin 6, ose nëpërmjet shqyrtimit dhe testimit të instrumenteve mbi një bazë statistikore siç përcaktohet në paragrafin 7.

6. Verifikimi i përputhshmërisë me kërkesat metrologjike nëpërmjet shqyrtimit dhe testimit të çdo instrumenti

6.1. Të gjitha instrumentet matëse shqyrtohen individualisht dhe testimet e duhura siç përcaktohen në dokumentet e duhura të referuara në nenin 13 ose testime të barasvlershme duhet të kryhen për të verifikuar përshtatshmërinë e tyre me kërkesat metrologjike që zbatohen ndaj tyre.

Në mungesë të një dokumenti të duhur, organi i njoftuar në fjalë vendos në lidhje me testimet e përshtatshme që kryhen.

6.2. Organi i njoftuar lëshon një certifikatë të përshtatshmërisë në lidhje me shqyrtimet dhe testimet e kryera dhe bashkon numrin e identifikimit të tij ndaj çdo instrumenti të miratuar ose merr masa për këtë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi mban certifikatat e përshtatshmërisë në dispozicion për inspektim nga autoritetet kombëtare për 10 vjet pas certifikimit të instrumentit.

7. Verifikimi statistikor i përputhshmërisë me kërkesat metrologjike

7.1. Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit të sigurojë njëtrajtshmërinë e çdo ngarkese të prodhuar dhe paraqet instrumentet matëse të tij për verifikim në formën e ngarkesave të njëtrajtshme.

7.2 Një mostër e rastësishme merret nga çdo ngarkesë sipas kërkesave të paragrafit 5.3. Të gjitha instrumentet matëse në mostër shqyrtohen individualisht dhe kryhen testime të përshtatshme siç përcaktohet në dokumentet e duhura të referuara në nenin 13 ose testime të barasvlershme për të përcaktuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat metrologjike që zbatohen për to dhe për të përcaktuar nëse ngarkesa pranohet ose refuzohet. Në mungesë të një dokumenti të duhur, organi i njoftuar në fjalë vendos në lidhje me testimet e përshtatshme që kryhen.

7.3. Procedura statistikore përmbush kërkesat e mëposhtme:

Kontrolli statistikor mbështetet në atributet. Sistemi i mostrave siguron:

- një nivel të cilësisë që i korrespondon një probabiliteti të pranueshmërisë prej 95% me një jo përputhshmëri prej më pak se 1%;
- një cilësi kufi që i korrespondon një probabiliteti të pranueshmërisë prej 5% me një jo përputhshmëri prej më pak se 7%.

7.4. Nëse një ngarkesë pranohet, të gjithë instrumentet matëse në ngarkesë miratohen, përveç atyre instrumenteve nga mostra që u zbulua se nuk e kalojnë testimin.

Organi i njoftuar lëshon një certifikatë të përshtatshmërisë në lidhje me shqyrtimet dhe testimet e kryera dhe bashkon numrin e identifikimit të tij ndaj çdo instrumenti të miratuar ose merr masa për këtë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi mban certifikatat e përshtatshmërisë në dispozicion për inspektim nga autoritetet kombëtare për 10 vjet pas certifikimit të instrumentit.

7.5. Nëse një ngarkesë refuzohet, organi i njoftuar merr masat e duhura për të moslejuar nxjerrjen në treg të asaj ngarkese. Në rast të refuzimit të shpeshtë të ngarkesave, organi i njoftuar mund të pezullojë verifikimin statistikor dhe të marrë masa të përshtatshme.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

8.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE” dhe shënime metrologjike shtesë në secilin instrument matës që është në përputhje me tipin e miratuar dhe përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

8.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklarimit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

Nëse pranohet nga organi i njoftuar i referuar në paragrafin 5, prodhuesi gjithashtu vendos numrin e identifikimit të organit të njoftuar në instrumentet matëse sipas përgjegjësisë së organit të njoftuar.

9. Prodhuesi, nëse pranohet nga organi i njoftuar dhe nën përgjegjësinë e tij, mund të vendosë numrin e identifikimit të organit të njoftuar në instrumentet matëse gjatë procesit të prodhimit.

Përfaqësuesi i autorizuar

10. Detyrimet e prodhuesit mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, me përjashtim të detyrimeve që gjenden në paragrafët 4 dhe 7.1.

SHTOJCA G

Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në verifikimin e njësisë

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në verifikimin e njësisë” është procedura e vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkuara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se një instrument matës që i është nënshtruar dispozitave të paragrafit 4 është në përputhje me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Dokumentacioni teknik

2. Prodhuesi siguron dokumentacionin teknik siç përshkruhet në nenin 10 dhe e vendos atë në dispozicion të organit të njoftuar të referuar në paragrafin 4. Dokumentacioni teknik lejon vlerësimin e përshtatshmërisë së instrumentit me kërkesat e duhura të kësaj direktive dhe, për sa është e rëndësishme për një vlerësim të tillë, mbulon skicën, prodhimin dhe funksionimin e instrumentit.

Prodhuesi vendos dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për dhjetë vjet.

Prodhimi

3. Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë e instrumenteve të prodhuara me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Verifikimi

4. Një organ i njoftuar i zgjedhur nga prodhuesi kryen shqyrtimet dhe testimet e duhura siç përcaktohet në dokumentet e duhura të referuara në nenin 13 ose testime të barasvlershme, për të kontrolluar përshtatshmërinë e instrumentit me kërkesat e duhura të kësaj direktive ose merr masa për kryerjen e tyre. Në mungesë të një dokumenti të duhur, organi i njoftuar në fjalë vendos në lidhje me testimet e përshtatshme që kryhen.

Organi i njoftuar lëshon një certifikatë të përshtatshmërisë në lidhje me shqyrtimet dhe testimet e kryera dhe bashkon numrin e identifikimit të tij ndaj instrumentit të miratuar ose merr masa për këtë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi mban certifikatat e përshtatshmërisë në dispozicion për inspektim nga autoritetet kombëtare për 10 vjet pas certifikimit të instrumentit.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

5.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE”, shënime metrologjike shtesë dhe, nën përgjegjësinë e organit të njoftuar të referuar në paragrafin 4, numrin e identifikimit të këtij të fundit, në secilin instrument matës që përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

5.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklarimit dorëzohet bashkë me instrumentin matës.

Përfaqësuesi i autorizuar

6. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafët 2 dhe 4.2 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

SHTOJCA H

Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në sigurimin e cilësisë së plotë

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në sigurimin e cilësisë së plotë” është procedura e vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkuara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Prodhimi

2. Prodhuesi përdor një sistem të miratuar të cilësisë për skicimin, prodhimin dhe inspektimin e testimin e prodhimit përfundimtar të instrumentit matës në fjalë siç përcaktohet në paragrafin 3 dhe i nënshtrohet vrojtimit siç përcaktohet në paragrafin 4.

Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi paraqet një kërkesë për vlerësimin e sistemit të cilësisë pranë një organi të njoftuar të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përfshin:

- të gjithë informacionin e duhur për kategorinë e parashikuar të instrumentit;
- dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

3.2. Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e instrumenteve me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi dokumentohen në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e praktikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave mbi cilësinë. Ai përmban veçanërisht një përshkrim të përshtatshëm të:

- objektivave të cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe autoritetin e administratës në lidhje me cilësinë e skicimit dhe të prodhimit;
- karakteristikave të skicimit teknik, përfshirë standardeve që zbatohen dhe, atje ku dokumentet e duhura të referuara në nenin 13 nuk zbatohen plotësisht, mjeteve që përdoren për të siguruar se përmbushen kërkesat thelbësore të kësaj direktive që zbatohen ndaj instrumenteve;
- kontrollit të skicës dhe teknikave të verifikimit të skicës, proceseve dhe veprimeve sistematike që përdoren kur skicohen instrumente që kanë lidhje me kategorinë e instrumentit që mbulohet;
- shqyrtimeve dhe testeve që kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe shpeshtësinë me të cilën ato kryhen;
- teknikave përkatëse të prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike që përdoren;
- shqyrtimeve dhe testeve që kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe shpeshtësinë e tyre;
- të dhënave mbi cilësinë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënave të kalibrimit, raporteve të kualifikimit të personelit në fjalë, etj;
- mjeteve për vëzhgimin e arritjeve në lidhje me skicën dhe cilësinë e kërkuar të prodhimit dhe funksionimin e efektshëm të sistemit të cilësisë.

3.3. Organi i njoftuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai përmbush kërkesat të cilave iu referohen në paragrafin 3.2 Ai supozon përshtatshmëri me këto kërkesa në lidhje me një sistem të cilësisë që është në përputhje me karakteristikat korresponduese të standardit kombëtar që zbaton standardin përkatës të harmonizuar, nga momenti që referimet ndaj tij janë botuar.

Përveç përvojës në sistemet e administrimit të cilësisë, ekipi i kontrollit zotëron përvojë të përshtatshme në fushën përkatëse të metrologjisë e teknologjisë së instrumenteve dhe njohuri mbi kërkesat e zbatueshme të kësaj direktive. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në mjediset e prodhuesit.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhuesi merr përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej sistemit të cilësisë që është miratuar dhe për mirëmbajtjen e tij në mënyrë që ai të qëndrojë i përshtatshëm dhe i efikas.

3.5. Prodhuesi informon organin e njoftuar që ka miratuar sistemin e cilësisë në lidhje me çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Organi i njoftuar vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë përmbush akoma kërkesat e referuara në paragrafin 3.2 ose nëse kërkohet një vlerësim i ri.

Ai njofton prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

Vëzhgimi nën përgjegjësinë e organit të njoftuar

4.1. Qëllimi i vëzhgimit është për t'u siguruar se prodhuesi përmbush detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë i miratuar.

4.2. Prodhuesi i lejon organit të njoftuar që të hyjë për qëllime inspektimi në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit e magazinimit dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

- dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
- të dhënat mbi cilësinë siç parashikohen nga pjesa e skicimit e sistemit të cilësisë, të tilla si rezultate të analizave, përlogaritjeve, testimeve, etj.;
- të dhënat mbi cilësinë siç parashikohen nga pjesa e prodhimit e sistemit të cilësisë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj.;

4.3. Organi i njoftuar kryen kontrole periodike për t'u siguruar se prodhuesi e mirëmban dhe e përdor sistemin e cilësisë dhe i paraqet prodhuesit një raport të kontrollit.

4.4. Përveç kësaj, organi i njoftuar mund të kryejë vizita të papritura pranë prodhuesit. Gjatë vizitave të tilla, organi i njoftuar, nëse janë të nevojshme, mund të kryejë teste të prodhimeve ose të marrë masa për kryerjen e tyre, për të verifikuar se sistemi i cilësisë është duke funksionuar në rregull.

Ai i paraqet prodhuesit një raport mbi vizitën, dhe një raport të testimeve, nëse janë zhvilluar teste.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

5.1. Prodhuesi vendos shënimin "CE", shënime metrologjike shtesë dhe, nën përgjegjësinë e organit të njoftuar të referuar në paragrafin 3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit, në secilin instrument matës që përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

5.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklarimit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

6. Prodhuesi, për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit, duhet të vendosë në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

- dokumentacionin që i referohet në paragrafin 3.1, kryeradha e dytë;
- ndryshimin e referuar në paragrafin 3.5, siç është miratuar;
- vendimet dhe raportet nga organi i njoftuar që u referohen në paragrafët 3.5, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo organ i njoftuar periodikisht vendos në dispozicion të Shtetit Anëtar që e caktoi atë listën e miratimeve të sistemeve të cilësisë të lëshuar ose të refuzuar, dhe njofton menjëherë Shtetin Anëtar që e caktoi atë për tërheqjen e një miratimi të një sistemi të cilësisë.

Përfaqësuesi i autorizuar

8. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafët 3.1, 3.5, 5.2 dhe 6 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

SHTOJCA H1

Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në sigurimin e cilësisë së plotë plus shqyrtimin e skicës

1. “Deklarimi i përshtatshmërisë mbështetur në sigurimin e cilësisë së plotë plus shqyrtimin e skicës” është procedura e vlerësimit të përshtatshmërisë sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përshkruara në këtë shtojcë dhe siguron e deklaron se instrumentet matëse në fjalë përmbushin kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Prodhimi

2. Prodhuesi përdor një sistem të miratuar të cilësisë për skicimin, prodhimin dhe inspektimin e testimin e prodhimit përfundimtar të instrumentit matës në fjalë siç përcaktohet në paragrafin 3 dhe i nënshtrohet vrojtimit siç përcaktohet në paragrafin 5. Përshtatshmëria e skicës teknike të instrumentit matës shqyrtohet në përputhje me dispozitat e paragrafit 4.

Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi paraqet një kërkesë për vlerësimin e sistemit të cilësisë pranë një organi të njoftuar të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përfshin:

- të gjithë informacionin e duhur për kategorinë e parashikuar të instrumentit;
- dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

3.2. Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e instrumenteve me kërkesat e duhura të kësaj direktive.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi dokumentohen në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e praktikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave mbi cilësinë. Ai përmban veçanërisht një përshkrim të përshtatshëm të:

- objektivave të cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe autoritetin e administratës në lidhje me skicimin dhe cilësinë e prodhimit;
- karakteristikave të skicimit teknik, përfshirë standardet që zbatohen dhe, atje ku dokumentet e duhura të referuara në nenin 13 nuk zbatohen plotësisht, mjeteve që përdoren për të siguruar se përmbushen kërkesat thelbësore të kësaj direktive që zbatohen ndaj instrumenteve;
- kontrollit të skicës dhe teknikave të verifikimit të skicës, proceseve dhe veprimeve sistematike që përdoren kur skicohen instrumente që kanë lidhje me kategorinë e instrumentit që mbulohet;
- prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe teknikave, proceseve dhe veprimeve sistematike të sigurimit të cilësisë që përdoren;
- teknikave përkatëse të prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike që përdoren;
- shqyrtimeve dhe testeve që kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe shpeshësinë me të cilën ato kryhen;

- të dhënave mbi cilësinë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënave të kalibrimit, raporteve të kualifikimit të personelit në fjalë, etj;
- mjetet për vëzhgimin e arritjeve në lidhje me cilësinë e kërkuar të prodhimit dhe funksionimin e efektshëm të sistemit të cilësisë.

3.3. Organi i njoftuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai përmbush kërkesat të cilave iu referohen në paragrafin 3.2 Ai supozon përshtatshmëri me këto kërkesa në lidhje me një sistem të cilësisë që është në përputhje me karakteristikat korresponduese të standardit kombëtar që zbaton standardin përkatës të harmonizuar, nga momenti që referimet ndaj tij janë botuar në Gazetën Zyrtare.

Përveç përvojës në sistemet e administrimit të cilësisë, ekipi i kontrollit zotëron përvojë të përshtatshme në fushën përkatëse të metrologjisë e teknologjisë së instrumenteve dhe njohuri mbi kërkesat e zbatueshme të kësaj direktive. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në mjediset e prodhuesit.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhuesi merr përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej sistemit të cilësisë që është miratuar dhe për mirëmbajtjen e tij në mënyre që ai të qëndrojë i përshtatshëm dhe efikas.

3.5. Prodhuesi informon organin e njoftuar që ka miratuar sistemin e cilësisë në lidhje me çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Organi i njoftuar vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë përmbush akoma kërkesat e referuara në paragrafin 3.2 ose nëse kërkohet një vlerësim i ri.

Ai njofton prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban përfundimet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.6. Çdo organ i njoftuar periodikisht vendos në dispozicion të Shtetit Anëtar që e caktoi atë listën e miratimeve të sistemeve të cilësisë të lëshuar ose të refuzuar dhe njofton menjëherë Shtetin Anëtar që e caktoi atë për tërheqjen e një miratimit të një sistemi të cilësisë.

Shqyrtimi i skicës

4.1 Prodhuesi paraqet një kërkesë për shqyrtimin e skicës pranë organit të njoftuar të referuar në paragrafin 3.1.

4.2. Kërkesa lejon kuptimin e skicës, prodhimit dhe funksionimit të instrumentit dhe lejon vlerësimin e përshtatshmërisë me kërkesat e duhura të kësaj direktive. Ajo përfshin:

- emrin dhe adresën e prodhuesit;
- një deklaratë me shkrim se e njëjta kërkesë nuk është paraqitur pranë ndonjë organi tjetër të njoftuar;
- dokumentacionin teknik siç përshkruhet në nenin 10. Dokumentacioni bën të mundur vlerësimin e përshtatshmërisë së instrumentit me kërkesat e duhura të kësaj direktive. Ai, për aq sa është e rëndësishme për një vlerësim të tillë, mbulon skicimin, prodhimin dhe funksionimin e instrumentit;
- provat mbështetëse për përshtatshmërisë e skicës teknike. Këto prova mbështetëse përmendin çdo dokument të duhur që është zbatuar, në veçanti atje ku dokumentet e duhura të referuara në nenin 13 nuk janë zbatuar të plota, dhe përfshijnë, atje ku është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera nga laboratorit i përshtatshëm i prodhuesit ose nga ndonjë laborator tjetër testues për llogaritë të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.

4.3 Organi i njoftuar shqyrton kërkesën dhe atje ku skica përmbush dispozitat e direktivës që zbatohen për instrumentin matës lëshon për prodhuesin një certifikatë të shqyrtimit të skicës KE. Certifikata përmban emrin dhe adresën e prodhuesit, përfundimet e shqyrtimit, çdo kusht për vlefshmërinë e tij dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e instrumentit të miratuar.

4.3.1 Të gjitha pjesët e dokumentacionit teknik i bashkëngjiten certifikatës.

4.3.2 Certifikata ose shtojcat e saj përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për vlerësimin epërshtatshmërisë dhe kontrollin e shërbimit. Ajo lejon vlerësimin e përshtatshmërisë së instrumenteve të prodhuara me skicën e shqyrtuar në lidhje me riprodhueshmërinë e funksioneve metrologjike të tyre, kur përditësohen siç duhet duke përdorur mjetet e përshtatshme, përfshirë:

- karakteristikat metrologjike të skicës së instrumentit;
- masat e kërkuara për sigurimin e integritetit të instrumenteve (vulosja, identifikimi i programit kompjuterik...);
- informacion mbi elementet e tjera të nevojshme për identifikimin e instrumenteve dhe për të kontrolluar përputhshmërinë e jashtme vizuale të tyre me skicën;
- nëse është e përshtatshme, çdo informacion të veçantë të nevojshëm për të verifikuar karakteristikat e instrumenteve të prodhuar;
- në rastin e një njësie, të gjithë informacionin e nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me njësitë ose instrumente matëse të tjerë.

4.3.3 Organi i njoftuar harton një raport të vlerësimit në lidhje me këtë dhe e vendos atë në dispozicion të Shtetit Anëtar që e caktoi atë. Pa cenuar nenin 12 pika 8, organi i njoftuar bën publike përmbajtjen e këtij raporti, të plotë ose të pjesshëm, vetëm me pëlqimin e prodhuesit.

Certifikata ka një vlefshmëri prej dhjetë vjetësh nga data e lëshimit dhe mund të përsëritet për periudha të mëvonshme prej dhjetë vjetësh secila.

Nëse prodhuesit i refuzohet një certifikate për shqyrtimin e skicës, organi i njoftuar jep arsye të hollësishme për refuzimin.

4.4 Prodhuesi informon organin e njoftuar që ka lëshuar certifikatën e shqyrtimit të skicës KE për çdo ndryshim thelbësor në skicën e miratuar. Ndryshimet në skicën e miratuar duhet të marrin miratimin shtesë nga organi i njoftuar që lëshoi certifikatën e shqyrtimit të skicës KE atje ku ndryshime të tilla mund të ndikojnë në përputhshmërinë me kërkesat thelbësore të kësaj direktive, kushtet për vlefshmërinë e certifikatës ose kushtet e parashikuar për përdorimin e instrumentit. Ky miratim shtesë jepet në formën e një shtesë ndaj certifikatës origjinale të shqyrtimit të skicës KE.

4.5. Çdo organ i njoftuar vendos në dispozicion periodikisht ndaj Shtetit Anëtar që e caktoi atë:

- certifikatën e shqyrtimit të skicës KE dhe shtojcat e lëshuara;
- shtesat dhe ndryshimet në lidhje me certifikatat e lëshuara.

Çdo organ i njoftuar njofton menjëherë Shtetin Anëtar që e ka caktuar atë për tërheqjen e një certifikate të shqyrtimit të skicës KE.

4.6 Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij mban një kopje të certifikatës së shqyrtimit të skicës KE, shtojcat e saj dhe shtesave me dokumentacionin teknik për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit matës të fundit.

Atje ku as prodhuesi, as përfaqësuesi i autorizuar i tij nuk është i vendosur brenda Komunitetit, detyrimi për të vendosur në dispozicion dokumentacionin teknik sipas kërkesës është përgjegjësi e personit të caktuar nga prodhuesi.

Vëzhgimi nën përgjegjësinë e organit të njoftuar

5.1. Qëllimi i vëzhgimit është për t'u siguruar se prodhuesi përmbush detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë i miratuar.

5.2. Prodhuesi i lejon organit të njoftuar që të hyjë për qëllime inspektimi në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit e magazinimit dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

— dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

— të dhënat mbi cilësinë siç parashikohen nga pjesa e skicimit e sistemit të cilësisë, të tilla si rezultate të analizave, përlogaritjeve, testimeve, etj.;

— të dhënat mbi cilësinë siç parashikohen nga pjesa e prodhimit e sistemit të cilësisë, të tilla si raporte të inspektimit dhe informacion mbi testimet, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj.;

5.3. Organi i njoftuar kryen kontrole periodike për t'u siguruar se prodhuesi e mirëmban dhe e përdor sistemin e cilësisë dhe i paraqet prodhuesit një raport të kontrollit.

5.4. Përveç kësaj, organi i njoftuar mund të kryejë vizita të papritura pranë prodhuesit. Gjatë vizitave të tilla, organi i njoftuar, nëse janë të nevojshme, mund të kryejnë teste të prodhimeve ose të marrin masa për kryerjen e tyre, për të verifikuar se sistemi i cilësisë është duke funksionuar në rregull. Ai i paraqet prodhuesit një raport mbi vizitën, dhe një raport të testimeve, nëse janë zhvilluar teste.

Deklarimi me shkrim i përshtatshmërisë

6.1. Prodhuesi vendos shënimin “CE”, shënime metrologjike shtesë dhe, nën përgjegjësinë e organit të njoftuar të referuar në paragrafin 3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit, në secilin instrument matës që përmbush kërkesat e duhura të kësaj direktive.

6.2. Një deklaram i përshtatshmërisë hartohet për secilin model të instrumentit dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit. Ai identifikon modelin e instrumentit për të cilin është hartuar dhe përmend numrin e certifikatës së shqyrtimit të skicës.

Një kopje e deklarimit dorëzohet me secilin instrument matës që nxirret në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale, në ato raste kur një numër i madh instrumentesh dorëzohet pranë një përdoruesi të vetëm.

7. Prodhuesi, për 10 vjet pas prodhimit të instrumentit të fundit, duhet të vendos në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

— dokumentacionin që i referohet në paragrafin 3.1, kryeradha e dytë;

— ndryshimin e referuar në paragrafin 3.5, siç është miratuar;

— vendimet dhe raportet nga organi i njoftuar që u referohen në paragrafët 3.5, 5.3 dhe 5.4.

Përfaqësuesi i autorizuar

8. Detyrimet e prodhuesit që përmbahen në paragrafët 3.1, 3.5, 6.2 dhe 7 mund të përmbushen, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nga përfaqësuesi i autorizuar i tij.

SHTOJCA MI-001

Kontatorët e ujit

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I, kërkesat e veçanta të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në këtë shtojcë zbatohen për kontatorët e ujit që janë të synuar për matjen e vëllimit të ujit të pastër, të ftohte ose të ngrohtë në përdorimin për banorët, përdorimin tregtar dhe atë të industrisë së lehtë

PERKUFIZIMET

Kontatori i ujit: një instrument i krijuar për të matur, ruajtur dhe shfaqur vëllimin në kushte të matjes së ujit që kalon nëpërmjet treguesit të matjes.

Niveli minimal i rrjedhjes (Q1): niveli më i ulët i rrjedhjes në të cilin kontatori i ujit siguron të dhënat që janë në përputhje me kërkesat në lidhje me gabimet maksimale të lejueshme (MPE-të.)

Niveli kalimtar i rrjedhjes (Q2): niveli kalimtar i rrjedhjes është vlera e nivelit të rrjedhjes që ndodh ndërmjet nivelit të përhershëm të rrjedhjes dhe nivelit minimal të rrjedhjes, në të cilën sfera e nivelit të rrjedhjes ndahet në dy zona, “zona e sipërme” dhe “zona e poshtme”. Çdo zonë ka një MPE të caktuar.

Niveli i përhershëm i rrjedhjes (Q3): niveli më i lartë i rrjedhjes në të cilën kontatori i ujit funksionon në një mënyrë të kënaqshme në kushtet normale të përdorimit, d.m.th. në kushte të një rrjedhje të vazhdueshme ose të ndërprerë.

Niveli i mbingarkuar i rrjedhjes (Q4): niveli i mbingarkuar i rrjedhjes është niveli më i lartë i rrjedhjes në të cilin kontatori funksionon në një mënyrë të kënaqshme për një periudhë të shkurtër kohe pa u prishur.

KËRKESAT E VEÇANTA

Kushtet e deklaruara të funksionimit

Prodhuesi përcakton kushtet e deklaruara të funksionimit për instrumentin, në veçanti;

1. Sferën e nivelit të rrjedhjes së ujit.

Vlerat për sferën e nivelit të rrjedhjes përmbushin kushtet e mëposhtme:

$$Q3/Q1 \geq 10$$

$$Q2/Q1 = 1,6$$

$$Q4/Q3 = 1,25$$

Për 5 vjet nga data e hyrjes në fuqi e kësaj direktive raporti Q2/Q1 mund të jetë: 1,5, 2,5, 4 ose 6,3.

2. Sfera e temperaturës së ujit.

Vlerat për sferën e temperaturës përmbushin kushtet e mëposhtme:

0,1 °C deri në të paktën 30 °C, ose

30 °C deri në të paktën 90 °C.

Kontatori mund të skicohet që të funksionojë në të dy sferat.

3. Sfera relative e presionit të ujit është 0.3 bar deri në të paktën 10 bar në Q3.

4. Për furnizimin me energji elektrike: vlera nominale e furnizimit të voltazhit AC dhe/ose kufij të furnizimit DC.

MPE

5. MPE, pozitive ose negative, në vëllimet e dërguara në nivelin e rrjedhjes ndërmjet nivelit kalimtar të rrjedhjes (Q2) (i përfshirë) dhe nivelit të mbingarkuar të rrjedhjes (Q4) është:

2 % për ujin që ka një temperaturë ≤ 30 °C,

3 % për ujin që ka një temperaturë ≥ 30 °C.

6. MPE, pozitive ose negative, në vëllimet e dërguara në nivelin e rrjedhjes ndërmjet nivelit minimal të rrjedhjes (Q1) dhe nivelit kalimtar të rrjedhjes (Q2) (i përjashtuar) është 5 % për ujin që ka çdo lloj temperature.

Ndikimet e lejueshëm të trazimeve

7.1. Përjashtimi elektromagnetik

7.1.1. Ndikimi i trazimit elektromagnetik në një kontator të ujit është i tillë që:

— ndryshimi në rezultatin e matjes është jo më i madh sesa vlera kritike e ndryshimit siç përcaktohet në 8.1.4, ose

— treguesi i rezultatit të matjes është i tillë që nuk mund të interpretohet si një rezultat i vlefshëm, i tillë si një luhajtje e momentit që nuk mund të interpretohet, regjistrohet ose transmetohet si një rezultat i matshëm.

7.1.2. Pas kalimit të një trazimi elektromagnetik kontatori i ujit:

— rifillon të funksionojë brenda MPE-së, dhe

— ruan të gjitha funksionet e matjes, dhe

— lejon rimarrjen e të gjitha të dhënave të matjes që ishin paraqitur pak përpara trazimit.

7.1.3. Vlera kritike e ndryshimit është më e vogla e dy vlerave të mëposhtme:

— vëllimi që i korrespondon gjysmës së madhësisë së MPE-së në zonën e sipërme të vëllimit të matur;

— vëllimi që i korrespondon MPE-së në vëllimin që i korrespondon një minute të nivelit të rrjedhjes Q3.

7.2. Qendrueshmëria

Pasi është kryer një testim i përshtatshëm, duke marrë parasysh periudhën e kohës, të vlerësuar nga prodhuesi, përmbushen kriteret e mëposhtme:

7.2.1. Luhajtja e rezultatit të matjes pas testimit të qëndrueshmërisë, kur krahasohet me rezultatin fillestar të matjes, nuk duhet të kapërcejë:

— 3 % të vëllimit të kontatorit ndërmjet Q1 të përfshirë dhe Q2 të përjashtuar;

— 1,5 % të vëllimit të kontatorit ndërmjet Q2 të përfshirë dhe Q4 të përjashtuar.

7.2.2. Gabimi i treguesit për vëllimin e kontatorit pas testimit të qëndrueshmërisë nuk duhet të kapërcejë:

— $\square \pm 6$ % të vëllimit të kontatorit ndërmjet Q1 të përfshirë dhe Q2 të përjashtuar;

— $\square \pm 2,5$ % të vëllimit të kontatorit ndërmjet Q2 të përfshirë dhe Q4 të përjashtuar për kontatorët e ujit që planifikohet të masin ujin me një temperaturë ndërmjet 0,1 °C dhe 30 °C,

— $\square \pm 3,5$ % të vëllimit të kontatorit ndërmjet Q2 të përfshirë dhe Q4 të përjashtuar për kontatorët e ujit që planifikohet të masin ujin me një temperaturë ndërmjet 30 °C dhe 90 °C.

Përshtatshmëria

8.1. Kontatori duhet të të instalohet për të funksionuar në çdo pozicion, përveçse kur është shënuar qartë ndryshe.

8.2. Prodhuesi përcakton nëse kontatori është synuar të masë rrjedhën në kahun e kundërt. Në një rast të tillë, vëllimi i rrjedhës në kahun e kundërt ose zbritet nga vëllimi i grumbulluar ose regjistrohet veçmas. I njëjti MPE përdoret për rrjedhën në kahun e duhur dhe në kahun e kundërt.

Kontatorët e ujit që nuk janë synuar për matjen e rrjedhës në kahun e kundërt ose parandalojnë rrjedhjen në kahun e kundërt ose i bëjnë ballë një rrjedhje të rastësishme në kahun e kundërt pa ndonjë prishje ose ndryshim të karakteristikave metrologjike.

Njësitë e matjes

9. Vëllimi i matur shprehet në metra kub.

Vendosja në përdorim

10. Shteti Anëtar siguron se kërkesat në pikën 1, 2 dhe 4 përcaktohen nga shpërndarësi ose personi i caktuar ligjërisht për instalimin e kontatorit, në mënyrë që kontatori të jetë i përshtatshëm për matjen e saktë të konsumit që është i parashikuar ose i parashikueshëm.

VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË

Procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të referuara në nenin 9 që prodhuesi mund të zgjedhë janë:

B + F ose B + D ose H1.

SHTOJCA MI-002

Kontatorët e gazit dhe pajisjet e konvertimit të vëllimit

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I, kërkesat e veçanta të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në këtë shtojcë zbatohen për kontatorët e gazit dhe pajisjet e konvertimit të vëllimit që përcaktohen më poshtë, të synuar për përdorimin për banorët, përdorimin tregtar dhe atë të industrisë së lehtë.

PËRKUFIZIMET

Kontatori i gazit: një instrument i krijuar për të matur, ruajtur dhe shfaqur sasinë e gazit për ngrohje (vëllimin ose masën) që ka kaluar në të.

Pajisja e konvertimit: një pajisje e vendosur në kontatorin e gazit që automatikisht konverton sasinë e matur në kushtet e matjes në një sasi në kushtet bazë.

Niveli minimal i rrjedhjes (Q_{min}): niveli më i ulët i rrjedhjes në të cilin kontatori i gazit siguron të dhënat që janë në përputhje me kërkesat në lidhje me gabimin maksimal të lejueshëm (MPE)

Niveli maksimal i rrjedhjes (Q_{max}): niveli më i lartë i rrjedhjes në të cilin kontatori i gazit siguron të dhënat që janë në përputhje me kërkesat në lidhje me gabimin maksimal të lejueshëm (MPE)

Niveli kalimtar i rrjedhjes (Q_t): niveli kalimtar i rrjedhjes është niveli i rrjedhjes që ndodh ndërmjet nivelit maksimal dhe minimal të rrjedhjes, në të cilën sfera e nivelit të rrjedhjes ndahet në dy zona, “zona e sipërme” dhe “zona e poshtme” Çdo zonë ka një MPE të caktuar.

Niveli i mbingarkuar i rrjedhjes (Q_r): niveli i mbingarkuar i rrjedhjes është niveli më i lartë i rrjedhjes në të cilin kontatori funksionon për një periudhë të shkurtër kohe pa u prishur.

Kushtet bazë

Kushtet e caktuara në të cilat konvertohet sasia e matur e lëngut.

Kushtet e deklaruara të funksionimit

Prodhuesi përcakton kushtet e deklaruara të funksionimit të kontatorit të gazit, duke marrë parasysh:

1.1 Sferat e nivelit të rrjedhjes përmbushin kushtet e mëposhtme:

Klasa Q_{max}/Q_{min} Q_{max}/Q_t Q_r/Q_{max}

1,5 \geq 150 \geq 10 1,2

1,0 \geq 20 \geq 5 1,2

1.2. Sfera e temperaturës së gazit, me një sferë minimal prej 40 °C.

1.3. Kushtet e lidhura me ngrohjen/gazin

Kontatori i gazit krijohet për sferën e gazeve dhe presionet e furnizimit të vendit të destinacionit. Në veçanti prodhuesi tregon:

- familjen ose grupin e gazit;
- presionin maksimal të funksionimit.

1.4. Një sferë minimale të temperaturës prej 50 °C për mjedisin klimatik.

1.5. Vlera nominale e furnizimit të voltazhit AC dhe/ose kufij të furnizimit DC.

2. Gabimi maksimal i lejueshëm (MPE-të)

2.1 Kontatori i gazit që tregon vëllimin në kushtet ose masën e matjes

Tabela 1

Klasa 1,5 1,0

$Q_{min} \leq Q < Q_t$ 3 % 2 %

$Q_t \leq Q < Q_{max}$ 1,5 % 1 %

Kur gabimet ndërmjet Q_t dhe Q_{max} kanë të gjitha të njëjtën shenjë, ato të gjitha nuk kapërcejnë 1% për klasën 1.5 dhe 0,5 % për klasën 1,0.

2.2. Për një kontator gazi me konvertimin e temperaturës, e cila tregon vetëm vëllimin e konvertuar, MPE e kontatorit rritet me 0,5 % në një sferë prej 30 °C duke u shtrirë në mënyrë simetrike rreth temperaturës së përcaktuar nga prodhuesi që shtrihet ndërmjet 15 °C dhe 25 °C. Jashtë kësaj sfere, lejohet një rritje tjetër prej 0,5 % në çdo interval prej 10 °C.

3. Ndikimet e lejueshme të trazimeve

3.1. Përrjashtimi elektromagnetik

3.1.1. Ndikimi i trazimit elektromagnetik në një kontator të gazit ose pajisje të konvertimit të vëllimit është i tillë që:

- ndryshimi në rezultatin e matjes është jo më i madh sesa vlera kritike e ndryshimit siç përcaktohet në 3.1.3, ose
- treguesi i rezultatit të matjes është i tillë që nuk mund të interpretohet si një rezultat i vlefshëm, i tillë si një luhajtje e momentit që nuk mund të interpretohet, regjistrohet ose transmetohet si një rezultat i matshëm.

3.1.2. Pas kalimit të një trazimi elektromagnetik kontatori i gazit:

- rifillon të funksionojë brenda MPE-së, dhe
- ruan të gjitha funksionet e matjes, dhe
- lejon rimarrjen e të gjitha të dhënave të matjes që ishin paraqitur pak përpara trazimit.

3.1.3. Vlera kritike e ndryshimit është më e vogla e dy vlerave të mëposhtme:

- vëllimi që i korrespondon gjysmës së madhësisë së MPE-së në zonën e sipërme të vëllimit të matur ;
- vëllimi që i korrespondon MPE-së në vëllimin që i korrespondon një minute të nivelit të rrjedhjes Q3.

3.2. Ndikimi i trazimeve të rrjedhjes së sipërme dhe të poshtme

Sipas kushteve të instalimit të përcaktuara nga prodhuesi, ndikimi i trazimeve të rrjedhjes nuk duhet të kapërcejë një të tretën e MPE-së

4. Qëndrueshmëria

Pasi është kryer një testim i përshtatshëm duke marrë parasysh periudhën e kohës, të vlerësuar nga prodhuesi, përmbushen kriteret e mëposhtme:

4.1. Klasa 1,5 metra

4.1.1. Luhatja e rezultatit të matjes pas testimit të qëndrueshmërisë kur krahasohet me rezultatin e matjes fillestare për nivelet e rrjedhjes së sferës Q_t deri në Q_{max} nuk kapërcen rezultatin e matjes prej më shumë se 2%.

4.1.2. Gabimi i treguesit pas testimit të qëndrueshmërisë nuk kapërcen dy herë MPE-në në paragrafin 2.

4.2. Klasa kontatori 1,0

4.2.1. Luhatja e rezultatit të matjes pas testimit të qëndrueshmërisë kur krahasohet me rezultatin e matjes fillestare nuk kapërcen një të tretën e MPE-së në paragrafin 2.

4.2.2. Gabimi i treguesit pas testimit të qëndrueshmërisë nuk kapërcen MPE-në në paragrafin 2.

5. Përshtatshmëria

5.1. Një kontator i gazit që punon me korrent (AC ose DC) pajiset me një mekanizëm të furnizimit me energji në rast emergjence ose mjete të tjera për të siguruar se të gjitha funksionet e matjes ruhen gjatë një avarie të burimit kryesor të energjisë.

5.2. Një burim i dedikuar i energjisë ka një jetëgjatësi prej të paktën pesë vjetësh. Pas 90% të jetëgjatësisë së tij, shfaqet një paralajmërim i duhur.

5.3. Një pajisje treguese ka një numër të mjaftueshëm shifrash për të siguruar se sasia që kalon gjatë 8 000 orësh në Q_{max} nuk i kthen shifrat në vlerat fillestare të tyre.

5.4. Kontatori i gazit instalohet për të funksionuar në çdo pozicion të deklaruar nga prodhuesi në udhëzimin e instalimit të tij.

5.5. Kontatori i gazit ka një element të testimit, i cili lejon kryerjen e testeve në një kohe të arsyeshme.

5.6. Kontatori i gazit respekton MPE-në në çdo drejtim të rrjedhjes ose vetëm në një drejtim të rrjedhjes të shënuar qartë.

6. Njësitë

Sasia e matur shfaqet në metra kub ose kilogramë.

PJESA II — KËRKESAT E VEÇANTA — PAJISJET E KONVERTIMI TË VËLLIMIT

Një pajisje e konvertimit të vëllimit përben një njësi sipas nenit 4, përkufizimit (b), kryeradha e dytë.

Për një pajisje të konvertimit të vëllimit, zbatohen kërkesat thelbësore për kontatorin e gazit, nëse janë të zbatueshme. Përveç tyre, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

7. Kushtet bazë për sasi të konvertuara

Prodhuesi përcakton kushtet bazë për sasi të konvertuara.

8. MPE

— 0,5 % në temperaturën e mjedisit $20\text{ }^{\circ}\text{C} \pm 3\text{ }^{\circ}\text{C}$, lagështira e mjedisit $60\% \pm 15\%$, vlerat nominale për furnizimin me energji;

— 0,7 % për pajisjet e konvertimit të temperaturës në kushtet e vlerësuara të funksionimit;

— 1 % për pajisjet e tjera të konvertimit në kushtet e vlerësuara të funksionimit.

Shënim: Gabimi i kontatorit të gazit nuk mbahet parasysh.

9. Përshtatshmëria

9.1. Një pajisje konvertimi elektronike është në gjendje për të zbuluar se kur është duke funksionuar jashtë sferës/sferave të funksionimit të deklaruar nga prodhuesi për parametrat që janë të rëndësishme për saktësinë e matjes. Në një rast të tillë, pajisja e konvertimit duhet të ndalojë së bashkuari sasinë e konvertuar dhe mund të llogarisë veçmas shumën e përgjithshme të sasisë së konvertuar për kohën kur është duke funksionuar jashtë sferës/sferave të funksionimit.

9.2. Një pajisje konvertimi elektronike është në gjendje për të shfaqur të gjitha të dhënat e rëndësishme për matjen pa pajisje shtesë.

PJESA III — VENDOSJA NË PËRDORIM DHE VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË

Vendosja në përdorim

10. (a) Atje ku një Shtet Anëtar imponon matje të përdorimit për banim, ai lejon që matje të tilla të kryhen nëpërmjet çdo kontatori të Klasës 1.5 dhe të Klasës 1,0, të cilat kanë një raport Q_{\max}/Q_{\min} të barabartë ose më të madh se 150.

(b) Atje ku një Shtet Anëtar imponon matje të përdorimit për tregti dhe/ose përdorimin industrial të lehtë, ai lejon që matje të tilla të kryhen nga çdo kontator i Klasës 1.5.

(c) Në lidhje me kërkesat sipas paragrafit 1.2 dhe 1.3, Shtetet Anëtare sigurohen se karakteristikat të përcaktohen nga shpërndarësi ose personi i caktuar ligjërish për instalimin e kontatorit, në mënyrë që kontatori të jetë i përshtatshëm për matjen e saktë të konsumit që është i parashikuar ose i parashikueshëm.

VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË

Procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të referuara në nenin 9 që prodhuesi mund të zgjedhë janë:

B + F ose B + D ose H1.

SHTOJCA MI-003

Kontatorët aktivë të energjisë elektrike

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I, kërkesat e veçanta të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në këtë shtojcë zbatohen për kontatorët aktivë të energjisë elektrike të synuar për përdorimin për banorët, përdorimin tregtar dhe atë të industrisë së lehtë.

Shënim: Kontatorët e energjisë elektrike mund të përdoren në kombinim me instrumente transformatorë të jashtëm, në varësi të teknikës së matjes të përdorur. Megjithatë, kjo shtojcë mbulon vetëm kontatorët e energjisë elektrike, por jo instrumentet matëse transformatore.

PËRKUFIZIMET

Një kontator aktiv i energjisë elektrike është një pajisje e cila mat energjinë elektrike aktive të konsumuar në një qark.

I = korrenti elektrik që kalon nëpërmjet kontatorit;

I_n = korrenti i përcaktuar i referimit për të cilin është krijuar kontatori që funksionon në transformator;

I_{st} = vlera më e ulët e deklaruar e I në të cilën kontatori regjistron energjinë elektrike aktive në një faktor të njësisë së energjisë (kontatorë me shumë faza me ngarkesë të ekuilibruar);

I_{min} = vlera e I mbi të cilën shtrihet gabimi brenda gabimeve maksimale të lejueshme (MPE-të) (kontatorë me shumë faza me ngarkesë të ekuilibruar);

I_{tr} = vlera e I mbi të cilën shtrihet gabimi brenda MPE-së më të vogël që i korrespondon treguesit të klasës së kontatorit;

I_{max} = vlera maksimale e I për të cilin gabimi shtrihet brenda MPE-ve;

U = voltazhi i energjisë elektrike që dërgohet në kontator;

U_n = voltazhi i përcaktuar i referimit;

f = frekuenca e voltazhit që dërgohet në kontator;

f_n = frekuenca e përcaktuar e referimit;

PF = faktori i energjisë = $\cos\phi$ = cosinusin e ndryshimit të fazës ϕ ndërmjet I dhe U .

KËRKESAT E VEÇANTA

1. Saktësia

Prodhuesi përcakton treguesin e klasës së kontatorit. Treguesit e klasave përcaktohen si:

Klasa, A, B dhe C.

2. Kushtet e vlerësuara të funksionimit

Prodhuesi përcakton kushtet e vlerësuara të funksionimit të kontatorit, veçanërisht:

Vlerat e f_n , U_n , I_n , I_{st} , I_{min} , I_{tr} dhe I_{max} që zbatohen për kontatorin. Për vlerat aktuale të përcaktuara, kontatori përmbush kushtet e dhëna në Tabelën 1;

Tabela 1

Klasa A Klasa B Klasa C

Për kontatorët e lidhur

drejtpërdrejt

$$I_{st} \leq 0,05 \cdot I_{tr} \leq 0,04 \cdot I_{tr} \leq 0,04 \cdot I_{tr}$$

$$I_{min} \leq 0,5 \cdot I_{tr} \leq 0,5 \cdot I_{tr} \leq 0,3 \cdot I_{tr}$$

$$I_{max} \geq 50 \cdot I_{tr} \geq 50 \cdot I_{tr} \geq 50 \cdot I_{tr}$$

Për kontatorët që

funksionojnë prej

transformatorëve

$$I_{st} \leq 0,06 \cdot I_{tr} \leq 0,04 \cdot I_{tr} \leq 0,02 \cdot I_{tr}$$

$$I_{min} \leq 0,4 \cdot I_{tr} \leq 0,2 \cdot I_{tr} [1] \leq 0,2 \cdot I_{tr}$$

$$I_n = 20 \cdot I_{tr} = 20 \cdot I_{tr} = 20 \cdot I_{tr}$$

$$I_{max} \geq 1,2 \cdot I_n \geq 1,2 \cdot I_n \geq 1,2 \cdot I_n$$

[1] Për Klasën B të kontatorëve elektromekanikë zbatohet $I_{min} \leq 0,4 \cdot I_{tr}$.

Voltazhi, frekuenca dhe sferat e faktorit të energjisë brenda të cilave kontatori duhet të përmbushë kërkesat e MPE-së përcaktohen në Tabelën 2. Këto sfera pranojnë karakteristikat tipike të energjisë elektrike të furnizuar nëpërmjet sistemeve publike të shpërndarjes.

Voltazhi dhe sferat e frekuencës janë të paktën:

$$0,9 \cdot U_n \leq U \leq 1,1 \cdot U_n$$

$$0,98 \cdot f_n \leq f \leq 1,02 \cdot f_n$$

faktori i energjisë shkon nga të paktën $\cos\phi = 0,5$ induksion deri në $\cos\phi = 0,8$ e kapacitetit.

3. MPE-të

Ndikimet e sasive të matura të ndryshme dhe sasitë e ndikimit (a, b, c, . . .) vlerësohen veçmas, të gjitha sasi të matura dhe sasitë e ndikimit të tjera mbahen relativisht konstante në vlerat e tyre të referencës. Gabimi i matjes, që nuk kapërcen MPE-në e deklaruar në Tabelën 2, llogaritet si:

$$\text{Gabimi i matjes} = \sqrt{a^2 + b^2 + c^2}$$

Kur kontatori funksionon nën korrentin me një ngarkesë të ndryshueshme, gabimet në përqindje nuk kapërcejnë kufijtë e dhënë në Tabelën 2.

Tabela 2

MPE-të në përqindje në kushtet e vlerësuara të funksionimit dhe nivelet e përcaktuara të korrentit të ngarkesës dhe temperatura e funksionimit

Temperaturat e funksionimit Temperaturat e funksionimit Temperaturat e funksionimit Temperaturat e funksionimit

+ 5 °C . . . + 30 °C - 10 °C . . . + 5 °C - 25 °C . . . - 10 °C - 40 °C . . . - 25 °C

ose ose ose

+ 30 °C . . . + 40 °C + 40 °C . . . + 55 °C + 55 °C . . . + 70 °C

Klasa e kontaktorit A B C A B C A B C A B C

Kontatori me një fazë të vetme: kontatori me shumë faza nëse funksionon me ngarkesa të ekuilibruara

$I_{min} \leq I < I_{tr}$ 3,5 2 1 5 2,5 1,3 7 3,5 1,7 9 4 2

$I_{tr} \leq I \leq I_{max}$ 3,5 2 0,7 4,5 2,5 1 7 3, 5 1,3 9 4 1,5

Kontatori me shumë faza nëse funksionon me një ngarkesë të një faze të vetme

$I_{tr} \leq I \leq I_{max}$

shih përjashtimin

më poshtë 4 2,5 1 5 3 1,3 7 4 1,7 9 4,5 2

Për kontaktoret me shumë faza elektromekanike sfera aktuale për ngarkesën me një fazë të vetme është e kufizuar në $5I_{tr} \leq I \leq I_{max}$

Kur një kontaktor funksionon në sfera të ndryshme të temperaturës zbatohen vlerat përkatëse të MPE-së.

4. Ndikimi i lejueshëm i trazimeve

4.1. Të përgjithshme

Meqenëse kontaktoret e energjisë janë të lidhur drejtpërdrejt me furnizimin me korrent dhe se korrenti është gjithashtu një prej sasive të matura, një mjedis elektromagnetik i veçantë përdoret për kontaktoret e energjisë elektrike.

Kontatori është në përputhje me mjedisin elektromagnetik EU dhe kërkesat shtesë në 4.2 dhe 4.3.

Mjedisi elektromagnetik dhe ndikimet e lejueshme pasqyrojnë gjendjen kur ekzistojnë shqetësime për një kohë të gjatë të cilat nuk ndikojnë në saktësinë përtej vlerave kritike të ndryshimit dhe trazimeve kalimtare, të cilët mund të shkaktojnë një prishje të përkohshme të funksionit ose funksionimit, por prej të cilave kontaktori rivendoset në funksionim dhe nuk ndikojnë në saktësinë përtej vlerave kritike të ndryshimit.

Kur ekziston një rrezik i lartë i parashikueshëm për shkak të vetëtimave ose atje ku rrjetet ajrore të furnizimit janë mbizotërues, mbrohen karakteristikat metrologjike të kontaktorit .

4.2. Ndikimi i trazimeve për një kohë të gjatë

Tabela 3

Vlerat e ndryshimit kritik për shqetësimet për një kohë të gjatë

Trazimi Vlerat e ndryshimit kritik në përqindje për klasën e kontaktorit

A B C

Radha e fazës së kundërt 1,5 1,5 0,3

Çekuilibri i voltazhit (i zbatueshëm vetëm për kontaktoret me shumë faza) 4 2 1

Përmbajtja harmonike në qarqet e tanishme (1) 1 0,8 0,5

DC dhe harmonia në qarkun e tanishëm (1) 6 3 1,5

Shpërthime të shpejta kalimtare 6 4 2

Fushat magnetike: Fusha elektromagnetike HF (RF e rrezatuar); Trazimet

e çuara të futura nga fusha e radio-frekuencës; dhe imuniteti i valëve

lëkundëse 3 2 1

(1) Në rast të kontaktoreve të energjisë elektrike elektromagnetike, nuk përcaktohet asnjë vlerë e ndryshimit kritik për përmbajtjen harmonike në qarqet aktuale dhe për DC dhe harmoninë në qarkun aktual.

4.3. Ndikimi i lejueshëm i një fenomeni elektromagnetik kalimtar

4.3.1. Ndikimi i një trazimi elektromagnetik në një kontaktor të energjisë elektrike është i tillë që gjatë dhe menjëherë pas trazimit:

— çdo informacion i nxjerrë i synuar për të testuar saktësinë e kontaktorit nuk prodhon impulse ose sinjale që i korrespondojnë një energjie më të lartë sesa vlera kritike e ndryshimit dhe në një kohë të arsyeshme pas trazimit kontaktori:

- rifillon të funksionojë brenda kufijve të MPE-së, dhe
- mbron të gjitha funksionet e matjes, dhe
- lejon rimarrjen e të gjitha të dhënave të matjes përpara trazimit, dhe
- nuk tregon një ndryshim në energjinë e regjistruar prej më shumë sesa vlera kritike e ndryshimit.

Vlera kritike e ndryshimit në kWh është $m \cdot U_n \cdot I_{max} \cdot 10^{-6}$
(m është numri i elementeve matëse të kontatorit, U_n në volt dhe I_{max} në amperë).

4.3.2. Për korentin e tepërt vlera kritike e ndryshimit është 1,5 %.

5. Përshtatshmëria

5.1. Nën voltazhin e vlerësuar të funksionimit gabimi pozitiv i kontatorit nuk kapërcen 10 %.

5.2. Tregimi i energjisë së përgjithshme ka një numër të mjaftueshëm shifrash për të siguruar se kur kontatori funksionon për 4 000 orë me ngarkesë të plote ($I = I_{max}$, $U = U_n$ dhe $PF = 1$), treguesi nuk rikthehet në vlerën fillestare të tij dhe nuk zerohet gjatë përdorimit.

5.3. Në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike në qark, sasi të e energjisë elektrike të matur mbeten në dispozicion për t'u lexuar gjatë një periudhe për të paktën 4 muaj.

5.4. Funksionimi pa ngarkesë

Kur zbatohet voltazhi pa një rrjedhje aktuale në qarkun aktual (qarku aktual është një qark i hapur), kontatori nuk regjistron energji në asnjë voltazh ndërmjet $0,8 \cdot U_n$ dhe $1,1 U_n$.

5.5. Fillimi

Kontatori fillon dhe vazhdon të regjistrojë në U_n , $PF = 1$ (kontatori me shumë faza me ngarkesë të ekuilibruar) dhe një korrent që është i barabartë me I_{st} .

6. Njësitë

Energjia elektrike e matur shfaqet në kilovat-orë ose në megavat-orë.

7. Vendosja në përdorim

(a) Atje ku një Shtet Anëtar imponon matje të përdorimit për banim, ai lejon që matje të tilla të kryhen nëpërmjet çdo kontatori të Klasës A. Për qëllimet e caktuara Shteti Anëtar është i autorizuar të kërkojë çdo kontator të Klasës B.

(b) Atje ku një Shtet Anëtar imponon matje të përdorimit për tregti dhe/ose përdorimin industrial të lehtë, ai lejon që matje të tilla të kryhen nga çdo kontator i Klasës B. Për qëllimet e caktuara Shteti Anëtar është i autorizuar të kërkojë çdo kontator të Klasës C.

(c) Shteti Anëtar siguron që sfera e korrentit të përcaktohet nga shpërndarësi ose personi i caktuar ligjërisht për instalimin e kontatorit, në mënyrë që kontatori të jetë i përshtatshëm për matjen e saktë të konsumit që është i parashikuar ose i parashikueshëm.

VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË

Procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të referuara në nenin 9 që prodhuesi mund të zgjedhë janë:

B + F ose B + D ose H1.

SHTOJCA MI-004
Kontatorët e ngrohjes

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I, kërkesat e veçanta dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në këtë shtojcë zbatohen për kontatorët e ngrohjes të përcaktuar më poshtë, të synuar për përdorimin për banorët, përdorimin tregtar dhe atë të industrisë së lehtë.

PËRKUFIZIMET

Një kontator i ngrohjes është një instrument i krijuar për të matur ngrohje, e cila në një qark të shkëmbimit të nxehtësisë, jepet nga një lëng i quajtur lëngu i transmetimit të nxehtësisë.

Një kontator i ngrohjes është ose një instrument i plotë ose një instrument i kombinuar që përbëhet nga njësi, sensori i rrjedhjes, grupi i ndjeshmërisë së temperaturës dhe llogaritësi, siç përcaktohen në nenin 4 germa (b) ose një kombinim i tyre

θ = temperatura e lëngut që transmeton nxehtësinë;

θ_{in} = vlera e në hyrjen e qarkut të shkëmbimit të nxehtësisë;

θ_{out} = vlera e në daljen e qarkut të shkëmbimit të nxehtësisë;

$\Delta\theta$ = ndryshimi i temperaturës $\theta_{in} - \theta_{out}$ me ≥ 0 ;

θ_{max} = kufiri i sipërm i θ që kontatori i ngrohjes të funksionojë saktë brenda MPE-ve;

θ_{min} = kufiri i poshtëm i θ që kontatori i ngrohjes të funksionojë saktë brenda MPE-ve;

$\Delta\theta_{max}$ = kufiri i sipërm i $\Delta\theta$ që kontatori i ngrohjes të funksionojë saktë brenda MPE-ve;

$\Delta\theta_{min}$ = kufiri i poshtëm i $\Delta\theta$ që kontatori i ngrohjes të funksionojë saktë brenda MPE-ve;

q = niveli i rrjedhjes së lëngut të transmetimit të nxehtësisë;

q_s = vlera më e lartë e q që lejohet për periudha të shkurtra kohe që kontatori i ngrohjes të funksionojë siç duhet;

q_p = vlera më e lartë e q që lejohet përgjithnjë që kontatori i ngrohjes të funksionojë siç duhet;

q_i = vlera më e ulët e q që lejohet që kontatori i ngrohjes të funksionojë siç duhet;

P = fuqia termike e shkëmbimit të nxehtësisë;

P_s = niveli i sipërm i P që lejohet që kontatori i nxehtësisë të funksionojë siç duhet.

KËRKESAT E VEÇANTA

1. Kushtet e vlerësuara të funksionimit

Vlerat e kushteve të vlerësuara të funksionimit përcaktohen nga prodhuesi si më poshtë:

1.1. Për temperaturën e lëngut: θ_{max} , θ_{min} ,

— për ndryshimet e temperaturës: $\Delta\theta_{max}$, $\Delta\theta_{min}$,

duke iu nënshtruar kufizimeve të mëposhtme: $\Delta\theta_{max}/\Delta\theta_{min} \geq 10$; $\min = 3\text{ K ose } 5\text{ K ose } 10\text{ K}$.

1.2. Për presionin e lëngut: Presioni maksimal pozitiv i brendshëm që kontatori i nxehtësisë mund të durojë përgjithnjë në kufirin e sipërm të temperaturës.

1.3. Për nivelet e rrjedhjes së lëngut: q_s , q_p , q_i , ku vlerat e q_p dhe q_i i nënshtrohen kufizimit të mëposhtëm: $q_p/q_i \geq 10$.

1.4. Për fuqinë termike: P_s .

2. Klasat e saktësisë

Klasat e mëposhtme të saktësisë përcaktohen për kontatorët e ngrohjes: 1, 2, 3.

3. MPE-të të zbatueshëm për kontatorët e plotë të ngrohjes

Gabimet maksimale relative të lejueshme të zbatueshme për një kontator të plotë të ngrohjes, të shprehur në përqindje të vlerës së vërtetë për çdo klasë të saktësisë janë:

- Për klasën 1: $E = E_f + E_t + E_c$, me E_f , E_t , E_c sipas paragrafëve 7.1 deri në 7.3.
- Për klasën 2: $E = E_f + E_t + E_c$, me E_f , E_t , E_c sipas paragrafëve 7.1 deri në 7.3.
- Për klasën 3: $E = E_f + E_t + E_c$, me E_f , E_t , E_c sipas paragrafëve 7.1 deri në 7.3.

4. Ndikimet e lejueshme të trazimeve elektromagnetike

4.1. Instrumenti nuk ndikohet nga fushat magnetike statike dhe nga fushat magnetike në frekuencën e korrentit.

4.2. Ndikimi i një trazimi elektromagnetik është i tillë që ndryshimi në rezultatin e matjes nuk është më i madh sesa vlera kritike e ndryshimit siç përshkruhet në kërkesën 4.3 ose treguesi i rezultatit të matjes është i tillë që nuk mund të interpretohet si një rezultat i vlefshëm.

4.3. Vlera kritike e ndryshimit për një kontator të plotë të ngrohjes është e barabartë me vlerën absolute të MPE-së të zbatueshme për atë kontator të ngrohjes (shihni paragrafin 3).

5. Qëndrueshmëria

Pasi është kryer një testim i përshtatshëm, duke marrë parasysh periudhën e kohës të vlerësuar nga prodhuesi, duhet të përmbushen kriteret e mëposhtme:

5.1. Sensorët e rrjedhjes: Luhatja e rezultatit të matjes pas testimit të qëndrueshmërisë, kur krahasohet me rezultatin fillestar të matjes nuk kapërcen vlerën kritike të ndryshimit.

5.2. Sensorët e temperaturës: Luhatja e rezultatit të matjes pas testimit të qëndrueshmërisë, kur krahasohet me rezultatin fillestar të matjes, nuk kapërcen $0,1\text{ }^{\circ}\text{C}$.

6. Mbishkrimet në një kontator të ngrohjes

- Klasa e saktësisë
- Kufijtë e nivelit të rrjedhjes
- Kufijtë e temperaturës
- Kufijtë e ndryshimit të temperaturës
- Vendi i instalimit të sensorit të rrjedhjes: rrjedhja ose kthimi
- Treguesi i drejtimit të rrjedhjes

7. Njësitë

Dispozitat për njësitë mund të zbatohen për njësitë e prodhuara nga prodhuesi i njëjtë ose prodhues të ndryshëm. Atje ku një kontator i ngrohjes përbëhet nga njësi, kërkesat thelbësore për një kontator zbatohen për njësitë gjithashtu. Përveç kësaj, zbatohen sa më poshtë:

7.1. MPE përkatës për sensorin e rrjedhjes, i shprehur në % për klasat e saktësisë:

- Klasa 1: $E_f = (1 + 0,01\text{ qp/q})$, por jo më shumë se 5 %,
- Klasa 2: $E_f = (2 + 0,02\text{ qp/q})$, por jo më shumë se 5 %,
- Klasa 3: $E_f = (3 + 0,05\text{ qp/q})$, por jo më shumë se 5 %,

B + F ose B + D ose H1.

SHTOJCA MI-005

Sistemet e matjes për matjen e vazhdueshme dhe dinamike të sasive të lëngjeve përveç ujit

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I, kërkesat e veçanta të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në këtë shtojcë zbatohen për sistemet e matjes për matjen e vazhdueshme dhe dinamike të sasive (vëllimeve ose masave) të lëngjeve përveç ujit . Nëse është e përshtatshme, termat “vëllimi dhe L” në këtë shtojcë mund të lexohen si: “masë dhe kg”.

PËRKUFIZIMET

Kontator: një instrument i krijuar për të matur në mënyrë të vazhdueshme, për të ruajtur dhe shfaqur sasinë në kushte të matjes së lëngut që kalon nëpërmjet treguesit të matjes në një tub të mbyllur të ngarkuar plotësisht.

Llogaritësi: një pjesë e kontatorit që merr sinjalet e informacionit të nxjerrë nga treguesi(t) e matjes dhe mundësisht, nga instrumentet matëse shoqërues të matjes dhe shfaq rezultatet e matjes.

Instrumenti shoqërues i matjes: një instrument i lidhur me llogaritësin për matjen e disa sasive që janë karakteristike të lëngut, me qëllim që të bëjnë një korrigjim dhe/ose një konvertim.

Pajisja e konvertimit: një pjesë e llogaritësit, e cila duke marrë parasysh karakteristikat e lëngut (temperatura, dendësia, etj.) të matura duke përdorur instrumentet matëse shoqëruese të matjes ose të vendosur në një memorie, konverton automatikisht:

— vëllimin e lëngut të matur në kushtet e matjes në një vëllim në kushtet bazë ose/dhe në masë, ose

— masën e lëngut të matur në kushtet e matjes në një vëllim në kushtet e matjes dhe/ose në një vëllim në kushtet bazë

Shënim: Një pajisje konvertimi përfshin instrumentet matëse shoqërues të matjes përkatëse.

Kushtet bazë: kushtet e përcaktuara në të cilët konvertohet sasia e matur e lëngut në kushtet e matjes.

Sistemi i matjes: një sistem që përfshin vetë kontatorin dhe të gjitha pajisjet e kërkuara për të siguruar matje të saktë ose të synuar për të lehtësuar funksionet e matjes.

Shpërndarësi i karburantit: një sistem i matjes i synuar për rimbushjen e automjeteve, anijeve të vogla dhe avionëve të vegjël.

Marrëveshja e vetëshërbimit: një marrëveshje që lejon klientin të përdorë një sistem të matjes me qëllim që të marrë lëngun për përdorimin e tij.

Pajisja e vetëshërbimit: një pajisje e posaçme që është pjesë e marrëveshjes së vetëshërbimit dhe që lejon që një ose më shumë sisteme të matjes të kryhen në këtë marrëveshje të vetëshërbimit.

Sasia minimale e matur (MMQ): sasia më e vogël e lëngut për të cilën matja është e pranueshme metrologjikisht për sistemin e matjes.

Treguesi i drejtpërdrejtë: treguesi, ose i vëllimit ose i masës, që i korrespondon matjes dhe që kontatori është fizikisht i aftë të matë.

Shënim: Treguesi i drejtpërdrejtë mund të konvertohet në një sasi tjetër duke përdorur pajisjen e konvertimit.

I ndërprershëm/i pandërprershëm: një sistem matës konsiderohet si i ndërprershëm/i pandërprershëm kur rrjedha e lëngut mund/nuk mund të ndalohe lehtësisht dhe shpejt.

Sfera e nivelit të rrjedhës: niveli ndërmjet nivelit minimal të rrjedhës (Q_{min}) dhe nivelit maksimal të rrjedhës (Q_{max}).

KËRKESAT E VEÇANTA

1. Kushtet e deklaruara të funksionimit

Prodhuesi përcakton kushtet e deklaruara të funksionimit për instrumentin, në veçanti

1.1. Sferën e nivelit të rrjedhjes

Sfera e nivelit të rrjedhjes u nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

(i) sfera e nivelit të rrjedhjes të një sistemi matës është brenda sferës së rrjedhjes së secilit prej elementeve të tij, në veçanti kontatorit.

(ii) kontatori dhe sistemi matës:

Tabela 1

Sistemi i caktuar i matjes Karakteristika e lëngut Raporti minimal $Q_{max} : Q_{min}$

Shpërndarësi i karburantit Gaze jo të lëngshëm 10 : 1

Gaze të lëngshëm 5: 1

Sistemi i matjes Lëngje kriogjenike 5: 1

Sistemet e matjes në tubacionedhe sistemet për ngarkimin e anijeve Të gjithë lëngjet Të përshtatshëm për përdorim

Të gjitha sistemet e tjerë të matjes Të gjithë lëngjet 4 : 1

1.2. Karakteristikat e lëngut që maten nga instrumenti duke përcaktuar emrin ose llojin e lëngut ose karakteristikat përkatëse të tij, për shembull:

— Sferën e temperaturës;

— Sferën e presionit;

— Sferën e dendësisë;

— Sferën e viskozitetit.

1.3. Vlera nominale e furnizimit të voltazhit AC dhe/ose kufij të furnizimit DC.

1.4. Kushtet bazë për vlerat e konvertuara.

Shënim: Paragrafi 1.4 nuk cenon detyrimet e Shteteve Anëtare për të kërkuar përdorimin e një temperature ose $15\text{ }^{\circ}\text{C}$ në përputhje me nenin 3 pika 1 të Direktivës së Këshillit, datë 19 tetor 1992, mbi harmonizimin e strukturave të tatimeve të akcizës mbi vajrat minerale [1] ose, për vajrat e karburanteve të rëndë, LPG dhe metan, një temperaturë tjetër në përputhje me nenin 3 pika 2 të asaj shtojce.

2. Klasifikimi i saktësisë dhe gabimet maksimale të lejueshme (MPE-të)

2.1. Për sasi të barabarta ose më të mëdha se 2 litra, MPE tek treguesit është:

Tabela 2

Klasa e saktësisë

0,3 0,5 1,0 1,5 2,5

Sistemet e matjes(A) 0,3 % 0,5 % 1,0 % 1,5 % 2,5 %
Kontatorët (B) 0,2 % 0,3 % 0,6 % 1,0 % 1,5 %

2.2. Për sasitë më pak sesa dy litra, MPE tek treguesit është:

Tabela 3

Vëllimi i matur V MPE

$V < 0,1 L$ 4 × vlera në Tabelën 2, e zbatuar për 0,1 L

$0,1 L \leq V < 0,2 L$ 4 × vlera në Tabelën 2

$0,2 L \leq V < 0,4 L$ 2 × vlera në Tabelën 2, e zbatuar për 0,4 L

$0,4 L \leq V < 1 L$ 2 × vlera në Tabelën 2

$1L \leq V < 2 L$ Vlera në Tabelën 2, e zbatuar për 2 L

2.3. Megjithatë, pavarësisht se cila mund të jetë sasia e matur, madhësia e MPE-së jepet nga më e madhja prej dy vlerave të mëposhtme:

- vlera absolute e MPE-së e dhënë në Tabelën 2 ose Tabelën 3,
- vlera absolute e MPE-së për sasinë minimale të matur (Emin).

2.4.1. Për sasitë minimale të matura më të mëdha sesa ose të barabarta me 2 litra, zbatohen kushtet e mëposhtme:

Kushti 1

Emin plotëson kushtin: $E_{min} \geq 2 R$, ku R është intervali i shkallës më të vogël të pajisjes treguese.

Kushti 2

Emin jepet nga formula $E_{min} = (2MMQ) \times (A/100)$, ku:

- MMQ është sasia minimale e matur,
- A është vlera numerike e përcaktuar në rreshtin A të Tabelës 2.

2.4.2. Për sasitë minimale të matura prej më pak se dy litra, zbatohet kushti 1 i përmendur më sipër dhe Emin është dy herë vlera e përcaktuar në Tabelën 3 dhe e lidhur me rreshtin A të Tabelës 2.

2.5. Treguesi i konvertuar

Në rast të një treguesi të konvertuar MPE-të janë si në rreshtin A të Tabelës 2.

2.6. Pajisjet e konvertimit

MPE-të në treguesit e konvertuar, për shkak të një pajisjeje të konvertuar, janë të barabartë me $\pm (A - B)$, ku A dhe B janë vlerat e përcaktuara në Tabelën 2.

Pjesë të pajisjeve të konvertimit që mund të testohen veçmas

(a) Llogaritësi

MPE-të e sasive të treguesve të lëngjeve të zbatueshme në llogaritje, pozitive ose negative, janë të barabartë me një të dhjetën e MPE-ve siç përcaktohet në rreshtin A të Tabelës 2.

(b) Instrumentet matëse shoqëruese

Instrumentet matëse shoqëruese kanë një saktësi të paktën po aq të mirë sa vlerat e Tabelës 4:

Tabela 4

MPE-të në matjet Klasa e saktësisë e sistemit matës

0,3 0,5 1,0 1,5 2,5

Temperatura • $\pm 0,3$ °

C • $\pm 0,5$ °C • $\pm 1,0$ °C

Presioni Me pak se MPa: • ± 50 kPa

Nga 1 në 4 MPa: • ± 5 %

Mbi 4 MPa: • ± 200 kPa

Dendësia • ± 1 kg/m³ • ± 2 kg/m³ • ± 5 kg/m³

Këto vlera zbatohen për treguesin e sasive karakteristike të lëngut të treguar nga pajisja e konvertimit.

c) Saktësia për llogaritjen e funksionit

MPE për llogaritjen e çdo sasie karakteristike të lëngut, pozitive ose negative, është e barabartë me dy të pestat e vlerës së fiksuar në shkronjën (b).

2.7. Kërkesa e shkronjës (a) në paragrafin 2.6 zbatohet për çdo llogaritje, jo vetëm konvertimin.

3. Ndikimi maksimal i lejueshëm i trazimeve

3.1. Ndikimi i një shqetësimi elektromagnetik në një sistem matës është një nga sa më poshtë:

— ndryshimi në rezultatin e matjes nuk është më i madh sesa vlera kritike e ndryshimit siç përcaktohet në paragrafin 3.2, ose

— tregimi i rezultatit matës tregon një luhajtje të momentit që nuk mund të interpretohet, memorizohet ose transmetohet si një rezultat i matjes. Për më tepër, në rast të një sistemi të ndërprerëshëm, kjo gjithashtu nënkupton pamundësinë për të kryer ndonjë matje, ose

— ndryshimi në rezultatin e matjes është më i madh sesa vlera kritike e ndryshimit dhe në këtë rast sistemi matës lejon rimarrjen e rezultatit të matjes pak përpara sesa vlera kritike e ndryshimit të ndodhte dhe të ndërpriste rrjedhën.

3.2. Vlera kritike e ndryshimit është më e madhja e $MPE/5$ për një sasi të caktuar të matur ose Emin.

4. Qëndrueshmëria

Pasi është kryer një testim i përshtatshëm, duke marrë parasysh periudhën e kohës të vlerësuar nga prodhuesi, duhet të përmbushen kriteret e mëposhtme:

Luhajtja e rezultatit të matjes pas testimit të qëndrueshmërisë, kur krahasohet me rezultatin fillestar të matjes nuk kapërcen vlerën për kontaktorët të përcaktuar në rreshtin B të tabelës 2.

5. Përshtatshmëria

5.1. Për secilën sasi të matur që ka lidhje me të njëjtën matje, treguesit e siguruar nga pajisje të ndryshme nuk duhet të shmangen njëra nga tjetra për më shumë se një interval prej një shkalle, atje ku pajisjet kanë të njëjtin interval të shkallës. Në rastin kur pajisjet kanë intervale të ndryshme të shkallëve, shmangia nuk është më e madhe sesa ajo e intervalit më të madh të shkallës.

Megjithatë, në rast të një marrëveshjeje të vetëshërbimit intervalet e shkallës të pajisjes treguese kryesore në sistemin e matjes dhe intervalet e shkallës të pajisjes së vetëshërbimit janë të njëjta dhe rezultatet e matjes nuk shmangen njëri nga tjetri.

5.2. Nuk mund të devijohet nga sasia e matur në kushtet normale të përdorimit, përveç kur kjo është tashmë e dukshme.

5.3. Çdo përqindje e ajrit ose gazit që nuk është lehtësisht e zbulueshme në lëng nuk çon në një ndryshim të gabimit më të madh sesa:

— 0,5 % për lëngjet e tjera përveç lëngjeve të pijshme dhe për lëngjet me në viskozitet që nuk kapërcen 1 mPa.s, ose

— 1 % për lëngjet e pijshme dhe për lëngjet me një viskozitet që kapërcen 1 mPa.s.

Megjithatë, luhatja e lejueshme nuk është kurrë më e vogël sesa 1 % e MMQ. Kjo vlerë zbatohet në rast të xhepave të ajrit ose gazit.

5.4. Instrumentet matëse për shitjet e drejtpërdrejta

5.4.1. Nje sistem matës për shitjet e drejtpërdrejta pajiset me mjetet për rivendosjen e tregimit në zero.

Nuk mund të devijohet nga sasia e matur.

5.4.2. Tregimi i sasisë në të cilën bazohet veprimi është i qëndrueshëm derisa të gjitha palët në veprim të kenë pranuar rezultatin e matjes.

5.4.3. Sistemet e matjes për shitjet e drejtpërdrejta janë të ndërprerëshme.

5.4.4. Çdo përqindje e ajrit ose gazit në lëng nuk çon në një ndryshim të gabimit më të madh sesa vlerat e përcaktuara në paragrafin 5.3.

5.5. Dispenserat e karburantit

5.5.1. Tregimet në shpërndarësit e karburantit nuk duhet të zerohen gjatë një matje.

5.5.2. Fillimi i matjeje të re është i ndaluar deri sa treguesi të jetë zeruar.

5.5.3. Atje ku një sistem matës është i pajisur me një tregim të çmimit, ndryshimi ndërmjet çmimit të treguar dhe çmimit të llogaritur nga çmimi për njësi, dhe sasia e treguar nuk kapërcen çmimin që korrespondon me Emin. Megjithatë, ky ndryshim nuk është vlera monetare më e vogël.

6. Avari e furnizimit me energji

Një sistem matës ose pajiset me një pajisje të furnizimit me energji, për raste emergjence, që tëruajë të gjitha funksionet e matjes gjatë avarisë së pajisjes kryesore të furnizimit me energji, ose pajiset me mjete për të ruajtur dhe treguar të dhënat e regjistruara, në mënyrë që të lejojë përfundimin e veprimit që është duke u kryer, dhe me mjete për të ndaluar rrjedhjen në momentin e avarisë së pajisjes kryesore të furnizimit me energji.

7. Vendosja në përdorim

Tabela 5

Klasa e saktësisë

Llojet e sistemit të matjes

0,3 Sistemet e matjes në tubacion

0,5 Të gjitha sistemet e matjes nëse nuk deklarohet ndryshe gjetkë në këtë tabelë, në veçanti:

- shpërndarësit e karburantit (jo për gazet e lëngshme),
 - sistemet e matjes për autobotet për lëngjet me një viskozitet të ulët (< 20 mPa.s)
 - sistemet e matjes për ngarkim/shkarkimin e anijeve dhe vagonëve, dhe autobotëve (1)
 - sistemet e matjes për qumesht
 - sistemet e matjes për rimbushjen e avionëve
- 1,0 Sistemet e matjes për gazet e lëngshme nën presion të matur në një temperaturë të barabartë me ose mbi $-10\text{ }^{\circ}\text{C}$
- Sistemet e matjes normalisht në klasën 0,3 ose 0,5, por që përdoren për lëngjet
- temperatura e të cilëve është më e ulët se $-10\text{ }^{\circ}\text{C}$ ose më e lartë se $50\text{ }^{\circ}\text{C}$

- viskoziteti dinamik i të cilëve është më i lartë sesa 1 000 mPa.s
- niveli maksimal i rrjedhjes së vëllimit të të cilëve nuk është më i lartë se 20 L/h

1,5 sistemet e matjes për dyoksidin e karbonit të lëngshëm

Sistemet e matjes për gazet e lëngshme nën presion të matur në një temperaturë nën $-10\text{ }^{\circ}\text{C}$ (përveç lëngjeve kriogjenike)

2,5 sistemet e matjes për lëngjet kriogjenike (temperaturë nën $-153\text{ }^{\circ}\text{C}$)

(1) Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë sisteme të matjes të një klase të saktësisë 0,3 ose 0,5 kur përdoren për mbledhjen e tatimeve në vajrat minerale kur ngarkohen/shkarkohen anije dhe vagonë dhe autobote.

Shënim: Megjithatë, prodhuesi mund të përcaktojë një saktësi më të mirë për një lloj të veçantë të sistemit të matjes.

8. Njësitë e matjes

Sasia e matur shfaqet në mililitra, centimetra kub, litra, metra kub, gramë, kilogramë ose tone.

VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË

Procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të referuara në nenin 9 që prodhuesi mund të zgjedhë janë:

B + F ose B + D ose H1 ose G.

[1] GZ L 316, 31.10.1992, fq. 12. Direktivë e shfuqizuar nga Direktiva 2003/96/KE (GZ L 283, 31.10.2003, fq. 51).

SHTOJCA MI-006

Instrumentet matëse të peshimit automatik

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I, kërkesat e veçanta të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë, të renditura në Kapitullin I të kësaj shtojce, zbatohen për instrumentet matëse të peshimit automatik të përcaktuara më poshtë, të synuar për të përcaktuar masën e një trupi duke përdorur veprimin e gravitetit mbi atë trup.

PËRKUFIZIMET

Instrumenti i peshimit automatik: një instrument që përcakton masën e një produkti pa ndërhyrjen e një operatori, dhe që ndjek një program ose proces automatik të paracaktuar që është karakteristike e instrumentit.

Matësi automatik i peshës së kapur: një instrument i peshimit automatik që përcakton masën e ngarkesave të veçanta të grumbulluara paraprakisht (për shembull parapaketime) ose ngarkesave të vetme të një materiali të lirshëm.

Kontrolluesi automatik i peshës: një matës automatik i peshës së kapur që i ndan artikujt e masës së ndryshme në dy ose më shumë grupe sipas vlerës së ndryshimit të masës së tyre dhe një pikë të caktuar nominale.

Etiketuesi i peshës: një matës automatik i peshës së kapur që etiketon artikujt individualë me vlerën e peshës.

Etiketuesi i peshës/çmimit: një matës automatik i peshës së kapur që etiketon artikujt individualë me vlerën e peshës dhe informacionin për çmimin.

Instrumenti automatik i mbushjes gravimetrike: një instrument i peshimit automatik që mbush kontejnerët me një masë të paracaktuar dhe praktikisht konstante të prodhimit nga ngarkesa.

Totalizatori jo i vazhdueshëm (peshuesi totalizues me hinkë): një instrument i peshimit automatik që përcakton masën e një prodhimi të ngarkesës duke e ndarë atë në ngarkesa të caktuara. Masa e çdo ngarkese të veçantë përcaktohet në vazhdim dhe përmbledhet. Pastaj çdo ngarkesë e veçantë dorëzohet si pjesë e ngarkesës së përgjithshme.

Totalizatori i vazhdueshëm: një instrument i peshimit automatik që vazhdimisht përcakton masën e prodhimit të ngarkesës në një rrip transmisioni, pa një ndarje sistematike të produktit dhe pa ndërprerë lëvizjen e rripit të transmisionit.

Ura e peshimit në hekurudhë: një instrument i peshimit automatik që ka një marrës të ngarkesës që përmban hekurudhë për transferimin e vagonëve.

KËRKESAT E VEÇANTA

KAPITULLI I — Kërkesat e zakonshme të njëjta për të gjitha llojet e instrumenteve të peshimit automatik

1. Kushtet e vlerësuara të funksionimit

Prodhuesi përcakton kushtet e deklaruara të funksionimit për instrumentin si më poshtë:

1.1. Për sasinë e matur:

Sfera e matjes në lidhje me kapacitetin maksimal dhe minimal të saj.

1.2. Për sasinë e ndikimit të furnizimit me energji elektrike:

Në rast të furnizimit me voltazh AC: vlera nominale e furnizimit të voltazhit ose kufijtë e voltazhit AC .

Në rast të furnizimit me voltazh DC: vlera nominale dhe minimale e furnizimit me voltazh DC ose kufijtë e voltazhit DC.

1.3. Për sasinë e ndikimit mekanik dhe klimatik:

Sfera e temperaturës minimale është 30 °C përveç kur përcaktohet ndryshe në kapitujt e tjerë të kësaj shtojce.

Klasat e mjedisit mekanik sipas Shtojcës I, paragrafi 1.3.2 nuk janë të zbatueshme. Për instrumentet matëse të cilat përdoren nën një tendosje të veçantë mekanike, p.sh. instrumentet matëse të vendosura në automjete, prodhuesi përcakton kushtet mekanike të përdorimit.

1.4. Për sasinë e tjera të ndikimit (nëse janë të zbatueshme):

Niveli/nivelet e funksionimit.

Karakteristikat e produktit(eve) që peshohen.

2. Ndikimet e lejueshme të trazimeve - mjedisi elektromagnetik

Funksionimi i kërkuar dhe vlera kritike e ndryshimit jepen në kapitullin përkatës të kësaj shtojce për çdo lloj instrumenti.

3. Përshtatshmëria

3.1. Mjetet sigurohen për të kufizuar ndikimet e pjerrësisë, ngarkimit dhe nivelit të funksionimit, të tillë që gabimet maksimale të lejueshme (MPE-të) të mos kapërcehen në funksionimin normal.

3.2. Mjedise të përshtatshme për trajtimin e materialit sigurohen për të lejuar që instrumenti të respektojë MPE-të gjatë funksionimit normal.

3.3. Çdo paraqitje e kontrollit nga operatori është e qartë dhe e efektshme.

3.4. Integriteti i shfaqjes (atje ku është e pranishme) është i verifikueshëm nga operatori.

3.5. Kapaciteti i duhur për zerimin duhet të sigurohet për të lejuar që instrumenti të respektojë MPE-të gjatë funksionimit normal.

3.6. Çdo rezultat jashtë sferës së matjes identifikohet si i tillë, atje ku një printim është i mundshëm.

4. Vlerësimi i përshtatshmërisë

Procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të referuara në nenin 9 që prodhuesi mund të zgjedhë janë:
Për sistemet mekanike:

B + D ose B + E ose B + F ose D1 ose F1 ose G ose H1.

Për instrumentet matëse elektromekanike:

B + D ose B + E ose B + F ose G ose H1.

Për sistemet elektronike ose sistemet që përmbajnë programe kompjuterike:

B + D ose B + F ose G ose H1.

KAPITULLI II — Matësit automatikë të peshës së kapur

1. Klasat e saktësisë

1.1. Instrumentet matëse ndahen në kategoritë kryesore që shënohen me: X ose Y siç përcaktohet nga prodhuesi.

1.2. Këto kategori kryesore më tej ndahen në katër klasa të saktësisë: XI, XII, XIII & XIV dhe Y(I), Y(II), Y(a) & Y(b) që përcaktohen nga prodhuesi.

2. Instrumentet e kategorisë X

2.1. Kategoria X zbatohet për instrumentet matëse të përdorura për të kontrolluar parapaketimet e krijuara në përputhje me kërkesat e Direktivës së Keshillit 75/106/KEE, datë 19 dhjetor 1974, mbi përafrimin e ligjeve të

Shteteve Anëtare, në lidhje me përbërjen e vëllimit të disa lëngjeve të parapaketuara [1] dhe të Direktivës së Keshillit 76/211/KEE, datë 20 janar 1976, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare, në lidhje me përbërjen e peshës ose vëllimit të disa prodhimeve të parapaketuara [2] të zbatueshme për parapaketimet.

2.2. Klasat e saktësisë janë të shoqëruara nga një faktor (x) që përcakton shmangien maksimale tëmundshme nga standardi, siç shprehet në paragrafin 4.2.

Prodhuesi përcakton faktorin (x), ku (x) është ≤ 2 dhe në formën $1 \times 10k$, $2 \times 10k$ ose $5 \times 10k$, ku k është një numër negativ i plotë ose zero.

3. Instrumentet matëse të kategorisë Y

Kategoria Y zbatohet për gjithë matësit automatikë të peshës së kapur

4. MPE

4.1. Gabimi mesatar Kategoria X / MPE instrumentet e kategorisë Y

Tabela 1

Ngarkesa neto (m) në intervale të shkallës së verifikimit(e)

Gabimi mesatar maksimal i lejueshëm

Gabimi maksimal i lejueshëm

XI Y(I) XII Y(II) XIII Y(a) XIV Y(b) X Y

$0 < m \leq 50\ 000$ $0 < m \leq 5$

000

$0 < m \leq$

500 $0 < m \leq 50$ $\cdot \pm 0,5 e$ $\cdot \pm 1 e$

$50\ 000 < m \leq 200\ 000$ $5\ 000 < m$

$\leq 20\ 000$

$500 < m \leq$

2 000

$50 < m \leq$

200 $\cdot \pm 1,0 e$ $\cdot \pm 1,5 e$

$200\ 000 < m$

$20\ 000 <$

$m \leq 100$

000

$2\ 000 < m$

$\leq 10\ 000$

$200 < m \leq$

$1\ 000$ $\cdot \pm 1,5 e$ $\cdot \pm 2 e$

4.2. Shmangia nga standardi

Vlera maksimale e lejueshme për shmangien nga standardi të një instrumenti të klasës X (x) është rezultat i shumëzimit të faktorit (x) me vlerën në Tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2

Ngarkesa neto (m) Shmangia maksimale e lejueshme nga standardi për klasën X(1)

$m \leq 50$ g 0,48 %

50 g $< m \leq 100$ g 0,24 g

100 g $< m \leq 200$ g 0,24 %

200 g $< m \leq 300$ g 0,48 g

300 g $< m \leq 500$ g 0,16 %

$500 \text{ g} < m \leq 1\,000 \text{ g}$ 0,8 g
 $1\,000 \text{ g} < m \leq 10\,000 \text{ g}$ 0,08 %
 $10\,000 \text{ g} < m \leq 15\,000 \text{ g}$ 8 g
 $15\,000 \text{ g} < m$ 0,053 %

Për klasën XI dhe XII (x) është më pak se 1.
 Për klasën XIII (x) nuk është më i madh sesa 1.
 Për klasën XIV (x) është më i madh sesa 1.

4.3. Intervali i verifikimit të shkallës — instrumentete me intervale të vetme

Tabela 3

Klasat e saktësisë
 Intervali i verifikimit të shkallës
 Numri i intervaleve të verifikimit të shkallës $n = \text{Maks}/e$
 Minimum Maksimum
 XI Y(I) $0,001 \text{ g} \leq e \leq 50\,000$ —
 XII Y(II) $0,001 \text{ g} \leq e \leq$
 $0,05 \text{ g}$
 $100\,000$
 $0,1 \text{ g} \leq e \leq 5\,000\,000$
 XIII Y(a) $0,1 \text{ g} \leq e \leq 2 \text{ g}$ $100\,000$
 $5 \text{ g} \leq e \leq 500\,000$
 XIV Y(b) $5 \text{ g} \leq e \leq 1\,000$

4.4. Intervali i verifikimit të shkallës — instrumentet me shumë intervale

Tabela 4

Klasat e saktësisë
 Intervali i verifikimit të shkallës
 Numri i intervaleve të verifikimit të shkallës $n = \text{Maks}/e$
 Vlera minimale (1)
 $n = \text{Maks}/e(i+1)$
 Vlera maksimale $n =$
 Maks/e_i
 XI Y(I) $0,001 \text{ g} \leq e_i \leq 50\,000$ —
 XII Y(II) $0,001 \text{ g} \leq e_i \leq$
 $0,05 \text{ g}$
 $5\,000\,000$
 $0,1 \text{ g} \leq e_i \leq 5\,000\,000$
 XIII Y(a) $0,1 \text{ g} \leq e_i \leq 500\,000$
 XIV Y(b) $5 \text{ g} \leq e_i \leq 50\,000$

Ku:
 $i = 1, 2, \dots, r$
 $i =$ sfera e pjeshme e peshimit
 $r =$ numri i përgjithshëm i sferave të pjeshme
 (1) Për $i = r$ kolona përkatëse e Tabelës 3 zbatohet me e të zëvendësuar nga er.

5. Sfera e matjes

Në përcaktimin e sferës së matjes për instrumentet matëse të klasës Y prodhuesi merr parasysh se kapaciteti minimal është jo më pak se:

klasa Y(I): 100 e
klasa Y(II): 20 e për $0,001 \text{ g} \leq e \leq 0,05 \text{ g}$, dhe 50 e për $0,1 \text{ g} \leq e$
klasa Y(a): 20 e
klasa Y(b): 10 e

Peshoret e përdorura për klasifikimin, p.sh. peshoret postare dhe matësit e peshës së plehrave: 5 e

6. Vendosija dinamike

6.1. Mjedisi i vendosjes dinamike funksionon brenda një sfere të ngarkesës të përcaktuar nga prodhuesi.

6.2. Kur përshtatet, një mjedis i vendosjes dinamike që kompenson për ndikimet dinamike të ngarkesës në lëvizje nuk lejohet që të funksionojë jashtë sferës së ngarkesës dhe mund të sigurohet.

7. Funksionueshmëria nën faktorët e ndikimit dhe trazimet elektromagnetike

7.1. MPE-të për shkak të faktorëve të ndikimit janë:

7.1.1. Për instrumentet matëse të kategorisë X:

- Për funksionimin automatik, siç përcaktohet në Tabelat 1 dhe 2,
- Për funksionimin joautomatik të peshimit statik; siç përcaktohet në Tabelën 1.

7.1.2. Për instrumentet matëse të kategorisë Y

- Për çdo ngarkesë në funksionimin automatik; siç përcaktohet në Tabelën 1,
- Për funksionimin joautomatik të peshimit statik; siç përcaktohet për kategorinë X në Tabelën 1.

7.2. Vlera e ndryshimit kritik për shkak të një trazire është një interval i verifikimit të shkallës.

7.3. Sfera e temperaturës:

- Për klasën XI dhe Y(I) sfera minimale është 5° C ,
- Për klasën XII dhe Y(II) sfera minimale është 15° C .

KAPITULLI III — Instrumentet matëse automatike të mbushjes gravimetrike

1. Klasat e saktësisë

1.1. Prodhuesi përcakton si klasën e saktësisë të referimit $\text{Ref}(x)$ dhe klasën(at) e saktësisë së funksionimit $X(x)$.

1.2. Një lloj instrumenti i caktohet një klase të saktësisë së referimit, $\text{Ref}(x)$, që i korrespondon saktësisë më të lartë të mundshme për instrumentet matëse të atij lloji. Pas instalimit, instrumentet matëse individuale caktohen për një ose më shumë klasa të saktësisë së funksionimit, $X(x)$, pasi janë marrë parasysh prodhimet e caktuara që peshohen. Faktori për caktimin e klasës (x) është ≤ 2 dhe në formën $1 \times 10k$, $2 \times 10k$ ose $5 \times 10k$ ku k është një numër negativ i plotë ose zero.

1.3. Klasa e saktësisë së referimit, $\text{Ref}(x)$ është e zbatueshme për ngarkesat statike.

1.4. Për klasën e saktësisë së funksionimit $X(x)$, X është një regjim që lidh saktësinë me peshën e ngarkesës dhe (x) është një shumëzues për kufijtë e gabimit të përcaktuar për klasën $X(1)$ në 2.2.

2. MPE

2.1. Gabimi i peshimit statik

2.1.1. Për ngarkesat statike në kushtet e vlerësuara të funksionimit, MPE për klasën e saktësisë së referimit Ref(x) është 0,312 e shmangies maksimale të lejuar për secilën sasi të mjaftueshme nga mesatarja, siç përcaktohet në Tabelën 5; të shumëzuar nga faktori i caktuar i klasës (x).

2.1.2. Për instrumentet matëse ku sasia e mjaftueshme mund të përbëhet nga më shumë se një ngarkesë (p.sh. matësit e peshës së kombinuar nga grumbullimi ose përzgjedhja) MPE-ja për ngarkesat statike është saktësia e kërkuar për sasinë e mjaftueshme siç përcaktohet në 2.2 (d.m.th. jo shuma e shmangies maksimale të lejueshme për ngarkesat individuale).

2.2. Shmangia nga sasia e mjaftueshme mesatare

Tabela 5

Vlera e masës, m (g), e sasive të mjaftueshme

Shmangia maksimale e lejueshme e çdo sasie të mjaftueshme nga mesatarja për klasën X(1)

$m \leq 50$ 7,2 %

$50 < m \leq 100$ 3,6 g

$100 < m \leq 200$ 3,6 %

$200 < m \leq 300$ 7,2 g

$300 < m \leq 500$ 2,4 %

$500 < m \leq 1\ 000$ 12 g

$1\ 000 < m \leq 10\ 000$ 1,2 %

$10\ 000 < m \leq 15\ 000$ 120 g

$15\ 000 < m$ 0,8 %

Shënim: Shmangia e llogaritur për çdo sasi të mjaftueshme nga mesatarja mund të rregullohet për të mbajtur parasysh ndikimin madhësisë së grimcës së materialit.

2.3. Gabimi relativ ndaj vlerës së paracaktuar (gabimi i vendosjes)

Për instrumentet matëse ku është e mundur të paracaktohet një peshë e sasisë së mjaftueshme; ndryshimi maksimal ndërmjet vlerës së paracaktuar dhe masës mesatare të sasisë së mjaftueshme nuk kapërcen 0,312 të shmangies maksimale të lejueshme të çdo sasie të mjaftueshme nga mesatarja, siç përcaktohet në Tabelën 5.

3. Funksionimi nën faktorin e ndikimit dhe trazime elektromagnetike

3.1. MPE-ja për shkak të faktorëve të ndikimit është siç përcaktohet në paragrafin 2.1

3.2. Vlera kritike e ndryshimit për shkak të një trazimi është një ndryshim i treguesit të peshës statike të barabartë me MPE-në siç përcaktohet në paragrafin 2.1 e llogaritur për mbushjen e vlerësuar minimale ose një ndryshim që jep ndikimin e njëjtë tek mbushja në rastin e instrumenteve kur mbushja përbëhet nga ngarkesa të shumta. Vlera kritike e ndryshimit e llogaritur rumbullakoset në intervalin e shkallës më të lartë të afërt (d).

3.3. Prodhuesi përcakton vlerën e mbushjes minimale të vlerësuar.

KAPITULLI IV— Totalizatorët jo të vazhdueshëm

1. Klasat e saktësisë

Instrumentet matëse ndahen në katër klasa të saktësisë si më poshtë: 0,2, 0,5, 1, 2.

2. MPE-të

Tabela 6

Klasa e saktësisë

MPE e ngarkesës së totalizuar

0,2 • ± 0,10 %

0,5 • ± 0,25 %

1 • ± 0,50 %

2 • ± 1,00 %

3. Intervali i shkallës së totalizimit

Intervali i shkallës së totalizimit (dt) është në sferën:

$0,01 \% \text{ Max} \leq dt \leq 0,2 \% \text{ Max}$

4. Ngarkesa minimale e totalizuar (Σ_{\min})

Ngarkesa minimale e totalizuar (Σ_{\min}) nuk është më pak sesa ngarkesa për të cilën MPE-ja është i barabartë me intervalin e shkallës së totalizimit (dt) dhe jo më pak sesa ngarkesa minimale siç përcaktohet nga prodhuesi.

5. Zerimi

Instrumentet që nuk matin peshën e ambalazhit pas çdo shkarkimi kanë një pajisje të zerimit. Funkcionimi automatik nuk lejohet nëse treguesi zero lëviz me:

— 1 dt në instrumentet matëse me zerimin automatik;

— 0,5 dt në instrumentet matëse me një zerim gjysmëautomatik ose joautomatik.

6. Paraqitja e operatorit

Rregullimet prej operatorit dhe funksioni i rivendosjes nuk lejohen gjatë funksionimit automatik.

7. Printimi

Në instrumentet matëse të pajisur me një instrument printimi, rivendosja e shumës së përgjithshme nuk lejohet derisa të printohet shuma e përgjithshme. Printimi i shumës së përgjithshme duhet tëndodhë nëse funksionimi automatik ndërpritet.

8. Funksionimi nën faktorët e ndikimit dhe trazime elektromagnetike

8.1. MPE-të për shkak të faktorëve të ndikimit përcaktohen në Tabelën7.

Tabela 7

Ngarkesa (m) në intervalet e shkallës së totalizimit (dt)

MPE

$0 < m \leq 500$ • ± 0,5 dt

$500 < m \leq 2\ 000$ • ± 1,0 dt

$2\ 000 < m \leq 10\ 000$ • ± 1,5 dt

8.2. Vlera kritike e ndryshimit për shkak të një trazimi është një interval i shkallës së totalizimit për çdo tregues të peshës dhe çdo shumë të përgjithshme të regjistruar.

KAPITULLI V — Totalizatorët e vazhdueshëm

1. Klasat e saktësisë

Instrumentet matëse ndahen në tri klasa të saktësisë si më poshtë: 0,5, 1, 2.

2. Sfera e matjes

2.1. Prodhuesi përcakton sferën e matjes, raportin ndërmjet ngarkesës minimale neto në njësinë e peshimit e kapacitetin maksimal dhe ngarkesën minimale të totalizuar.

2.2. Ngarkesa minimale e totalizuar Σ_{min} nuk është më pak se

800 d për klasën 0,5,
400 d për klasën 1,
200 d për klasën 2.

Ku d është intervali i shkallës së totalizimit i pajisjes së totalizimit të përgjithshëm.

3. MPE

Tabela 8

Klasa e saktësisë
MPE për ngarkesën e totalizuar
0,5 • $\pm 0,25$ %
1 • $\pm 0,5$ %
2 • $\pm 1,0$ %

4. Shpejtësia e rripit

Shpejtësia e rripit përcaktohet nga prodhuesi. Për matësit e peshës me rrip me një shpejtësi të vetme dhe matësin e peshës me rrip me shpejtësi të ndryshueshme që kanë një kontroll manual të vendosjes së shpejtësisë, shpejtësia nuk ndryshon më shumë se 5% e vlerës nominale. Produkti nuk ka një shpejtësi të ndryshme nga shpejtësia e rripit.

5. Pajisja e totalizimit të përgjithshëm

Nuk mund të zerohet pajisja e totalizimit të përgjithshëm.

6. Funksionimi nën faktorët e ndikimit dhe trazimeve elektromagnetike

6.1. MPE-ja për shkak të faktorëve të ndikimit për një ngarkesë jo më pak se Σ_{min} , është 0.7 herë vlera e përshtatshme e përcaktuar në Tabelën 8, e rumbullakosur në intervalin më të afërt të shkallës së totalizimit (d).

6.2. Vlera kritike e ndryshimit për shkak të një trazimi është 0,7 vlera e përshtatshme e përcaktuar në Tabelën 8, për një ngarkesë të barabartë me Σ_{min} , për klasën e caktuar të matësit të peshës me rrip; e rumbullakosur në intervalin më të afërt të shkallës së totalizimit (d).

KAPITULLI VI — Urat e peshimit në hekurudhë

1. Klasat e saktësisë

Instrumentet matëse ndahen në katër klasa të saktësisë si më poshtë:

0,2, 0,5, 1, 2.

2. MPE

2.1. MPE-të për peshimin –në lëvizje të një vagoni të vetëm ose një treni të tërë tregohen në Tabelën 9.

Tabela 9

Klasa e saktësisë

MPE

0,2 • $\pm 0,1$ %

0,5 • $\pm 0,25$ %

1 • $\pm 0,5$ %

2 • $\pm 1,0$ %

2.2. MPE-të për peshën e vagonëve të lidhur ose të palidhur gjatë peshimit në lëvizje janë një prej vlerave të mëposhtme, cila të jetë më e lartë:

— vlera e llogaritur sipas Tabelës 9, e rrumbullakosur në intervalin më të afërt të shkallës;

— vlera e llogaritur sipas Tabelës 9, e rrumbullakosur në intervalin më të afërt të shkallës për një peshë të barabartë me 35 % të peshës maksimale të vagonit (siç shënohet në shënimet përshkruese);

— një interval të shkallës(d).

2.3. MPE-të për peshën e trenit gjatë peshimit –në lëvizje janë një prej vlerave të mëposhtme, cila të jetë më e lartë:

— vlera e llogaritur sipas Tabelës 9, e rrumbullakosur në intervalin më të afërt të shkallës;

— vlera e llogaritur sipas Tabelës 9, për peshën e një vagoni të vetëm e barabartë me 35 % të peshës maksimale të vagonit (siç shënohet në shënimet përshkruese) e shumëzuar me numrin e vagonëve të referimit (që nuk kapërcen 10) në tren dhe e rrumbullakosur në intervalin më të afërt të shkallës;

— një interval të shkallës(d) për çdo vagon në tren, por që nuk kapërcen 10 d.

2.4. Kur peshohen vagonë të lidhur; gabimet e jo më shumë se 10% e rezultateve të peshimit të marra nga një ose më shumë kalime të trenit mund të kapërcejnë MPE-në e duhur të dhënë në paragrafin 2.2, por nuk kapërcejnë dyfishin e MPE-së.

3. Intervali i shkallës (d)

Lidhja ndërmjet klasës së saktësisë dhe intervalit të shkallës siç përcaktohet në Tabelën 10.

Tabela 10

Klasa e saktësisë

Intervali i shkallës (d)

0,2 $d \leq 50$ kg

0,5 $d \leq 100$ kg

1 $d \leq 200$ kg

2 $d \leq 500$ kg

4. Sfera e matjes

4.1. Kapaciteti minimal nuk është më pak se 1 t dhe jo më i madh sesa vlera e rezultatit të peshës minimale të vagonit e pjestuar me numrin e peshimeve të pjesshme.

4.2. Pesha minimale e vagonit nuk është më pak se 50 d.

5. Funksionimi nën faktorin e ndikimit dhe trazimin elektromagnetik

5.1. MPE për shkak të një faktori të ndikimit siç përcaktohet në Tabelën 11.

Tabela 11

Ngarkesa (m) në intervale të verifikimit të shkallës (d)

MPE

$0 < m \leq 500 \cdot \pm 0,5 d$

$500 < m \leq 2\,000 \cdot \pm 1,0 d$

$2\,000 < m \leq 10\,000 \cdot \pm 1,5 d$

5.2. Vlera kritike e ndryshimit për shkak të një trazimi është një interval prej një shkalle.

[1] GZ L 42, 15.02.1975, fq. 1. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Direktiva 89/676/KEE (GZ L 398, 30.12.1989, fq. 18).

[2] GZ L 46, 21.02.1976, fq. 1. Direktivë e ndryshuar së fundi nga Marrëveshja e ZEE-së.

SHTOJCA MI-007 Kontatorët e taksive

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I, kërkesat e veçanta të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në këtë shtojcë zbatohen për kontatorët e taksive.

PËRKUFIZIMET

Kontatori i taksive: një pajisje që funksionon së bashku me një prodhues të sinjalit [1] për të krijuar një instrument matës.

Kjo pajisje mat kohëzgjatjen, llogarit distancën mbi bazën e një sinjali që jepet nga prodhuesi i sinjalit të distancës. Përveç kësaj, ai llogarit dhe paraqit tarifën që duhet paguar për një udhëtim mbi bazën e distancës së llogaritur dhe/ose kohëzgjatjen e matur të udhëtimit.

Tarifa: shuma e përgjithshme e parave që duhen paguar për një udhëtim mbështetur në një kuotë fillestare fikse dhe/ose gjatësia dhe/ose kohëzgjatja e udhëtimit. Tarifa nuk përfshin një shumë shtesë për shërbime ekstra.

Shpejtësia e kapërcimit: vlera e shpejtësisë që gjendet përmes pjesëtimit të një vlere të tarifës së koheës me vlerën e tarifeës së distancës.

Modaliteti i llogaritjes normale S (zbatimi i vetëm i tarifës): llogaritja e tarifës mbështetur në zbatimin e tarifës së kohës nën shpejtësinë e kapërcimit dhe zbatimin e tarifës së distancës mbi shpejtësinë e kapërcimit.

Modaliteti i llogaritjes normale D (zbatimi i dyfishtë i tarifës): llogaritja e tarifës mbështetur në zbatimin në të njëjtën kohë të tarifës së kohës dhe tarifës së distancës për të gjithë udhëtimit.

Pozicioni i funksionimit: modalitetet e ndryshme në të cilat kontatori i taksive përmbush pjesët e ndryshme të funksionimit të tij. Pozicionet e funksionimit dallohen prej treguesve të mëposhtëm:

“E lirë”: pozicioni i funksionimit në të cilin llogaritja e tarifës është çaktivizuar

“E zënë”: pozicioni i funksionimit në të cilin llogaritja e tarifës kryhet mbi bazën e një shume fillestare të mundshme dhe një tarife për distancën e udhëtuar dhe/ose kohën e udhëtimit

“Ndaluar”: pozicioni i funksionimit në të cilin tarifa që duhet paguar për udhëtimin është e treguar dhe të paktën llogaritja e tarifës mbështetur në kohën është e çaktivizuar.

KËRKESAT E SKICËS

1. Kontatori i taksive krijohet për të llogaritur distancën dhe për të matur kohëzgjatjen e një udhëtimit.
2. Kontatori i taksive krijohet për të llogaritur dhe shfaqur tarifën, duke e rritur atë në hapa të barabartë me vendimin e përcaktuar nga Shteti Anëtar në pozicionin e funksionimit “E zënë”. Kontatori i taksive gjithashtu krijohet për të shfaqur vlerën përfundimtare për udhëtimin në pozicionin e funksionimit “E ndaluar”.
3. Një kontator i taksive mund të zbatojë modalitetet e llogaritjes normale S dhe D. Është e mundur që të zgjidhet ndërmjet këtyre modaliteteve të llogaritjes nëpërmjet një vendosjeje të siguruar.
4. Një kontator i taksive paraqet të dhënat e mëposhtme nëpërmjet një paraqitjeje(ve) të pershtatshme të siguruar:

- pozicioni i funksionimit: “E lirë”, “E zënë” ose “E ndaluar”;
- datat e totalizimit sipas paragrafit 15.1;
- informacionin e përgjithshëm: konstanten e prodhuesit të sinjalit të distancës, datën e sigurimit, identifikuesin e taksisë, kohën aktuale, identifikimin e tarifës;
- informacionin e tarifës për një udhëtim: shumën e përgjithshme, tarifën, përlllogaritjen e tarifës, shumën shtesë, datën, kohën e fillimit, kohën e përfundimit, distancën e udhëtuar;
- informacionin e tarifës(ave): parametrat e tarifës(ave).

Legjislacioni kombëtar mund të kërkojë që disa pajisje të jenë të lidhura me paraqitjen(t) e një kontatori të taksive. Atje ku kërkohet një pajisje e tillë, është e mundur, nëpërmjet vendosjes së siguruar, që të ndalohej automatikisht funksionimi i kontatorit të taksive për arsye të mungesës ose funksionimit jo të drejtë të pajisjes së kërkuar.

5. Nëse është e rëndësishme, mund të rregullohet një kontator i taksive për konstanten e prodhuesit të sinjalit të distancës me të cilin lidhet dhe për të siguruar rregullimin.

KUSHTET E VLERËSUARA TË FUNKSIONIMIT

6.1. Klasa e mjedisit mekanik që zbatohet është M3.

6.2. Prodhuesi përcakton kushtet e vlerësuara të funksionimit për instrumentin, në veçanti:

- një sferë të temperaturës minimale prej 80 °C për mjedisin klimatik;
- kufijtë e furnizimit me energji DC për të cilët është krijuar instrumenti.

GABIMET MAKSIMALE TË LEJUESHME (MPE-të)

7. MPE-të, duke përjashtuar çdo gabim për shkak të përdorimit të kontatorit të taksive në një taksi, janë:

- Për kohën që ka kaluar: $\bullet \pm 0,1 \%$
vlera minimale e mpe-së: 0,2s;
- Për distancën e udhëtuar: $\bullet \pm 0,2 \%$
vlera minimale e mpe-së: 4 m;
- Për llogaritjen e tarifës: $\bullet \pm 0,1 \%$

minimumi, përfshi rrumbullakosjen: që i korrespondon shifrës më pak domethënëse të treguesit të tarifës.

NDIKIMI I LEJUESHËM I TRAZIMEVE

8. Imuniteti elektromagnetik

8.1. Klasa elektromagnetike që zbatohet është E3.

8.2. MPE-ja e përshkruar në paragrafin 7 gjithashtu respektohet në prani të një trazimi elektromagnetik.

AVARIA E FURNIZIMIT ME ENERGJI

9. Në rast të një zvogëlimi të furnizimit me energji në një vlerë nën kufirin më të ulët të përdorimit siç përcaktohet nga prodhuesi, kontatori i taksive:

- vazhdon të punojë saktë ose rifillon funksionimin e tij të saktë pa humbje të të dhënave përpara rënies së voltazhit, nëse rënia e voltazhit është e përkohshme, p.sh. për shkak të ri-ndezjes së motorit;
- ndërpret një matje ekzistuese dhe kthehet në pozicionin 'E lirë' nëse rënia e voltazhit është për një periudhë të gjatë.

KERKESA TE TJERA

10. Kushtet për përshtatshmërinë ndërmjet kontatorit të taksive dhe prodhuesit të sinjalit të distancës përcaktohen nga prodhuesi i kontatorit të taksive.

11. Nëse ekziston një shumë shtesë për një shërbim ekstra e vendosur nga shoferi në komandën manuale, kjo përjashtohet nga tarifa e shfaqur. Megjithatë, në atë rast kontatori i taksive mund të shfaqë përkohësisht vlerën e tarifës përfshi shumën shtesë.

12. Nëse tarifa llogaritet sipas modalitetit të llogaritjes D, një kontator i taksive mund të ketë një modalitet shtesë të shfaqjes në të cilën vetëm distanca dhe kohëzgjatja e përgjithshme e udhëtimit shfaqen në kohën aktuale.

13. Të gjitha vlerat për pasagjerin identifikohen në mënyrë të përshtatshme. Këto vlera, si dhe identifikimi i tyre janë qartësisht të lexueshme gjatë ditës dhe natës.

14.1. Nëse tarifa që paguhet ose masat që merren ndaj përdorimit mashtrues mund të ndikohen nga zgjedhja e funksionueshmërisë prej një vendosje të para-programuar ose prej vendosjes së lirë të të dhënave, është e mundur që të sigurohen vendosjet e instrumentit dhe të dhënat e futura në të.

14.2. Mundësitë e sigurimit të disponueshme në kontatorin e taksive janë të tilla që të bëjnë të mundur sigurime të veçanta të vendosjeve.

14.3. Dispozitat në paragrafin 8.3 të Shtojcës I zbatohen gjithashtu për tarifat.

15.1. Një kontator i taksive pajiset me totalizatorë jo të rivendosshëm për të gjitha vlerat e mëposhtme:

- Distanca e përgjithshme e udhëtuar me taksi;
- Distanca e përgjithshme e udhëtuar kur është pajtuar;
- Numri i përgjithshëm i pajtimeve;
- Shuma e përgjithshme e parave të marra shtesë;
- Shuma e përgjithshme e parave të marra si tarifë.

Vlerat e totalizuara përfshijnë vlerat e ruajtura sipas paragrafit 9 në kushtet e humbjes së furnizimit me energji.

15.2. Nëse shkëputet nga energjia, një kontator i taksive lejon që vlerat e totalizuara të depozitohen për një vit me qëllim leximin e vlerave nga kontatori i taksive në një mjet tjetër.

15.3. Masa të përshtatshme merren për të parandaluar shfaqjen e vlerave të totalizuara që të përdoren për të mashtruar pasagjerët.

16. Ndryshimi automatik i tarifave lejohet vetëm për:

- distancën e udhëtimit;
- kohëzgjatjen e udhëtimit;
- kohën e ditës;
- datën;
- ditën e javës.

17. Nëse karakteristikat e taksisë janë të rëndësishme për korrektësinë e matësit të taksive, kontatori i taksive pajiset me mjetet për sigurimin e lidhjes së kontatorit të taksisë me taksinë në të cilën është instaluar.

18. Me qëllim testimin pas instalimit, kontatori i taksive pajiset me mundësinë për testimin veçmas të saktësisë së kohës e distancës së matur dhe saktësinë e llogaritjes.

19. Një kontator i taksive dhe udhëzimet e instalimit të përcaktuara nga prodhuesi janë të tilla që nëse instalohet në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, ndryshime mashtruese të sinjalit të matjes që përfaqësojnë distancën e udhëtuar janë të përjashtuara në mënyrë të mjaftueshme.

20. Kërkesat thelbësore të përgjithshme në trajtimin me përdorimin mashtrues plotësohen në një mënyrë të tillë që të mbrohen interesat e klientit, shoferit, punëdhënësit të shoferit dhe autoriteteve fiskale.

21. Një kontator i taksive krijohet në mënyrë që të mund të respektojë MPE-të pa rregullime gjatë një periudhë prej një viti të përdorimit normal.

22. Kontatori i taksive pajiset me një kyç të kohës së tanishme nëpërmjet të cilit të regjistrohet koha e ditës dhe data, njëra ose të dyja mund të përdoren për ndryshimin automatik të tarifave. Kërkesat për orën që tregon kohën aktuale janë:

- Regjistrimi i kohës ka një saktësi prej 0,02 %;
- Mundësia e korigjimit të orës është jo më shumë se 2 minuta në javë. Korigjimi për kohën e verës dhe të dimrit kryhet automatikisht;
- Korigjimi, automatik ose manual, parandalohet gjatë një udhëtimi.

23. Vlerat e distancës së udhëtuar dhe kohës që ka kaluar, kur shfaqen ose shtypen në përputhje me këtë direktivë, përdorin njësitë e mëposhtme:

Distanca e udhëtuar:

- në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë: deri në datën e cila caktohet nga këto Shtete Anëtare sipas nenit 1 gërma (b) të Direktivës 80/181/KEE: kilometra ose milje;
- në të gjithë Shtetet Anëtare të tjera: kilometra.

Koha që ka kaluar:

- sekonda, minuta ose orë, siç mund të jetë e përshtatshme, duke marrë parasysh rezolucionin e nevojshëm dhe nevojën për të parandaluar keqkuptimet.

VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË

Procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të referuara në nenin 9 që prodhuesi mund të zgjedhë janë:

B + F ose B + D ose H1.

[1] Prodhuesi i sinjalit të distancës është jashtë fushës së veprimit të kësaj direktive.

SHTOJCA MI-008

Matësit materialë

KAPITULLI I — Matësit materialë të gjatësisë

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I, kërkesat e veçanta të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në këtë kapitull zbatohen për matësit materialë të gjatësisë të përcaktuar më poshtë. Megjithatë, kërkesa për paraqitjen e një kopje të deklaratave të përshtatshmërisë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale.

PËRKUFIZIMET

Matësit materialë të gjatësisë: një instrument që përbëhet nga shenja të shkallëzimit distancat e të cilit jepen në njësi ligjore të gjatësisë.

KËRKESAT E VEÇANTA

Kushtet e referimit

1.1. Për shiritat me gjatësi të barabartë me ose më të madhe se pesë metra, gabimet maksimale të lejueshëm (MPE-të) përbushen kur një forcë tërheqëse prej pesëdhjetë njutone ose vlera të një force tjetër siç përcaktohet nga prodhuesi dhe të shënuara siç duhet në shirit ose në rast të matësve të ngurtë ose gjysmë të ngurtë nuk është e nevojshme që të zbatohet asnjë forcë tërheqëse.

1.2. Temperatura e referimit është 20 °C përveç kur përcaktohet ndryshe nga prodhuesi dhe kur shënohet siç duhet në matës.

MPE-të

2. MPE-ja, pozitive ose negative në mm ndërmjet dy shenjave të shkallëzimit jo të njëpasnjëshme është (a + bL), ku:

— L është vlera e gjatësisë e rumbullakosur në metrin e ardhshëm të plotë; dhe

— a dhe b jepen në Tabelën 1 më poshtë.

Kur një interval i fundit kufizohet nga një sipërfaqe, MPE për çdo distancë që fillon në këtë pikë rritet me vlerën c të dhënë në Tabelën 1.

Tabela 1

Klasa e saktësisë a (mm) b c (mm)

I 0,1 0,1 0,1

II 0,3 0,2 0,2

III 0,6 0,4 0,3

D — klasa e veçantë për shiritat zhytës (1)

Deri në dhe duke përfshirë 30 m (2)

1,5 zero zero

S — klasa e veçantë për shiritat e lidhjes së rezervuarëve.

Për çdo gjatësi 30 m kur shiriti mbështetet në një sipërfaqe të sheshtë 1,5 zero zero

(1) Zbatohet për kombinimet shirit/peshë e zhytjes.

(2) Nëse gjatësia nominale e shiritit kapërcen 30 m, një mpe shtesë prej 0,75 mm lejohet për çdo 30 m gjatësi të shiritit.

Shiritat e zhytjes gjithashtu mund të jenë të Klasave I ose II dhe në këtë rast për çdo gjatësi ndërmjet dy shenjave të shkallëzimit, njëra prej të cilave është në zhytësin dhe tjetra në shiritin, mpe është $\pm 0,6$ mm atje ku zbatimi i formulës jep një vlerë prej më pak se 0,6 mm.

MPE për gjatësinë ndërmjet shenjave të shkallëzimit të njëpasnjëshme dhe ndryshimi maksimal i lejueshëm ndërmjet dy intervaleve të njëpasnjëshëm jepen në Tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2

Gjatësia e intervalit

MPE ose ndryshimi në milimetra sipas klasës së saktësisë

I II III

$i \leq 1$ mm 0,1 0,2 0,3

$1\text{mm} < i \leq 1$ cm 0,2 0,4 0,6

Atje ku një vizore është e llojit të palosur, bashkimi i pjesëve është i tillë që të mos shkaktojë ndonjë gabim, përveç atyre të mësipërm, që kapërcen: 0,3 mm për Klasën II dhe 0,5 mm për Klasën III.

Materialet

3.1. Materialet e përdorura për matësit, materiale janë të tilla që ndryshimet e gjatësisë për shkak të ndryshimeve të temperaturës deri në ± 8 °C mbi temperaturën e referencës nuk kapërcejnë MPE-në. Kjo nuk zbatohet për masat e Klasës S dhe Klasës D atje ku një prodhues synon që korrigjimet e zgjerimit sizmik të zbatohen ndaj leximeve të vëna re atje ku është e nevojshme.

3.2. Matësit e prodhuar nga materiali - dimensionet e të cilit mund të ndryshojnë materialisht kur i nënshtrohet një sferë të gjerë të lagështirës relative, mund të përfshihen vetëm në Klasat II ose III.

Shënimet

4. Vlera nominale shënohet në matës. Shkallëzimi i milimetrave numërohet çdo centimetër dhe matësit me një interval të shkallës më të madhe se 2 cm i kanë të gjitha shkallëzimet të numëruara.

VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË

Procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të referuara në nenin 9 që prodhuesi mund të zgjedhë janë:

F 1 ose D1 ose B + D ose H ose G.

KAPITULLI II — Masat e kapacitetit të shërbimit

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I dhe kërkesat e veçanta të kësaj shtojce e procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në këtë kapitull zbatohen për masat e kapacitetit të shërbimeve të përcaktuara më poshtë. Megjithatë, kërkesa për paraqitjen e një kopje të deklaratave të përshtatshmërisë mund të interpretohet se zbatohet për një ngarkesë ose dërgesë sesa për instrumente individuale. Gjithashtu, kërkesa që instrumenti të mbajë informacion në lidhje me saktësinë e tij nuk zbatohet.

PERKUFIZIMET

Masa e kapacitetit të shërbimit: një masë e kapacitetit (e tillë si një gotë pije, kane ose gishtëz) të krijuar për të përcaktuar një vëllim të caktuar të një lëngu (përveç prodhimeve farmaceutike) që shiten për konsum të menjëhershëm.

Masa e vijës: një masë e kapacitetit të shërbimit e shënuar me një vijë për të treguar kapacitetin nominal.

Masa e buzës: një masë e kapacitetit të shërbimit për të cilën vëllimi i brendshëm është i barabartë me kapacitetin nominal.

Masa e transferimit: një masë e kapacitetit të shërbimit nga e cila synohet që lëngu të filtrohet përpara konsumit.

Kapaciteti: kapaciteti është vëllimi i brendshëm për masat e buzës ose vëllimi i brendshëm deri në shenjën e mbushjes për masat e vijës.

KËRKESAT E VEÇANTA

1. Kushtet e referimit

1.1. Temperatura: temperatura e referimit për masat e kapacitetit është 20 °C.

1.2. Pozicioni për treguesin e drejtë: qëndrimi lirshëm në një sipërfaqe të sheshtë.

2. MPE-të

Tabela 1

Vija Buza

Masat e transferimit

< 100 ml • $\pm 2 \text{ ml} - 0$

+4 ml

$\geq 100 \text{ ml}$ • $\pm 3 \% - 0$

+6 %

Masat e shërbimit

< 200 ml • $\pm 5 \% - 0$

+10 %

$\geq 200 \text{ ml}$ • $\pm 5 \text{ ml} + 2,5 \% - 0$

+10 ml+5 %

3. Materialet

Masat e kapacitetit të shërbimit krijohen nga materiale të cilat janë aq të ngurta dhe me dimensione të qëndrueshme për të mbajtur kapacitetin brenda MPE-së.

4. Forma

4.1. Masat e transferimit krijohen në mënyrë që një ndryshim i përmbajtjes i barabartë me MPE-në të shkaktojë një ndryshim në nivelin prej të paktën 2 mm në buzë ose shenjën e mbushjes.

4.2. Masat e transferimit krijohen në mënyrë të tillë që të mos pengohet zbrazja e plotë e lëngut që është duke u matur.

5. Shënimi

5.1. Kapaciteti nominal i deklaruar është i shënuar qartë dhe në mënyrë të pa-heqshme në matës.

5.2. Në masat e kapacitetit të shërbimit gjithashtu mund të vendosen masa me deri në tre kapacitete të dallueshme qartë, asnjë prej të cilave nuk çon në ngatërrim të njëjës me tjetrën.

5.3. Të gjitha shenjat e mbushjes janë aq të qarta dhe të qëndrueshme për të siguruar se MPE-të nuk kapërcehen në përdorim.

VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË

Procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të referuara në nenin 9 që prodhuesi mund të zgjedhë janë:

A1 ose F1 ose D1 ose E1 ose B + E ose B + D ose H.

SHTOJCA MI-009

Instrumentet e matjes së dimensioneve

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I, kërkesat e veçanta të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në këtë shtojcë, zbatohen për instrumentet matëse e matjes së dimensioneve të llojeve të përcaktuar më poshtë.

PERKUFIZIMET

Instrumenti i matjes së gjatësisë: një instrument i matjes së gjatësisë shërben për përcaktimin e gjatësisë së materialeve të llojit litar (p.sh. tekstile, shirita, kablllo) gjatë lëvizjes së prodhimit që matet.

Instrumente të matjes së sipërfaqes: një instrument i matjes së sipërfaqes shërben për përcaktimin e sipërfaqes së objekteve me një formë jo të rregullt, p.sh. për lëkurën.

Instrumentet e matjes me shumë dimensione: një instrument i matjes me shumë dimensione shërben për përcaktimin e gjatësisë së skajit (gjatësi, lartësi, gjerësi) të paralelepipedit më të vogël të brendshëm të një prodhimi.

KAPITULLI I — Kërkesat e zakonshme për të gjithë instrumentet matëse e matjes së dimensioneve

Imuniteti elektromagnetik

1. Ndikimi i një trazire elektromagnetike mbi një instrument të matjes së dimensioneve është i tillë që:

— ndryshimi në rezultatin e matjes nuk është më i madh sesa vlera kritike e ndryshimit siç përcaktohet në paragrafin 2.3; ose

— është e pamundur të kryhet ndonjë matje; ose

— ekzistojnë luhatje të momentit në rezultatin e matjes që nuk mund të interpretohen, memorizohen (regjistrohen) ose transmetohen si një rezultat i matjes; ose

— ekzistojnë luhatje në rezultatin e matjes aq të larta sa që vihen re prej atyre që janë të interesuar në rezultatin e matjes.

2. Vlera kritike e ndryshimit është e barabartë me një interval të një shkalle.

VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË

Procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të referuara në nenin 9 që prodhuesi mund të zgjedhë janë:

Për instrumentet matëse mekanike ose elektromekanike:

F1 ose E1 ose D1 ose B + F ose B + E ose B + D ose H ose H1 ose G.

Për instrumentet matëse elektronike ose instrumentet matëse që përmbajnë programe kompjuterike:

B + F ose B + D ose H1 ose G.

KAPITULLI II — Instrumentet matëse të matjes së gjatësisë

Karakteristikat e prodhimit që matet

1. Tekstilet karakterizohen nga faktori i karakteristikës K. Ky faktor mban parasysh zgjatjen dhe forcën për njësinë e sipërfaqes së prodhimit të matur dhe përcaktohet nga formula e mëposhtme:

$$K = \varepsilon \cdot (G_A + 2,2 \text{ N/m}^2), \text{ ku}$$

ε është zgjatja relative e një mostre të cohës 1 m e gjerë nën një forcë zgjatëse prej 10 N,

G_A është forca e peshës për njësinë e sipërfaqes të një mostre të cohës në N/m².

Kushtet e funksionimit

2.1. S f e r a

Dimensionet dhe faktori K ku është i zbatueshëm brenda sferës së përcaktuar nga prodhuesi për instrumentin. Sferat e faktorit K jepen në Tabelën 1:

Tabela 1

Grupi Sfera e K Prodhimi

I $0 < K < 2 \times 10^{-2} \text{ N/m}^2$ zgjatje e ulët

II $2 \times 10^{-2} \text{ N/m}^2 < K < 8 \times 10^{-2} \text{ N/m}^2$ zgjatje mesatare

III $8 \times 10^{-2} \text{ N/m}^2 < K < 24 \times 10^{-2} \text{ N/m}^2$ zgjatje e lartë

IV $24 \times 10^{-2} \text{ N/m}^2 < K$ zgjatje shumë e lartë

2.2. Atje ku objekti i matur nuk transportohet nga instrumenti matës, shpejtësia e tij duhet të jetë brenda sferës së përcaktuar nga prodhuesi për instrumentin.

2.3. Nëse rezultati i matjes varet nga trashësia, kushti i sipërfaqes dhe lloji i dorëzimit (p.sh. nga një rrotull i madh ose një piring), kufizimet korresponduese janë të përcaktuara nga prodhuesi.

MPE-të

3. I n s t r u m e n t i

Tabela 2

Klasa e saktësisë MPE

I 0,125 %, por jo më pak se 0,005 Lm

II 0,25 %, por jo më pak se 0,01 Lm

III 0,5 %, por jo më pak se 0,02 Lm

Ku Lm është gjatësia minimale e matshme, d.m.th. gjatësia më e vogël e përcaktuar nga prodhuesi për të cilën instrumenti synohet të përdoret.

Vlera e vërtetë e gjatësisë së llojeve të ndryshëm të materialeve duhet të matet duke përdorur instrumente të përshtatshme (p.sh. shirita të gjatësisë.) Kështu që, materiali i cili matet duhet të vendoset në një shtresë të përshtatshme (p.sh. një tryezë e përshtatshme) e drejtë dhe jo e zgjatshme.

Kërkesa të tjera

4. Instrumentet matëse duhet të sigurojnë se prodhimi matet pa zgjatje sipas zgjatjes së synuar për të cilin instrumenti është krijuar.

KAPITULLI III — Instrumente të matjes së sipërfaqes

Kushtet e funksionimit

1.1. S f e r a

Dimensionet brenda sferës së përcaktuar nga prodhuesi për instrumentin.

1.2. Kushti i prodhimit

Prodhuesi duhet të përcaktojë kufizimet e instrumenteve për shkak të shpejtësisë dhe trashësisë së kushteve të sipërfaqes, nëse është e përshtatshme, të prodhimit.

MPE-të

2. Instrumenti

MPE është 1,0 %, por jo më pak se 1 dm².

Kërkesa të tjera

3. Paraqitja e prodhimit

Në rast të tërheqjes pas ose ndalimit të prodhimit, nuk duhet të ketë një gabim të matjes ose treguesi duhet të jetë i zbrazët.

4. Intervali i shkallës

Instrumentet matëse duhet të kenë një interval të shkallës prej 1,0 dm². Përveç kësaj, duhet të jetë e mundshme që të ekzistojë një interval i shkallës prej 0,1 dm² për qëllime testimi.

KAPITULLI IV — Instrumentet matëse të matjes me shumë dimensione

Kushtet e funksionimit

1.1. S f e r a

Dimensionet brenda sferës të përcaktuara nga prodhuesi për instrumentin.

1.2. D i m e n s i o n i m i n i m a l

Kufiri i ulët i dimensionit minimal për të gjitha vlerat e intervalit të shkallës së dhënë në Tabelën 1.

Tabela 1

Intervali i shkallës(d)

Dimensioni minimal (min) (kufiri i ulët)

$d \leq 2$ cm 10 d

$2 \text{ cm} < d \leq 10$

cm 20 d

$10 \text{ cm} < d \leq 50$ d

1.3. Shpejtësia e prodhimit

Shpejtësia duhet të jetë brenda sferës së përcaktuar nga prodhuesi për instrumentin.

MPE-të

2. I n s t r u m e n t i:

MPE është $\pm 1,0$ d.

SHTOJCA MI-010 Analizuesit e gazit të shkarkos

Kërkesat e përshtatshme të Shtojcës I, kërkesat e veçanta të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në këtë shtojcë zbatohen për analizuesit e gazit të shkarkos të përcaktuar më poshtë, të synuar për inspektimin dhe mirëmbajtjen profesionale të automjeteve me motor në përdorim.

PËRKUFIZIMET

Analizuesi i gazit të shkarkos: një analizues i gazit të shkarkos është një instrument matës që shërben për të përcaktuar pjesë të vëllimit të elementeve përbërëse të caktuar të gazit të shkarkos nga motori i një automjeti me motor me ndezje me shkëndijë në nivelin e lagështirës të mostrës së analizuar.

Këto elemente përbërëse të gazit janë monoksid karboni (CO), dyoksid karboni (CO₂), oksigjen (O₂) dhe hidrokarbon (HC).

Përmbajtja e hidrokarboneve duhet të shprehet si një përqendrim i n-heksanit (C₆H₁₄), të matur me teknikat e thithjes pranë rrezeve infra të kuqe.

Pjesët e vëllimit të elementeve përbërëse të gazit shprehen si një përqindje (% në vëllim) për CO, CO₂ dhe O₂ dhe në pjesë për milion (ppm në vëllim).

Gjithashtu, një analizues i gazit të shkarkos llogarit vlerën lambda nga pjesë të vëllimit të elementeve përbërëse të gazit të shkarkos.

Lambda: lambda është një vlerë pa dimension që përfaqëson efektshmërinë e djegies së një motori për sa i përket raportit të ajrit/karburantit në gazet e shkarkos. Ajo përcaktohet me një formulë referimi të standardizuar.

KËRKESAT E VEÇANTA

Klasat e instrumentit

1. Dy klasa (0 dhe I) përcaktohen për analizuesit e gazit të shkarkos. Sferat minimale përkatëse të matjes për këto dy klasa tregohen në Tabelën 1.

Tabela 1

Klasat dhe sferat e matjes

Parametri Klasat 0 dhe I

pjesa CO nga 0 ne 5 % në vëllim
pjesa CO₂ nga 0 ne 16 % në vëllim
pjesa HC nga 0 ne 2 000 ppm në vëllim
pjesa O₂ nga 0 ne 21 % në vëllim
 λ nga 0,8 ne 1,2

Kushtet e vlerësuara të përdorimit

2. Vlerat e kushteve të përdorimit përcaktohen nga prodhuesi si më poshtë:

2.1. Për sasitë e ndikimeve klimatike dhe mekanike:

— Një sferë e temperaturës minimale 35 °C për mjedisin klimatik;
— Klasa e mjedisit mekanik që zbatohet është M1.

2.2. Për sasitë e ndikimeve të energjisë elektrike:

— Sfera e voltazhit dhe e frekuencës për furnizimin me voltazh AC;
— Kufijtë e furnizimit me voltazh DC.

2.3. Për presionin e mjedisit:

— Vlerat minimale dhe maksimale të presionit të ambientit janë për të dy klasat: $p_{min} \leq 860$ hPa, $p_{max} \geq 1\ 060$ hPa.

Gabimet maksimale të lejueshme (MPE-të)

3. MPE-të përcaktohen si më poshtë:

3.1. Për secilën prej pjesëve të matura, vlera maksimale e lejueshme e gabimit në kushtet e vlerësuara të funksionimit sipas paragrafit 1.1. të Shtojcës I është vlera më e madhe e dy vlerave të treguara në Tabelën 2. Vlerat absolute shprehen në % në vëllim ose ppm në vëllim, vlerat e përqindjes janë përqindje të vlerës së vërtetë.

Tabela 2

MPE-të

Parametri Klasa 0 Klasa I

pjesa CO

• $\pm 0,03$ % vol • ± 5 % • $\pm 0,06$ % vol • ± 5 %

pjesa CO₂

• $\pm 0,5$ % vol • ± 5 % • $\pm 0,5$ % vol • ± 5 %

pjesa HC

• ± 10 ppm vol • ± 5 % • ± 12 ppm vol • ± 5 %

pjesa O₂ • $\pm 0,1$ % vol • ± 5 % • $\pm 0,1$ % vol • ± 5 %

3.2. MPE në llogaritjen e Lambdes është 0,3 %. Vlera e vërtetë konvencionale llogaritet sipas formulës së përcaktuar në pikën 5.3.7.3 të Shtojcës I të Direktivës 98/69/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje

me masat që duhen marrë ndaj ndotjes së ajrit prej emetimit të gazeve nga automjetet me motor dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 70/220/KEE [1].

Për këtë qëllim, vlerat e shfaqura nga instrumenti përdoren për llogaritje.

Ndikimi i lejueshëm i trazimeve

4. Për secilën prej pjesëve të vëllimit të matura nga instrumenti, vlera kritike e ndryshimit është e barabartë me MPE-në për parametrin në fjalë.

5. Ndikimi i një trazimi elektromagnetik është i tillë që:

- ose ndryshimi në rezultatin e matjes nuk është më i lartë sesa vlera kritike e përshkruar në paragrafin 4;
- ose paraqitja e rezultatit të matjes është e tillë që nuk mund të merret për një rezultat të vlefshëm.

Kërkesa të tjera

6. Rezolucioni është i barabartë me ose i një rendi të madhësisë më të lartë sesa vlerat e treguara në Tabelën 3.

Tabela 3

Rezolucioni

CO CO₂ O₂ HC

Klasa 0 dhe klasa I 0,01 % në vëllim 0,1 % në vëllim (1) 1 ppm në vëllim

(1) 0,01 % në vëllim për vlerat e matura nën ose të barabarta me 4 % në vëllim, përndryshe 0,1 % në vëllim.

7. Shmangia standarde e 20 matjeve nuk është më e madhe sesa një e treta e elementeve standarde të MPE-ve për çdo pjesë të zbatueshme të vëllimit të gazit.

8. Për matjen e CO, CO₂ dhe HC, instrumenti, përfshirë sistemin e përcaktuar të trajtimit të gazit, duhet të tregojë 95 % të vlerës përfundimtare siç është përcaktuar me gazet kalibrues brenda 15 sekondave pas kalimit nga një gaz me një përmbajtje zero, p.sh. ajër i pastër. Për matjen e O₂, instrumenti në kushte të ngjashme duhet të tregojë një vlerë që ndryshon më pak sesa 0,1 % në vëllim nga zero brenda 60 sekondave pas ndryshimit nga ajri i pastër në një gaz pa oksigjen.

9. Elementet përbërëse të gazit të shkarkos, përveç elementeve përbërëse vlerat e të cilëve i nënshtrohen matjes, nuk ndikojnë në rezultatin e matjes më shumë sesa gjysma e elementeve standarde të MPE-ve, kur ato elemente përbërëse janë të pranishme në pjesët maksimale të mëposhtme të vëllimit:

6 % në vëllim CO,
16 % në vëllim CO₂,
10 % në vëllim O₂,
5 % në vëllim H₂,
0,3 % në vëllim NO,
2 000 ppm në vëllim HC (si n-heksan),
avuj uji deri në njomje.

10. Një analizues i gazit të shkarkos ka një mjedis të rregullimit që siguron funksionet për zerimin, kalibrimin e gazit dhe rregullimin e brendshëm. Mjedisi i rregullimit për zerimin dhe rregullimin e brendshëm është automatik.

11. Për mjediset e rregullimit automatik ose gjysmë-automatik, instrumenti nuk duhet të bëjë një matje për sa kohë që rregullimet nuk janë kryer.

12. Një analizues i gazit të shkarkos zbulon mbetjet e hidrokarbonit në sistemin e trajtimit të gazit. Nuk duhet të kryhet një matje nëse mbetjet e hidrokarbonit, të pranishme përpara çdo matje, tejkalojnë 20 ppm në vëllim.

13. Një analizues i gazit të shkarkos ka një pajisje për zbulimin automatik të çdo mosfunksionimi të sensorit të kanalit të oksigjenit për shkak të amortizimit ose një çarje në linjën e lidhjes.

14. Nëse analizuesi i gazit të shkarkos është në gjendje të funksionojë me karburante të ndryshme (p.sh. naftë ose gaz i lëngshëm), ekziston mundësia për të zgjedhur koeficiente të përshtatshme për llogaritjen e Lambdes në mënyrë të qartë në lidhje me formulën e përshtatshme.

VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË

Procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të referuara në nenin 9, që prodhuesi mund të zgjedhë, janë:

B + F ose B + D ose H1.

[1] GZ L 350, 28.12.1998, fq. 17.